

RAPORTI VJETOR 2016
Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur



Raporti i punës së Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur për vitin 2016

Përmbledhje

Viti 2016 ishte i fundit në implementimin e Strategjisë 2014-2017. Kjo nuk do të thotë se në këtë vit është përmbyllur i tërë cikli programor i paraparë për tu realizuar në këtë periudhë. Strategjia 2017-2020 sjell një cikël të ri, i cili në rastin e fondacionit, mund të shihet si vazhdim i strategjisë së kaluar por edhe si fillim i disa aktiviteteve programore të cilat janë të reja.

Po ashtu, në këtë vit, sfida më e madhe për fondacionin ishte t'i përmbyll disa aktivitete programore në mënyrë që të shihen qartë të arriturat, pavarësisht nëse programi i caktuar mbyllet apo do të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme. Ky ishte viti i tretë i implementimit të programeve që implikon një qartësi shumë më të lartë programore, që do duhej të rrumbullakësohej me: (1) rezultate konkrete që janë në harmoni të plotë me qëllimet e vendosura paraprakisht, (2) forcimin e partnerëve tanë që kanë punuar në implementim, (3) ngritjen e një ambienti më bashkëpunues për ne dhe partnerët tanë, dhe (4) përvetësimin e rezultateve (ndryshimeve) të arritura, nga grupet vendim-marrëse të cilave iu janë drejtuar kampanjat avokuese.

Të arriturat gjatë vitit 2016, duhet parë si finalizim i një cikli strategjik por edhe si krijim i kushteve për të filluar ciklin e ardhshëm. Pra, një vjelje rezultatesh por edhe pasurim i ambientit për mbjellje të reja "programore". Pothuaj se të gjitha programet – përveç RAE Avokimit, që është mbyllur – kanë punuar edhe në përgatitje për ciklin e ri strategjik. Rezultatet e arritura janë konkrete dhe lehtë të prekshme. Në kapitujt programor të këtij raporti janë dhënë më shumë detaje për to. Por vlen të përmenden disa prej tyre:

1. Në Mitrovicë, është arritur që nga një prezencë në hije, fondacioni, nëpërmes të partnerëve të tij, OJQ-së Aktiv, të krijoj një vend energjie për të gjitha aktivitetet, civile në rend të parë, duke e ngritur dukshëm pjesëmarrjen qytetare në Mitrovicën e veriut. Me qindra aktivitete, që dëshmohen në web faqen e CEC (Civic Energy Center), të themeluar dhe operacionalizuar nga fondacioni, e kanë krijuar një realitet tjetër të jetës civile, në këtë pjesë të vendit, më shumë iniciativa lokale dhe me organizata të fuqizuara të marrin një mandat të ri për intensifikimin e jetës qytetare, duke rritur në këtë mënyrë shanset për integrim më të suksesshëm. CEC është bërë shtëpi e aktiviteteve tjera programore që i ka iniciuar dhe i mban gjallë fondacioni, siç është Shkolla Europiane, platforma avokuese Empirika, dhe dyzimi i aktiviteteve të mediave serbe me OJQ-të në kampanja të përbashkëta avokuese.

2. Involvimi trevjeçar programor për ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies të organizatave qeveritare, gjatë vitit 2016 i ka treguar shenjat e para të një involvimi të suksesshëm, sidomos në Hapjen e të Dhënave si dhe anëtarësimin në EITI. Institucionet qeveritare, në krye me Ministrinë e Administratës Publike dhe Ministrinë e Integritimit, kanë filluar të ristrukturojnë shërbimet e tyre, ashtu siç ju kemi propozuar, për t'i hapur rrugë hapjes së të dhënave nga të gjitha dikasteret ekzistuese. Paralel me këtë përgatitje, është punuar edhe në një mori dokumentesh ligjore dhe strategjike, për ta çimentuar më mirë obligimin e tyre për transparencë të plotë dhe llogaridhënie adekuate. Në ciklin e dytë strategjik 2017/20 ngelet mjaft punë për të krijuar një rutinë veprimi në hapjen e të dhënave, por gjatë vitit 2016 definitivisht janë vendosur të gjitha premisat që e mundësojnë një mbarëvajtje të këtij programi aq të rëndësishëm për demokracinë kosovare.
3. Integrimi European i Kosovës ngelet një orientim “evergreen” i fondacionit. Në vitin 2016 kishte shumë lëvizje në këtë drejtim. Pas përmbylljes së kampanjës gjithëpërfshirëse për liberalizim të vizave, si dhe avokimit në disa vende Europiane si në Bruksel, Paris, Berlin, fondacioni ka arritur që ta përcjell në mënyrë mjaft efektive zërin e shoqërisë civile nëpërmes të think tenk grupeve të specializuara, të institucionet Europiane në Bruksel. Një nismë bashkëpunimi e fondacionit me zyrën Europiane në Prishtinë, ka sjellë mjaft rezultate konkrete në përafrimin e qëndrimeve të ekspertëve Kosovar nga think tenk organizatat të ata që hartojnë raporte dhe plane për Kosovën në Bruksel. Autoritetet në Prishtinë ishin cak i dytë i avokimit për integrim të vendit në BE. Më shumë se 10 think tenk dhe organizata avokuese i kanë sjellë rekomandimet e veta në platformën e Forum 2015, me të cilat kanë avokuar për zgjidhjet që dalin nga hulumtimet e bëra, në shumë lëmi të rëndësishme për ngritjen e nivelit të sundimit të ligjit në vend. Po ashtu, këto organizata kanë organizuar punëtori edukative, me pjesëmarrjen e ekspertëve vendor dhe të jashtëm, për të ngritur nivelin e njohurive që kanë përfaqësuesit civil dhe politik të administratës Kosovare, shoqërisë civile, mediave, institucioneve të pavarura, për lëmitë me interes të posaqëm për procesin e integritimit Europiane.
4. Integrimi European i Kosovës është adresuar edhe nga programi i “Lidhjes me Europën”, i cili përpos ngritjes së marrëdhënieve me pesë shtetet Europiane që nuk e kanë njohur shtetësinë e Kosovës, i ka adresuar edhe shtetet rajonale, Serbinë dhe Bosnjën e Hercegovinën. Ky program shumëvjeçar i fondacionit, në vitin 2016 e ka filluar një cikël të ri aktivitetesh, që sjellin në spikamë më shumë ekspertë nga shtetet respektive, të cilët marrin mandatin që pas hulumtimit të çështjeve të caktuara në Kosovë, ta bëjnë prezantimin e gjetjeve të tyre në institucionet akademike dhe së bashku me mediat, dhe opinionionin e gjërë, nga vendet mosnjohëse, që janë pesë anëtare të BE dhe dy rajonale. Në këtë mënyrë synohet përforcimi i kampanjave avokuese, nga studentët dhe ekspertët e këtyre vendeve, që me hulumtimet e tyre do ta ngrisin nivelin e njohurive që këto shtete i kanë për Kosovën dhe në mënyrën ma të mirë do të jenë në gjendje që t'i thyejnë paragjykimet eventuale që ato kanë për te. Një pjesë e këtij programi do të sjell në Kosovë ekspertizën e profesorëve të njohur European që vijnë nga Universitete dhe think tenk organizata prestigjioze, që do të sjellin eksperiencën dhe rezultatet e hulumtimeve të tyre, për pozitën aktuale që mbajnë shtetet (1) që nuk e njohin shtetësinë e Kosovës, (2) shtetet që e njohin

shtetësinë dhe vazhdojnë të jenë shumë mbështetëse të pavarësisë së saj dhe (3) shtetet që e njohin shtetësinë por që kohëve të fundit nuk janë aq mbështetëse.

5. Ky ishte viti i fundit që fondacioni merret me çështje të RAE, në këtë rast ngritjes së kapaciteteve të organizatave civile që i përkasin këtyre komuniteteve për të avokuar për përmirësimin e kushteve të jetës, edukim dhe pjesëmarrje sa më të denjë në jetën publike. Nga viti 2017, fondacioni do të vazhdojë të punojë me këto komunitete nëpërmjet fondeve të palëve të treta. Janë arritur disa caqe: (1) është krijuar rrjeti jo formal i të rinjëve RAE, të cilët janë trajnuar për të avokuar sa më mirë, (2) janë përkrahur disa projekte bazike të OJQ-ve RAE për përmirësimin e kushteve të jetës dhe pjesëmarrje në administratën publike lokale, (3) është krijuar një potencial brenda mediave nacionale për të raportuar për aktivitetet e shoqërisë civile brenda këtyre komuniteteve, në mënyrë të rregulltë dhe përfundimisht (4) janë arritur disa rezultate konkrete pas avokimit të bërë.

Në vazhdim të punës së bërë në këtë vit, fondacioni ka punuar edhe me projektet e financuara nga palët e treta (fonde jo-Soros), si dhe me fondin rezervë të OSF, në partneritet me fondacionin e Bosnjës dhe Hercegovinës (më shumë detaje ka brenda këtij raporti).




RAPORTI FINANCIAR

PASQYRA PERMBLEDHESE FINANCIARE E SHPENZIMEVE të KFOS-it

për periudhen kohore Janar - Dhjetor 2016

Nr.	Specifikimi	Buxheti	Shpenzuar	% e Shpenzuar
1	Mjetet e buxhetit bazë për vitin 2016			
	Koncepti 1 - Platforma e vet avokimit RAE	121,143.98	121,143.98	100.00
	Koncepti 2 - Ribashkimi i Mitrovices	347,999.40	347,999.40	100.00
	Koncepti 3 - Rilidhja me Evropën	313,081.87	313,081.87	100.00
	Fusha 1 - Transparenca dhe llogaridhenja	294,203.40	294,203.40	100.00
	Fusha 2 - Integrimet Evropiane	239,428.40	239,428.40	100.00
	Mjetet e Fondit Rezerve - School me	265,571.00	265,571.00	100.00
	Shpenzimet Administrative	236,673.75	236,434.50	99.90
<i>Sub-Totali 1 :</i>		1,818,101.80	1,817,862.55	99.99
2	Mjetet e buxhetit të rrjetit OSF për vitin 2016			
	School me	138,828.42	138,828.42	100.00
<i>Sub-Totali 2 :</i>		138,828.42	138,828.42	100.00
3	Mjetet e buxhetit të donatorëve tjerë për vitin 2016			
	Fondet e Bashkimit Evropian	371,100.00	371,100.00	100.00
	Karl Kubel Shtiftung	132,739.00	132,739.00	100.00
	Ambasada Zvicerane	29,505.37	29,505.37	100.00
	Programi i zhvillimit të Kombeve të Bashkuara - UNDP	26,614.63	26,614.63	100.00
<i>Sub-Totali 3:</i>		559,959.00	559,959.00	100.00
Totali i buxhetit dhe shpenzimeve:		2,516,889	2,516,650	

Shpenzimet e bëra sipas programeve



Buxheti i shpenzuar sipas programeve - euro






Figura 2. Shpenzimet e bera sipas muajve ne 2016




Figura 1. Buxheti i shpenzuar i ndare sipas kategorive financuese





Figure4. Shperndarja e granteve sipas vleres se tyre - euro (eshte marr per baze shuma totale e shpenzuar sipas ketyre kategorive)







TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA

Transparenca dhe Llogaridhënia

Përmbledhje

Programi i Ngritjes së Transparencës dhe Llogaridhënies të organizatave qeveritare në vitin 2016 ishte shumë më shumë në gjysmë të rrugës se në përfundim të implementimit të aktiviteteve të parapara tre vjet më parë. Ky ishte edhe shkaku që Bordi dhe stafi i Fondacionit këtë program vazhdojnë ta mbajnë lartë në agjendën 2017-2020.

Varësisht nga synimet strategjike, një pjesë e madhe e programeve (1) janë përmbyllur me sukses (T&A në administratë lokale) (2) një pjesë tjetër është e përgatitur tashmë për të bërë hapat e fundit dhe konkret para se të fillojnë realizimin (Open Data, EITI) si dhe (3) projektet që gjatë vitit u ngritën për të qenë përgjegjës për situatat e krijuara, ku Fondacioni me veprimin e vet mund të sjell ndryshimin (Trepça, Kosova C, Shoqëria Civile dhe Politika).

Ajo që mund të konstatohet në fund të vitit 2016 është se disa programe janë faktorizuar mjaftë shumë brenda autoriteteve të administratës qendrore dhe në komunitetin e donatorëve, të cilët kanë shprehur gatishmëri për të ko-financuar punët e mëtutjeshme. Në rend të parë është fjala për projektin qendror Të Dhënat e Hapura, i cili pritet që gjatë 2017 të ketë mbështetje financiare dominuese nga donatorë të mëdhej, por që mbetet në lidhshirë të Fondacionit. Hapa të njejtë, por akoma fillestar janë bërë edhe me projektin e industrisë nxjerrëse, Extractive Industry Transparency International - EITI.

Qeverisja e Hapur

Hapja e të dhënave

Iniciativa e Fondacionit për Hapjen e të Dhënave në vitin 2016 pati zhvillim mjaft të hovshëm dhe janë bërë një sërë të arriturash, ashtu si kanë qenë të planifikuara, por edhe më shumë.

Në mars është mbajtur takimi me të gjithë hisedarët me qëllim që të diskutohet vazhdimi i punës për Hapjen e të Dhënave, të filluar në vitin 2015. Në takim u diskutua për kompletimin e legjislacionit, për Kartën e Kosovës për Hapje të të Dhënave dhe veprimin e mëtutjeshëm në mes hisedarëve.

Ministria e Integrimit Evropian ishte bartëse e këtij procesi nga ana e qeverisë, deri me 13 maj kur është aprovuar Karta e Kosovës për Hapjen e të Dhënave. Në këtë vendim është mandatuar Ministria e Administratës Publike për ta udhëhequr procesin mëtutje. MAP e krijoi grupin punues i cili do ta draftonte planin e veprimit të Kartës. Propozimi i dhënë nga Fondacioni për pjesëmarrësit e grupit punues është pranuar nga MAP. Fondacioni e angazhoj konsulentin për ta ndihmuar këtë proces dhe propozuar draftin e parë të planit të veprimit, i cili në nëntor është diskutuar me grupin punues si dhe me zyrën e Millennium Challenge Corporation - MCC

në Prishtinë. Kryeministri Isa Mustafa, me 18 nëntor i dërgon letër MCC në Uashington, në të cilën zotohet që njëra ndër prioritetet e qeverisë për ta luftuar korrupsionin është Hapja e të Dhënave. Fondacioni tërë kohën e ka ushqyer me informata zyrën e Kryeministrit dhe atë të MCC-së se çfarë është punuar në këtë drejtim dhe si të vazhdohet më tutje. MCC është treguar e gatshme për ta mbështetur financiarisht vazhdimin e punës në hapjen e të dhënave. Për këtë janë duke u organizuar disa takime në mes të Fondacionit, MCC Uashington dhe Prishtinë, si dhe Qeverisë.

Hapja e të Dhënave është pjesë operacionale të cilën e realizon Fondacioni me partnerët e tij. Ndërsa, për ta mbështetur këtë iniciativë si dhe projekte të tjera në shtyllën programore Qeverisja e Hapur, janë ndarë grante organizatave, për punën e të cilave më poshtë janë raportimet për secilin projekt.

Instituti Riinvest: Forumi Kombëtar për shkëmbimin e eksperiencave mbi qeverisjen e hapur- Avokimi për Qeverisje të Hapur

Forumit Kombëtar për shkëmbimin e eksperiencave mbi qeverisjen e hapur, është në kuadër të projektit 'Avokimi për Qeverisje të Hapur', projekt i cili udhëhiqet nga rrjeti PASOS. Partnerët e këtij projektit janë: 1) PASOS, Czech Republic 2) Institute for Democracy and Mediation, Shqipëri 3) The Monitoring Centre CEMI, Mal i Zi 4) Centre for Euro-Atlantic Studies, Sërbi, 5) Analitika – Qendra për Studime Sociale, Bosne dhe Hercegovinë 6) Centre for Research and Policy Making, Shqipëri.

Qëllimi i këtij forumi ishte shkëmbimi i eksperiencave dhe prezantimi i praktikave më të mira rajonale të cilat duhet ndjekur nga Institucionet e Kosovës në mënyrë që të rritet transparencja, llogaridhënia dhe participimi qytetar. Ky qëllim është arritur përmes ndarjes së eksperiencave të OJQ-ve të shteteve të anëtarësuar në PQH, e përfaqësues gjatë forumit për këto OJQ ishte Paul Maassen, koordinator i shoqërisë civile në PQH. Ndarja e eksperiencave është bërë edhe nga ekspert qeveritar dhe jo qeveritar të Qeverisjes së Hapur në Shqipëri. Më saktësisht Artela Mitrush, ekspert i PQH-së, Shqipëri, ndau gjatë forumit 'reflektimin mbi kontributin e OSHC-ve në Shqipëri në kuadër të PQH' dhe eksperiencat e tjera të organizatave të shoqërisë civile. Ndërsa, Jona Josifi, nga Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike, Zyra e Kryeministrit, shqipëri, prezantoi "rritjen e integritetit publik në Shqipëri" dhe angazhimin e Shqipërisë për një qeverisje të hapur. Ndër të tjerë, përfaqësuesit e Kosovës gjithashtu ndanë përvojat dhe rrugëtimin e institucioneve si qeveritare ashtu edhe të shoqërisë civile për një qeverisje më të hapur.

Në këtë forum ekspertët nga rajoni ndanë eksperiencat e tyre rreth aktiviteteve të Partneritetit për Qeverisje të Hapur (PQH), si dhe eksperiencat nga angazhimet si qeveritare ashtu edhe të shoqërisë civile, në një përpjekje për të përmirësuar strukturat dhe mekanizmat që sigurojnë transparencë, llogaridhënie dhe pjesëmarrje aktive qytetare.

Ndërsa, u kuptua edhe orientimi i qeverisë së Kosovës drejt zhvillimit të më tutjeshëm së hapjes së të dhënave me rëndësi për publikun. Kjo duke funksionalizuar dhe pasuruar portalin e të dhënave të hapura, linku: <http://opendata.rks-gov.net/>, i cili akoma nuk është shumë funksional.

Open Data Kosovo: Trajnim për zyrat komunale të prokurimit, si ti hapim dhe t'i bëjmë të qasshme për publikun të dhënat e prokurimit

Faza e parë e projektit ka inicuar ndërtimin e kontakteve me institucionet qendrore, më saktësisht me Ministrinë e Administratës Publike, respektivisht Agjencionin e Shoqërisë së Informacionit dhe komunat.

Në fazën e dytë ishte trajnimi i përfaqësuesve të komunave, respektivisht zyrave të prokurimit, ndërsa faza e tretë, e cila do të zgjatë deri në muajin shkurt të vitit 2017 do të bëhet hapja e "Llogarive" përkatëse për komunat e përfshira në kuadër të portalit <http://opendata.rks-gov.net/>, si dhe futja e të dhënave nga ana e përfaqësuesve të komunave, së bashku me koordinimin dhe monitorimin e vazhdueshëm.

Komunat me të cilat është punuar janë: Prishtina, Gjakova, Ferizaj, Gjilani, Vitia dhe Lipjani, ndërsa Shtimja është në proces. Nga ecuria e punës në terren është se procesi i futjes së të dhënave pas trajnimit mund të rezultojë rrjedhshëm, por janë hasur në dy sfida kryesore: 1. Përgjegjësia e Institucioneve (duhet të përdoren disa mënyra të komunikimit, për të arritur rezultatin e dëshiruar) dhe 2. Personat të cilët e marrin detyrën pa dëshirë, mund të ndodh që të mos e vazhdojnë rrjedhjen e futjes së të dhënave (dëshira duhet të bëhet obligim).

Në planin për të ardhmen ODK do të vazhdojë të: (1) Monitorojë komunat të cilat kanë qasje në portal, nëse është nevoja edhe aftësimi shtesë (2) Shtojë komuna të reja në sistemin e open data-së (3) Përfshijë institucionet qendrore (raportet e prokurimit) dhe (4) Gjeneralizojë data-setet me të dhëna nga sektorët e tjerë (përveç prokurimit).

OJQ Çohu: Shkolla për gazetari hulumtuese

Organizata për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet – Cohu!, përmes Qendrës Kosovare për Gazetari Hulumtuese, në vitin 2016, realizoi shkollën trajnuese për gazetari hulumtuese. Ky projekt me kohëzgjatje njëvjeçare u realizua në disa faza të ndryshme duke filluar nga planifikimi i pjesëve të veçanta trajnuese deri te realizimi i tyre përfundimtar. Projekti u realizua si bashkëpunim i Organizatës Çohu! respektivisht Qendrës Kosovare për Gazetari Hulumtuese dhe organizatës KRIK nga Beogradi. Target për ofrimin e këtij trajnimi ishin organizatat e shoqërisë civile dhe studentët, kryesisht studentë të gazetarisë dhe fushave të tjera sociale. Organizatat e shoqërisë civile u ftuan të merrnin pjesë, ndërsa pjesëmarrja e studentëve u mundësua pas aplikimit dhe shqyrtimit të aplikacioneve. Si përfundim pjesëmarrës në trajnim ishin rreth 25 përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe studentë.

Shkolla për gazetari hulumtuese ishte trajnim i cili në vete përmbante dy pjesë trajnimi të dyja me karakter hulumtues dhe me prezantim të metodologjive të veçanta. Pjesa e parë e trajnimit 'Natyra e krimit të organizuar dhe metodat e hulumtimit në fushën e gazetarisë hulumtuese', trajnim ky që u mbajt në Durrës, u realizua nga stafi profesional dhe me bagazh në fushën e gazetarisë hulumtuese nga organizata KRIK. Përmbajtja kryesore e kësaj pjese të trajnimit ka qenë natyra e krimit të organizuar, hulumtimet e avancuara, databazat ndërkombëtare për biznese, qarkullimi i parasë së paligjshme të bizneseve, dhe hulumtimi i avancuar në internet.

Pjesa e dytë e trajnimit e realizuar në Prishtinë nga stafi i organizatës Çohu ka vazhduar që për fokus kryesisht të ketë aspektet praktike të gazetarisë hulumtuese në Kosovë. Kjo pjesë e hulumtimit u përbë nga tri module të veçanta: 1. Metodatat hulumtuese dhe ndërtimi i databazave 2. Aspekti ligjor dhe 3. Etika dhe shkrimi në gazetarinë hulumtuese.

Demokrasi Plus: Rritja e përgjegjshmërisë së OSHP-së përmes monitorimit

Demokrasi plus (D+) me datën 1 dhjetor 2016, ka filluar me zbatimin e projektit për monitorimin e takimeve të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP). Në kuadër të muajit dhjetor është zhvilluar metodologjia e monitorimit të takimeve, së bashku me dimensionet e monitorimit. Në këtë kuadër është hartuar edhe formulari elektronik ku do të procesohen të dhënat për takimet e OSHP-së. Linku për të parë këtë formular është <http://dplus-ks.org/oshp/newfolder/index.php>.

Përveç hartimit të metodologjisë së monitorimit, D+ ka iniciuar edhe një takim me kryetarin e OSHP-së, z. Blerim Dina. Kryetari i OSHP-së është njoftuar se nga dhjetori i vitit 2016, D+ do të monitoroj të gjitha seancat e këtij institucioni. Po ashtu është prezantuar edhe qëllimi i këtij monitorimi dhe është kërkuar bashkëpunimi i institucionit në lehtësimin e këtij monitorimi. Me kërkesën e Kryetarit të OSHP-së është iniciuar nënshkrimi i një memorandumi të bashkëpunimit në mes të OSHP-së dhe D+. Arsyeja e z. Dina për nënshkrimin e memorandumit ka qenë që OSHP të bëjë zotime institucionale për të lehtësuar dhe lejuar monitorimin në përputhje me legjislacionin. Poashtu, përmes këtij memorandumi dhe të gjithë anëtarët e bordit të OSHP-së do të ishin pjesë e vendimit për të lidhur këtë bashkëpunim. D+ ka marr zotimin që të draftoj versionin fillestar të Memorandumit dhe i njëjti është në pritje të komenteve apo ftesës së OSHP-së për ta nënshkruar.

Gjatë muajit dhjetor, janë monitoruar dy seanca dëgjimore të OSHP-së nga D+. Seanca e parë ka pasur për kontest lëndën e renovimit të stadiumit në Malishevë, përderisa seanca e dytë e monitoruar ka pasur për kontest pastrimin e hapësirave të brendshme të QKUK-së.

Aktivitetet shtesë i realizuar i cili nuk ka qenë i paraparë me projekt, është organizimi i një debati publik në formë të dëgjimit publik në bashkëpunim me Komisionin e Kuvendit për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Tema e këtij debati ka qenë "Performanca dhe Integriteti i OSHP-së". Në këtë takim kanë marr pjesë anëtarët e Komisionit, Kryetari i OSHP-së Blerim Dina, Kryetari i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik Safet Hoxha, Përfaqësuesja e Ambasadën Amerikane Michele Stovall, përfaqësues të OJQ-ve bashkë organizuese të javës kundër korrupsionit #bashkeendreqim, gazetarë hulumtues, dhe përfaqësues të disa operatorëve ekonomik.

Sbunker & Open 333: "Çfarë lirie?"

OJQ Sbunker është duke realizuar projektin tematik "Çfarë lirie?", me qëllimin për të kontribuar, përmes avokimit publik, në krijimin e debatit mbi temat më të rëndësishme publike, mbrojtjen e vlerave të kushtetutës si dhe të kuptimit të lirisë dhe të drejtave të parapara aty.

Projekti përfshin prodhimin dhe publikimin e përbashkët të gjashtë serive të video-mesazheve Open 333, dhe publikimin e 12 shkrimeve analitike dhe ilustrimeve përkatëse.

Seria e parë nën bashkëpunimin Sbunker & Open 333 është realizuar në muajin nëntor nën tematikën “Çfarë sjell ligji për Trepçën?”, i cili përmban mesazhe nga Muhamet Mustafa, Luan Shllaku dhe Iraj Hashi. Përkitazi me publikimin e kësaj serie, në bllogun Sbunker janë botuar dy opinione pasuese, “Aktet juridike nuk mjaftojnë për zhvillim ekonomik” nga profesorët Besnik Pula dhe “Trepça, bekim apo mallkim” nga Kujtim Dobruna, të ilustruara nga Driton Selmani.

Përmbajtja e kësaj serie ka arritur të një audiencë totale prej 15, 700 personash në kanalet e rrjeteve sociale.

Seria e dytë në kuadër të këtij bashkëpunimi ka shtjelluar temën qendrore “Çfarë ndryshojnë librat e historisë në Ballkan?”, në të cilën janë paraqitur si folës Shkëlzen Gashi, Bekim Blakaj dhe Ermal Hasimja. Shkrimet komplementare të serisë janë realizuar nga profesoret Armanda Hysa, “Çfarë shtrembërojnë librat e histories në ballkan”, nga Universiteti i Tiranës dhe “Logjika e falsifikimit të historisë” nga Anna Di Lellio nga Universiteti i Nju Jorkut, me ilustrime të Driton Selmanit.

Seria e dytë ka arritur tek më se 37 mijë përdorues, pas publikimit në kanalet e rrjeteve sociale dhe kanalit në YouTube.

OJQ FOL: Reforma Ligjore kundër Korrupsionit / Ndryshim-Plotësimi i Ligjit për Deklarim të Pasurisë dhe Ligjit për Sinjalizues

Projekti përmban tre objektiva kyçe: **a)Raporti i harmonizuar me ndryshim-plotësim të këtyre dy ligjeve b)Futja në agjendë për diskutim të ligjeve të përmendura c)Ndryshimi dhe miratimi i ligjeve të deklarimit të pasurisë dhe ligjit për sinjalizues.**

Lidhur me objektivën e parë - Do të hartohet raporti i harmonizuar me ndryshim-plotësimin e Ligjit për Deklarim të Pasurisë dhe Ligjit për Sinjalizues. Gjatë muajit dhjetor janë ndërmarë këto veprime: analizë e përmbajtjes, mbledhje e të dhënave, dhe rishikim i raporteve nga organizata të tjera të shoqërisë civile lidhur me ndryshim-plotësimin e ligjeve. Ndërkaq, gjatë periudhës Janar-Mars do të përpilohet draft-raporti i harmonizuar, i cili do të përmbajë të gjitha të gjeturat dhe shembuj nga praktikat më të mira të vendeve evropiane sa i përket kornizës ligjore për luftën ndaj korrupsionit. Ky draft raport më pas do të shpërndahet për komente në punëtorinë e parë që do të organizohet me akterë kyç si: komisionin për legjislacion, nënkomisionin për mbikëqyrje, agjencinë kundër korrupsion, ekspert të fushës, shoqërinë civile dhe media. FOL- si udhëheqës i planifikimit, takimeve dhe punimeve në grup punues do e finalizojë raportin e harmonizuar, si rezultat i debatit në punëtori si dhe takimeve të brendshme me ekspert të fushës.

Objektiva e dytë - Futja në agjendë për diskutim të këtyre ligjeve

Periudha maj-gusht, 2017 do të fokusohet kryesisht në përpjekje për të mundësuar futjen në agjendë për diskutim në Kuvendin e Kosovës. Do të organizohen takime me Komisionin për Legjislacion dhe nënkomisionin për mbikëqyrje. Në mënyrë të sigurimit të mbështetjes së tyre për mundësinë e diskutimit të këtyre ligjeve në Kuvend. Gjithashtu, do të organizohet punëtorja e dytë, me qëllimin të rishikimit të arriturave të deritashme dhe veprimet që parashihen të ndërmerren deri në përfshirjen në agjendën për diskutim të këtyre dy ligjeve.

Objektiva e Tretë - Ndryshimi dhe Miratimi i ligjeve për deklarim të pasurisë dhe sinjalizues

Periudha kohore korrik-dhjetor, 2017 do të fokusohet në lobim për miratimin e ligjeve në Kuvend të Republikës së Kosovës. Do të organizohet punëtorja e tretë dhe e fundit lidhur me këtë çështje. Duke i parë të gjithë akterët kyç të përfshirë në hartimin e raportit final, shohim më të lehtë avokimin përgjatë këtij procesi dhe krijimin e bazës ligjore dhe mekanizmave adekuat për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin në mënyrë efikase.

Demokraci Plus: Programi Qeverisës – Jo vetëm në letër!

Qëllimi i projektit është që të shqyrtohen programet e partive politike që janë pjesë e koalicionit qeverisës dhe me theks të veçantë Programi qeverisës i qeverisë së Kosovës (2015-2018). Po ashtu gjatë kësaj periudhe së realizimit është bërë identifikimi i çështjeve/obligimeve që dalin si detyra për tri dikasteret qeveritare: Ministria e Financave (MF), Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS).

Më pas është vazhduar me analizimin e vendimeve dhe veprimeve të ndërmarra nga ministrinë: MF, MZHE dhe MPMS, për t'i adresuar obligimet që dalin nga Programi qeverisës 2015-2018.

Gjithashtu, janë analizuar edhe raportet e organizatave vendore dhe ndërkombëtare mbi performancën e institucioneve qeveritare, me theks të veçantë tematikat që kanë të bëjnë me fushëveprimtarinë e ministrive që projekti i ka në fokus. Stafi i D+, gjithashtu ka përgatitur një pyetësorë me të cilin ka realizuar intervista me persona përgjegjës për temat që janë në fokus të monitorimit të D+. Për këtë qëllim D+ ka realizuar intervista me Ministrat Avdulla Hotin, Arban Abrashi dhe Blerand Stavilecin, si dhe me Safet Gërgjaliun – Oda Ekonomike e Kosovës, Ibrahim Rexhepi – organizata STRAS, Haki Shatri – AAK, Alban Hashani – Instituti Riinvest dhe Agron Demi – Instituti GAP.

Takime me zyrtarë të zgjedhur

Stafi i D+ ka realizuar takime me ministrat Avdulla Hoti, Arban Abrashin dhe Blerand Stavilecin ku ka kërkuar nga ta vlerësimin e tyre për nivelin e zbatimit të obligimeve të tyre dhe sfidat eventuale gjatë procesit të zbatimit të programit qeverisës.

Aktualisht D+ është duke e finalizuar draftin e Analizës rreth realizimit të programit qeverisës nga ministrinë që kanë qenë fokus i monitorimit. D+ planifikon që këtë analizë ta publikojë përmes një tryeze të rrumbullakët që do të realizohet gjatë muajit janar 2017.

Vlerësimi mbi procesin e monitorimit

Deri në këtë fazë të raportimit, i gjithë procesi i monitorimit ka shkuar sipas planifikimeve para-prake.

Organizata për Rritjen e Cilësisë për Arsim – ORCA: Programi Anti-Plagjiaturë në UP

ORCA e ka realizuar planin e veprimit për muajin dhjetor (brenda vitit 2016) të paraparë në kuadër të projektit PAP-UP. Janë mbledhur CV-të e profesorëve të nivelit menaxhues dhe vendimmarrës si dhe janë verifikuar punimet në revistat e dyshimta. Në ndërkohë ekipi hulumtues ka shtuar edhe disa kategori të verifikimit që lidhen me publikimet në revista ndërkombëtare dhe rajonale të pranura sipas dokumenteve përkatëse të lëshuara nga vet Senati i UP-së.

Materialet e mbledhura dhe të përpunuara si draft i parë janë në procesin e përgatitjes për konsulentin e projektit Jeffrey Beall i cili deri në muajin shkurt do t'i kthejë komentet rreth gjetjeve.

ORCA ka kryer edhe një raund takimesh me njohës të fushës së publikimeve shkencore që vepronë brenda dhe jashtë vendit për të parë mundësinë e angazhimit të tyre në recenzimin e draftit të raportit.

Poashtu, ka filluar koordinimi me organizatat studentore për një reagim të menjëhershëm pas publikimit të rezultateve.

ORCA parasheh realizim të përpiktë të planifikimeve deri në mars të vitit 2017, ndërkohë që konstaton vlefshmërinë dhe domosdoshmërinë që projekti të zgjerohet në të gjitha nivelet akademike të UP-së, me ç'rast do të përfshihej tërë stafi akademik i UP-së.

ORCA sheh potencial për krijimin e një fronti të organizatave studentore dhe organizatave të tjera të shoqërisë civile i cili do të luante rolin e kujdestarit të transparencës akademike e menaxhuese të UP-së.

KMLDNJ - Ministria e Drejtësisë, Shërbimi Korrektues dhe personat e privuar nga liria, drejt shpëtimit apo fundosjes në bankën e mungesës së transparencës dhe llogaridhënies

Gjatë realizimit të projektit, janë vizituar të gjitha qendrat korrektuese, qendrat e paraburgimit dhe stacionet policore në Kosovë. Janë realizuar takime me Ministrinë e Drejtësisë, atë të Punëve të Brendshme, Ministrinë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, Drejtorinë e Policisë së Kosovës, drejtorin e Shërbimit Korrektues të Kosovës, me komisionet parlamentare për të drejtat e njeriut dhe legjislacion, me kryetarin e Kuvendit dhe me Presidentin. Gjithashtu, është realizuar takimi edhe me ministrin e Drejtësisë së Maqedonisë për t'u informuar për trajtimin e personave të privuar nga liria, shtetas të Kosovës që mbahen të burgosur në këtë shtet. Në kuadër të bashkëpunimit rajonal është realizuar vizitë studimore edhe në Republikën e Shqipërisë kur është realizuar takuar me ministrin e Drejtësisë, drejtorin e përgjithshëm të

burgjeve të Shqipërisë, Avokatin e Popullit në Shqipëri, si dhe vizita në burgun për femra të paraburgosura dhe të dënuara në Tiranë (Burgu i vetëm për femra). Në kuadër të bashkëpunimit është realizuar edhe takimi me drejtorin e Amnesty International për Evropën Juglindore, i cili është informuar për gjendjen e personave të privuar nga liria në Kosovë. KMLDNJ ka qenë pjesë aktive e grupit punues për ridraftimin e Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale në Kosovë si dhe për ndryshimin e Rregulloreve dhe akteve të tjera nënligjore për trajtimin e personave të privuar nga liria, përmirësimin e kushteve për stafin, rritjes së transparencës dhe llogaridhënies që është qëllimi final i këtij projekti, barazisë gjinore dhe realizimit të drejtave të komuniteteve të personave të privuar nga liria u është kushtuar vëmendje e veçantë duke siguruar ndryshime pozitive në këtë drejtim. KMLDNJ është e angazhuar në hartimin e strategjisë për zbatimin e masave alternative të dënimit.

OSBE - Fushata e vetëdijësimit për sigurinë të gazetarëve

Projekti ka për qëllim ta mbështesë Kosovën në përpjekjet e saj për zbatim efikas të legjislacionit ekzistues i cili rregullon lirinë e mediave dhe lirinë e shprehjes. Në kuadër të projektit, OSBE-ja planifikon të nisë një fushatë të quajtur 'Siguria e Gazetarëve' për të rritur vetëdijësimin në lidhje me rëndësinë e ofrimit të mundësisë që gazetarët të kryejnë punën e tyre pa pengesa dhe pa frikë e kanosje. Projekti do të fillojë të zbatohet në janar të vitit 2017 dhe do të zgjasë deri në dhjetor të vitit 2018.

Fondacioni do të mbështesë dhe financojë aktivitetet në vijim: 1. Angazhimin e një kompanie për të kryer studimin e gjendjes mbi perceptimin publik të sigurisë së gazetarëve dhe rolit të mediave. Ky studim do të kryhet në fillim të projektit si dhe pas përfundimit të aktiviteteve të projektit; 2. Prodhimin e një dokumentari në lidhje me sigurinë e gazetarëve; 3. Organizimin e një konference rajonale me temën: "Gazetarët në rrezik: Standardet ligjore të mbrojtjes së gazetarëve;" 4. Zhvillimin e tri debateve televizive në lidhje me sigurinë e gazetarëve; dhe 5. Hartimin e një publikimi dhe/ose transmetimin e një storieje të prodhuar në bashkëpunim me një medium;

Ky projekt është i financuar edhe nga donatorë tjerë.

Forum 2015 - Historia e Kosovës në tekstet mësimore të historisë në Kosovë, Shqipëri, Sërbi, Mal të Zi dhe Maqedoni

Forum 2015 dhe Instituti për Studime në Shoqëri e në Kulturë Alter Habitus, organizuan tryezën në të cilën u diskutua paraqitja e historisë së Kosovës në tekstet mësimore të historisë në Kosovë, Shqipëri, Sërbi, Mal të Zi dhe Maqedoni. Kjo tryezë u organizua me rastin e publikimit të raportit të Institutit për Studime në Shoqëri Alter Habitus, me titull "Historia e Kosovës në tekstet mësimore të historisë në Kosovë, Shqipëri, Sërbi, Mal të Zi dhe Maqedoni".

Ky raport vë nën objektiv paraqitjen e historisë së Kosovës që nga antikiteti e deri më sot nëpër tekstet mësimore për shkolla fillore e të mesme të Kosovës, Shqipërisë, Sërbisë, Malit të Zi dhe

Maqedonisë. Tekstet e lëndës së historisë të këtyre pesë vendeve, të miratuara nga ministritë përkatëse të arsimit, kanë shërbyer si burimi themelor i këtij raporti. Janë krahasuar përshkrimet e bëra nëpër këto historiografi duke i nxjerrë ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre. Autorë ndërkombëtarë, që trajtojnë zhvillimet dhe ngjarjet në Kosovë në periudha të ndryshme, janë vënë përballë me argumentet përkatëse. Në mënyrë të tërthortë raporti nxjerr në pah edhe se çfarë marrëdhëniesh ndërfaqinësore po u sugjerojnë qeveritë e këtyre vendeve breza që po i arsimojnë nëpërmjet këtyre teksteve. Raporti ka për qëllim të shpalosë në mënyrë sa më të qartë dhe të faktografuar, atë që është baza e pretendimeve shpesh kundërshtuese ndërmjet popujve që përplasen në Kosovë. Panelistët në këtë tryezë ishin: Ermal Hasimja, Dr. Pedagog - Universiteti i Nju Jorkut/Tiranë, Bekim Blakaj – Fondi për të Drejten Humanitare Kosovë dhe Shkëlzen Gashi – Autor i raportit.

Lista e projekteve të organizatave të mbështetura në shtyllën Qeverisja e Hapur

Emri i Projektit	Grantist	Shuma Euro
Plani i Veprimit të Kartës së Kosovës për Hapjen e të Dhënave	Bardhyl Jashari	-
Programi qeverisës – Jo vetëm në letër	Demokraci Plus	17,820
Shkolla për Gazetari Hulumtuese	OJQ Çohu	19,000
Trajnimi për gazetarë hulumtues	KRIK	2,000
Trajnim për zyrat komunale të prokurimit se si t'i hapin të dhënat dhe t'i bëjnë të qasshme të dhënat e prokurimit	Open Data Kosovo	3,876
Ministria e Drejtësisë, Shërbimi Korrektues dhe personat e privuar nga liria, drejt shpëtimit apo fundosjes në barkën e mungesës së transparencës dhe llogaridhënies	Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut	19,350
S'bunker dhe Open 333 projekt tematik: Çfarë Lirie?	S'bunker	12,641
Rritja e përgjegjshmërisë së Organit Shqyrtues së Prokurimit përmes monitorimit	Demokraci Plus	19,060
Reforma Ligjore kundër Korrupsionit - Ndishim-Plotësimi i Ligjit për Deklarim të Pasurisë dhe Ligjit për Sinjalizues	OJQ FOL	19,230
Pjesëmarrja në OGP Summit - Paris	Open Data Kosovo	1,047
Programi Anti-Plagjiature ne UP	ORCA	13,750
Fushata e vetëdijësimit për sigurinë të gazetarëve	OSBE	20,000
Shpenzime tjera programore		15,191
	Total :	-

Privatizimi dhe Investimet Kapitale

Në maj, Fondacioni organizoj punëtori dyditore me dy organizatat partnere me të cilat është realizuar projekti i Investimeve Kapitale. Në punëtori u diskutua se si të vazhdohet me mjete avokimi për të ushtruar presion institucioneve me të gjeturat e analizave të cilat janë punuar, organizimi i tryezave në kuadër të Dokufestit si dhe idetë e reja të cilat mund të realizohen brenda kësaj shtylle të programit.

Aktivitete avokuese dhe promovuese rreth hulumtime analitike mbi investimet kapitale

Në partneritet të ngushtë dhe me mbështetjen e Fondacionit dhe organizatës Çohu, në kuadër të fushatës «Trajtoje me kujdes, është pronë e qytetarëve», Instituti Riinvest arriti të organizojë dhe të marrë pjesë në disa aktivitete të avokimit.

Pas publikimit të katër raporteve studimi në vitin 2015, aktivitetet e avokimit në vitin 2016 përfshinë panele diskutimesh, animacione të ilustruara, intervista me storie të shkurta, dokumentarin dhe diskutim në kuadër të Festivalit Dokufest.

Në prill të vitit 2016, Alban Hashani – drejtor i hulumtimit në Institutin Riinvest, Alban Zogaj – hulumtues, Lorik Bajrami nga Çohu, dhe Bujar Ejupi – hulumtues i pavarur, prezentuan të gjeturat e katër raporteve studimesh, në njërin prej emisioneve më të shikuara politike televizive në “Zona B” të kanalit nacional Klan Kosova.

Gjithashtu, si pjesë e fushatës së avokimit, Instituti Riinvest prodhoi dhe lansoi katër animacione të ilustruara njëminutëshe me titull “Projektet e mëdha qeveritare në një minutë”, që ishin rezultat i katër raporteve studimesh. Nga maji i vitit 2016 të katër animacionet u transmetuan çdo javë, kryesisht në platforma mediash sociale si YouTube, Facebook, Twitter, dhe më vonë në televizionin Klan Kosova.

Në gusht të vitit 2016, drejtori i Institutit Riinvest, Lumir Abdixhiku, dhe Alban Hashani – drejtor i hulumtimit, nën ombrellën e Fondacionit dhe Grupit KOHA, në kuadër të ngjarjes më të rëndësishme kulturore dhe festivalit të filimit Dokufest, diskutuan në lidhje me temën e korrupsionit dhe investimeve kapitale të Kosovës së bashku me përfaqësuesit e mediave dhe të shoqërisë civile. Gjithashtu, gjatë kësaj ngjarjeje u shfaqën edhe animacionet e prodhuara në kuadër të fushatës avokuese.

Në kuadër të platformës mediale Open333, u shfaqën animacionet dhe intervistat me storie të shkurta. Stafi i Institutit Riinvest gjithashtu botoi artikuj në gazeta nacionale, që kishin të bënin me temat e shtjelluara në raporte.

Organizata Çohu dhe Instituti Riinvest organizuam tryezën e diskutimit rreth procesit të privatizimit dhe gjendjes momentale të PTK-së. Në cilësi të panelistëve prezentuan: Blernad Stavileci Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Lumir Abdixhiku nga Riinvest, dhe Lorik Bajrami nga Çohu (autor

i raportit). Lorik Bajrami në tryezë tha se PTK ka pasur sërish rënie në të hyra, dhe rikthim në pikën ku ishte në vitin 2014. Sipas Bajramit të gjitha qeveritë të cilat kanë qeverisur deri me tani kanë pasur qasje partiake ndaj PTK-së, gjë e cila ka pamundësuar zhvillimin e mekanizmit të llogaridhënies, dhe ka ndikuar në rënie të performancës. Tryeza e organizuar, është mbajtur në kuadër të aktiviteteve avokuese të nismës së Fondacionit, “Trajtoje me kujdes, është pronë e qytetarëve”. Tryeza u mbajt me 26-maj-2016.

Çohu, ka reaguar edhe lidhur me dënimin e shqiptuar nga arbitrazhi për PTK-në “Degradimi dhe shkatërrimi i PTK-së nga Politika”. Organizata Çohu! e ka konsideruar shqetësues dhe të papërgjegjshëm faktin që deri me tani në tërë procesin e PTK-së janë humbur miliona euro (4.2 milionë euro për këshilltarët e transaksionit) dhe 30 milionë tash për operatorin Z-MOBILE dhe akoma nuk dihet se si do të përfundojë padia e AXOS. Ky është një shkatërrim i PTK-së, që duket të jetë i qëllimshëm nga përgjegjësit: menaxhmentet e PTK-së dhe Qeveria e Kosovës. Deri më tani nuk është dhënë përgjegjësi as politike dhe as penale lidhur me keq- menaxhimin, problemet e vazhdueshme me dështimin në privatizim si dhe degradimin e vazhdueshëm të PTK-së. Organizata Çohu! i ka bërë thirrje Prokurorisë së Shtetit që të fillojë një hetim të gjërë për personat të cilët ishin përgjegjës dhe të cilët mbajnë përgjegjësi për degradimin dhe shkatërrimin e PTK-së, deri në këtë masë. Organizata Çohu! konsideron se dikush duhet të jetë përgjegjës për humbjet e 34.2 milionë eurove të PTK-së deri më tani. Pos përgjegjësisë politike duhet të ekzistojë edhe përgjegjësia penale për personat përgjegjës (bordi aktual dhe ai i kaluar i PTK-së, drejtori aktual dhe drejtorët e mëhershëm, ministri aktual i Zhvillimit Ekonomik, dhe ministrat e mëhershëm).

Revitalizimi i Trepçës përmes partneritetit publiko-privat: mësimet nga përvojat e vendeve tjera

Në shkurt të vitit 2016 Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri i Kuvendit të Kosovës porosi nga ekspertët ndërkombëtarë të zhvillojnë gjashtë studime rastesh për të nxjerrë në pah përvojat e vendeve tjera sa i përket sektorit të minierave dhe restrukturimit si dhe përfshirjes së sektorit privat me një numër kompanish specifike të minierave. Këto studime rastesh u prezantuan në një seminar në Prishtinë më 6 qershor 2016.

Duke e parë si shumë të rëndësishme punën e bërë në këto gjashtë studime, Fondacioni e angazhoj profesorin e Universitetit Staffordshire, Iraj Hashi me qëllim që t'i përmbledhë këto gjashtë studime me synim të paraqitjes së mësimëve kryesore që mund të nxjerren nga përvoja e vendeve tjera: të zhvilluara siç është Kanadaja, Australia dhe Zelanda e Re, atyre në zhvillim si Turqia, si dhe vendeve të tranzicionit si Polonia dhe Bullgaria. Ky raport i ka përmbledhur të gjashtë rastet dhe pastaj ka nxjerrë disa përfundime të përgjithshme.

Përmbledhje e gjashtë Studimeve Rastesh

Gjashtë studime rastesh hynë në tri grupe, ku secili shpërfaq karakteristika të caktuara që janë relevante për Kosovën, dhe duhet të përmbledhen veç e veç.

1. Tri studimet e para, KGHM Polska Miedz (Polish Copper Co KGHM), KCM Plovdiv (Bullgari) dhe Eti Bank Group (Turqi) fokusohen në ndërmarrje individuale dhe restrukturimin e privatizimit të tyre. Ato analizojnë procesin e ristrukturimit (duke përfshirë edhe ndryshimet në pronësi) dhe atë të ndryshimit të performansës së ndërmarrjeve pas privatizimit të tyre.

2. Dy studime rastesh të Planit dhe Qasjeve të Kiubekut Verior sa i përket Industrisë Nxjerrëse në Australazi nuk merren me ndërmarrjet individuale që kalojnë nëpër procesin e ristrukturimit por analizojnë çështje më të përgjithshme të zhvillimit të industrive nxjerrëse dhe qasje të partneritetit publiko-privat të miratuara nga qeveritë e këtyre vendeve.

3. Studimi i fundit, Koza Altin Isletmeleri A.Ş., ofron një shembull se si ndërmarrja që kërkon financim të mëtejshëm mund të shesë aksione të ndryshme aksionarëve të vet dhe kështu aksionarët mund të kenë dy lloje aksionesh (me të drejta të ndryshme). Megjithëse të gjithë aksionarët gëzojnë të drejtën që t'u kthehen investimet e tyre, pjesëmarrja e tyre në vendim-marrje apo përparësia e tyre në kthimin e investimit të tyre në bazë të aksioneve mund të jetë e ndryshme. Aksionet mund të jenë me votë apo pa votë; mund të jenë aksione të rëndomta apo preferenciale; si dhe dallimet tjera.

Rjedhimisht, ne do t'i përmbledhim këto studime rastesh dhe do të nxjerrim mësimet kyçe për Trepçën në tri pjesë të ndara.

Pas shqyrtimit të gjashtë studimeve rastesh, janë nxjerr një varg mësimesh për revitalizimin e Trepçës si dhe disa opsione të Qeverisë së Kosovës. Të gjitha këto u prezentuan dhe diskutuan në tryezën e Forum 2015 «Çka pas ligjit: Sfidat, mundësitë dhe rreziqet», të mbajtur me 28 tetor. Panelistë në këtë tryezë ishin: Muhamet Mustafa – Kryetar i Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri; Nazmi Mikullovi - Drejtor i Trepçës në periudhat 1978-1984 dhe 2001-2008; Blerand Stavileci, Ministër i Zhvillimit Ekonomik dhe Iraj Hashi Profesor i Ekonomisë – Qendra për Hulumtime për Ekonomitë në Zhvillim, Shkolla e Biznesit, Universiteti Staffordshire.

Forum 2015 – Tryeza Një Don Kishotizëm Modern - Pse nuk ka Kosova strategji afatgjate energjetike?

Në kuadër të platformës së avokimit për studimet e investimeve kapitale, më 7 korrik është organizuar tryeza e Forum-it 2015, në të cilën është prezentuar dhe diskutuar analiza e punuar nga Fondacioni dhe Instituti Riinvest “Një Don Kishotizëm Modern - Pse nuk ka Kosova strategji afatgjate energjetike?”.

Ka kohë që Kosova gjindet vazhdimisht e sfiduar nga zhvillimi i sektorit energjetik në njerën anë dhe nga shumë tentativa, të pa-përfunduara, për të sjellë investues të jashtëm në këtë sektor,

në anën tjetër. Ka një dekadë që të gjitha forcat tona politike garojnë për të na treguar se e kanë zgjidhjen për këtë problem të madh zhvillimor të vendit, dhe ka po aq kohë, që këto forca politike, kur të vijnë në pushtet, tregojnë një pafuqi të plotë karshi kësaj sfide. Ajo që qytetarët kanë parë në këtë dekadë janë: (1) mungesë e njohurive elementare tekniko-teknologjike, por edhe sociale dhe mjedisore, për të sjellë një opcion të qëndrueshëm në këtë sektor, (2) mos-respektim i plotë i institucioneve demokratike të vendit gjatë hartimit dhe finalizimit të projekteve investuese, dhe (3) mungesë e mekanizmave që do të aplikoheshin te TEC-et e reja, për t'i siguruar vendit edhe levërdi ekonomike nga ky atak në resurset nëntokësore. Të gjitha këto munden të sillen së bashku me një emërues të përbashkët: Vendim-marrësit Kosovar në asnjë moment deri tash nuk e kanë pasur një vizion afatgjatë dhe të qartë të zhvillimit të këtij sektori në disa dekada të ardhshme, si parakusht i vetëm dhe i domosdoshëm për të planifikuar këto investime miliardëshe në vend.

Kjo ishte tema boshte e panelit të Forumit 2015, në të cilin ishin: Blerand Stavileci, Ministër - Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Libor Chlad, Zëvendës Shef i Seksionit për Bashkëpunim - Komisioni Evropian dhe Alban Hashani, Drejtor i Hulumtimeve - Instituti Riinvest.

Industria Nxjerrëse - EITI

Punëtorja, 24-25 qershor

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur, vazhdon angazhimin në industrinë nxjerrëse, të filluar para disa viteve. Me 24 dhe 25 qershor, në Durrës u mbajt punëtorja e dytë rreth Inicativës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI). Në të morën pjesë zyrtarë nga ministritë e ndryshme, agjencitë, rregullatorët, komisionet parlamentare, bizneset dhe pjesëtarë të organizatave të shoqërisë civile.

EITI është një standard global për qeverisje të vendeve me burime të naftës, gazit dhe mineraleve. Ai përfshinë çështjet kyçe që nga fillimi i nxjerrjes së pasurive natyrore nga toka, e deri te ndikimi i kësaj në mirëqenien e qytetarëve. Vendet që implementojnë EITI-n marrin obligimin të zbulojnë informacione lidhur me pagesat e taksave, licencat, kontratat, prodhimin, si dhe elementet tjera kyçe që lidhen me nxjerrjen e pasurive nëntokësore.

Standardi në fjalë mëton të promovojë menaxhimin e hapur dhe llogaridhënës të pasurive nëntokësore. Duke qenë se pasuritë natyrore të një shteti i përkasin qytetarëve të tij, nxjerrja e këtyre pasurive do të duhej të pasohej nga zhvillimi ekonomik dhe shoqëror. Mirëpo, qeverisja e dobët e pasurive natyrore shpeshherë rezulton në korrupsion dhe konflikte. Për këtë, me rritjen e transparencës dhe kujdesit të shtuar publik ndaj industrisë nxjerrëse sigurohet përfitimi sa më gjithëpërfshirës i të gjithë qytetarëve.

Kursi dyditor i organizuar nga Eurasia Hub bashkë me Fondacionin e Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) i ka njoftuar pjesëmarrësit me standardet kryesore të zbulimit të informacioneve,

me kërkesat për transparencë në derivate, gazra dhe sektorë të përfshirë në Standardin e EITI-së si dhe me praktikat më të mira në krijimin e një grupi me shumëpalësh të interesit (MSG) për mbikëqyrjen e zbatimit të EITI-së.

Ky standard implementohet nga qeveritë, në bashkëpunim me bizneset dhe shoqërinë civile.

Është vënë kontakti me Sekretariatit e EITI në Oslo, për të filluar procesin e plotësimit të disa kritereve bazë, të nevojshme për fillimin e procesit të anëtarësimit të Kosovës në EITI. Ministria e Zhvillimit Ekonomik është zotuar që të marr përsipër obligimet që duhet t'i ketë qeveria në këtë proces. EuroAsia Hub, partner i Fondacionit vazhdon të jap këshilla dhe përcaktojë prioritetet për të qenë në rrugë të duhur dhe të punohet paralelisht në: negociatat me Oslon, ngritje e kapaciteteve të hisedarëve kyq si dhe informimin e qytetarëve për benefitet të cilat do t'i ketë Kosova nga anëtarësimi në EITI.

Në dhjetor Euro Asia Hub e ka punuar draftin e parë të studimit të fisibilitetit, i cili do të diskutohet me MZHE dhe do të punohet deri në draftin final.

Festivali i Filmit Dokumentar – Dokufest

Edicioni XV i Dokufestit 2016 u mbajt nga 5 deri më 13 gusht, duke ofruar përsëri një varg filmash të shkurtër dokumentarë, dhe duke tubuar producentë e regjisorë nga mbarë bota për të treguar rrëfimet e tyre, për të shfaqur filmat, dhe për të dhënë kontribut temës së festivalit e cila kishte të bënte me korrupsionin.

Dokufest është mbështetur nga dy programet e Fondacionit, ai i Transparencës dhe Llogaridhënies dhe i Integritimit Evropian. Për Fondacionin kjo ishte edhe një mundësi e vlefshme për të ndërtuar ura ndërmjet shoqërisë kosovare dhe shoqërive të vendeve të Bashkimit Evropian dhe atyre të rajonit të cilat ende nuk e kanë njohur Kosovën. Festivali edhe njëherë shërbeu si ngjarje e shkëlqyeshme për aftësinë e tij për të krijuar imazh pozitiv për vendin i cili ballafaqohet me vështirësi në aspektin e shtetndërtimit dhe procesit të integritimit evropian. Prandaj, për vitin e katërt me radhë Fondacioni me sukses solli disa gazetarë për të marrë pjesë në festival, për të mësuar për Kosovën dhe për të shkruar storie për mediumet e tyre përmes së cilave do ta informonin publikun e tyre për Prizrenin dhe Kosovën si nikoqirë të Festivalit Ndërkombëtar të Filmit Dokumentar.

Në anën tjetër, mbështetja e luftës kundër korrupsionit është njëra prej vlerave kyçe të strategjisë shumëvjeçare të veprimtarisë së Fondacionit. Kështu, festivali prezentoj një platformë të shkëlqyeshme për ta shtyrë përpara zbatimin e qëllimeve strategjike të Fondacionit që kanë të bëjnë me mbështetjen e luftës kundër korrupsionit dhe krijimin e lidhjeve ndërmjet shoqërisë kosovare dhe shoqërive të vendeve që nuk e kanë njohur Kosovën.

Për arritjen e këtyre qëllimeve, Fondacioni organizoi:

- Vizita të gazetarëve dhe aktivistëve të mediave nga 8 vendet që nuk e kanë njohur Kosovën;
- Panele diskutimesh në lidhje me aspektet e ndryshme të korrupsionit;
- *Stand-up* komedi me Dardan Islamin;

Panele diskutimesh mbi aspektet e ndryshme të korrupsionit

Fokusi i festivalit në çështjet e korrupsionit sivjet prezentoj platformë unike për të eksploruar aspekte të ndryshme të kësaj dukurie si dhe ndikimin që ai ka në jetën e njeriut në përgjithësi. Koleksioni i pasur i Fondacionit me studime, animacione, dokumentarë dhe mbështetje për shoqërinë civile e pasuruan një segment të veçantë të festivalit të sivjetëm. Ideja fillestare e Fondacionit për të organizuar një panel diskutimi duke shfaqur animacione dhe projekte në lidhje me korrupsionin dhe infrastrukturën publike prodhoi një bashkëpunim edhe më të gjerë me vetë organizatorët e festivalit dhe rezultoi me organizimin e pesë paneleve të ndara diskutimesh, si pjesë e segmentit Dokutalk të këtij festivali. Rrjedhimisht, çdo pasdite vizitorët, qytetarët, regjisorët, gazetarët dhe publiku i gjërë patën mundësi të bashkëbisedonin me aktivistë vendorë, rajonale e ndërkombëtarë në lidhje me praktikën korruptive në fushat e ndryshme të jetës. Temat e shtjelluara përmes segmentit Dokutalk ishin: (1) Pushteti, korrupsioni dhe gënjeshtria, (2) “Trajtoje me kujdes! Është pronë e qytetarëve” (3) Qeverisja dhe mosndëshkueshmëria (4) Rrebelimi i përditshëm (5) Mediat dhe teknologjia (6) Nga para në pas.

Diskutimet ishin interaktive dhe nxitën bashkëbisedime energjike ndërmjet panelistëve dhe publikut. Por, për ta nxitur edhe më tutje karakterin e tyre interaktiv të diskutimeve Fondacioni shfrytëzoi mini-kuize në fillim të çdo diskutimi. Duke përdorur pajisjet e saj për komunikim interaktiv me publikun e gjerë Fondacioni shtjelloi dy çështje që kanë të bëjnë me temën e diskutuar dhe opinionet e publikut. Mini-kuizin e zhvilloi Dardan Islami, komedian i zhanrit stand-up.

Stand-up komedia Si N’fore

Për herë të parë në Dokufest dhe në Prizren, publiku pati mundësi të ndjekë një komedi të zhanrit stand-up. Dardan Islami, komedian i njohur nga Prishtina u ftua në Prizren, dhe duke u nisur nga rezultatet e mini-kuizeve, performanca u shfaq në mbërmjen e 22 gushtit. Kjo performancë mbledhi numër të madh të pjesëmarrësve dhe u mbajt në oborrin e Lidhjes së Prizrenit. Duke u mbajtur në hapësirë të hapur, ajo simbolizoi natyrën e luftës kundër korrupsionit dhe nevojën për të diskutuar hapur për çështjet e tilla, duke shtjelluar gjithashtu praktikat të cilat vazhdojnë t’i shqetësojnë qytetarët edhe sot e kësaj dite.

Punëtoritë – Shoqëria Civile dhe sfidat e skenës politike

Të sfiduar nga skena politike e cila gjatë vitit prodhoj shume paqartësi dhe momente konflikti të cilat i paralizuan një pjesë të madhe të institucioneve demokratike të Kosovës, Fondacioni mbledhi liderët e organizatave jo-qeveritare më të rëndësishme për të debatuar e më vonë edhe hartuar një plan konkret që pozicionon organizatat e shoqërisë civile për të marr një rol konstruktiv në situatat e krijuara. Këto dy punëtori sollën shumë debate interesante të cilat më vonë u formësuan në një plan strategjik veprimi.

Lista e projekteve të organizatave të cilat janë mbështetur në shtyllën Privatizimi dhe Investimet Kapitale

Emri i Projektit	Grantist	Shuma Euro
Punëtorja: Avokimi për analizat në investimet kapitale	Operacional	5,435
Forumi kombëtar për shkëmbimin e eksperiencave mbi qeverisjen e hapur	Instituti Riinvest	5,000
Përmbledhja e 6 rasteve studimore për Trepçën dhe rekomandimet	Strafoedshire Institute	4,510
EITI punëtorja 24-25 qershor	Operacional	16,180
Trajnime të gazetarëve të cilët punojnë në projekte humltuese për procesin e privatizimit dhe investimeve kapitale	Klan Kosova	3,000
Dokufest – realizimi i tryezave me temë Korrupcioni	DokuFest	10,700
Stand-up komedi në kuadër të Dokufest	DokuFest	3,684
Organizimi i aktiviteteve në kuadër të Dokufestit	EC Ma Ndryshe	1,250
Punëtorja - Edukimi i Lartë	Operacional	5,345
Punëtorja I – Shoqëria Civile dhe sfidat e skenës politike	Operacional	6,362
Punëtorja II - Shoqëria Civile dhe sfidat e skenës politike	Operacional	5,133
EITI meeting , Baku	Operacional	6,212
Shpenzime tjera programore		13,303
	Total :	86,114

Transparenca e Komunave

EC Ma Ndryshe: Transparenca e planifikimit hapësinor në Prizren

Qëllimi i projektit është të ndihmojë përmbushjen e obligimeve të Kartës për Hapjen e të Dhënave, përmes hapjes së të gjitha të dhënave dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor në komunën e Prizrenit, për rritjen e nivelit të llogaridhënies publike në njërin ndër sektorët më jotransparent dhe të përfolur për keqpërdorime në Kosovë.

Aktivitetet e realizuara

Projekti ka filluar së zbatuari më 1 Nëntor 2016, ndërsa gjatë periudhës raportuese (dy muajt e parë) janë realizuar (dhe vazhdojnë të realizohen) këto aktivitete:

- Dokumentimi i të gjitha dokumenteve dhe të dhënave të planifikimit hapësinor
- Grumbullimi dhe arkivimi i të gjitha dokumenteve dhe të dhënave të planifikimit hapësinor (komunë dhe Qeveri) (aktivitet në vazhdim)
- Monitorim i rregullt i autoriteteve lokale dhe qendrore të planifikimit hapësinor (aktivitet në vazhdim).

Një bazë e të dhënave (dokumente elektronike dhe linqe) me dokumentet e planifikimit hapësinor (ligjet qendrore, aktet nënligjore, strategjitë sektorale, rregulloret komunale, dokumentet e zhvillimit strategjik komunal planet rregulluese, hartat dhe të tjera) është krijuar. Paralelisht, në dakordim me Drejtorinë e Urbanizmit të Komunës së Prizrenit, zyrtarët e kësaj drejtorie kanë filluar grumbullimin dhe arkivimin e lejeve ndërtimore. EC ka kontaktuar edhe me autoritetet e trashëgimisë kulturore (Departamenti i Trashëgimisë Kulturore në MKRS, Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Prizren, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve, Këshilli për Trashëgimi Kulturore i Prizrenit për t'i siguruar të gjitha pëlqimet dhe rekomandimet e lëshuara për Qendrën Historike të Prizrenit dhe zonat e trashëgimisë kulturore. Paralelisht, projekti ka siguruar monitorim të rregullt të autoriteteve lokale dhe qendrore të planifikimit hapësinor dhe gjatë periudhës së raportimit janë publikuar katër komunikata me të gjeturat e monitorimit.

Tre mujori i parë i vitit 2017

Gjatë tre muajve të parë të vitit 2017 do të realizohen këto aktivitete të projektit:

- Grumbullimi dhe arkivimi i të gjitha dokumenteve dhe të dhënave të planifikimit hapësinor (komunë dhe Qeveri) (vazhdon nga dy muajt e parë)
- Kontraktimi i kompanisë së IT për krijimin e platformës online

- Monitorim i rregullt i autoriteteve lokale dhe qendrore të planifikimit hapësinor (aktivitet në vazhdim).

OJQ Iniciativa Qytetare e Skenderajt: Aktivizim qytetarë – Qeverisje e përgjegjshme

Në kuadër të periudhës tremujore (tetor, nëntor, dhjetor 2016), OJQ Iniciativa Qytetare Skenderaj (IQS), ka zhvilluar një mori aktivitete. Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti është të jap kontribut në forcimin e qeverisjes lokale në komunën e Skenderajt, nëpërmjet avokimit për zbatim të mekanizmave ligjor dhe avancim të demokracisë lokale.

Aktivitetet e zhvilluara gjatë kësaj periudhe:

- **Monitorimi i seancave të Kuvendit Komunal të Skenderajt.** Janë monitoruar tri seanca të rregullta të Asamblesë, me qëllim të mbikëqyrjes së procedurave të mbledhjeve dhe zbatimit të Rregullores së Punës së Kuvendit Komunal. Në këto mbledhje, Kuvendi ka nxjerr përkatësisht ka miratuar gjithsej 10 vendime dhe rregullore komunale. Gjatë kësaj kohe nuk janë vërejtur shkelje procedurale apo statusore me përjashtim të disa shkelje të vogla të Rregullores së Punës. Kuvendi ka mbajtur edhe një mbledhje të jashtëzakonshme, në kuadër të kësaj periudhe.
- **Monitorimi i mbledhjeve të Komitetit për Politika dhe Financa.** Ekipi monitorues ka monitoruar edhe takimet e rregullta të njërit prej komiteteve më të rëndësishme, Komiteti për Politika e Financa. Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur 3 takime të tilla.
- **Debatet publike.** Në fazën e parë të periudhës 3 mujore është mbajtur debati i parë me publikun, në të cilin kanë marrë pjesë përfaqësues të autoriteteve lokale, shoqëria civile, përfaqësues të fshatrave dhe të tjerë, me të cilët është diskutuar për përfshirjen e qytetarëve në hartimin e politikave buxhetore. Duke qenë se në të kaluarën pjesëmarrja qytetare në dëgjimet buxhetore ka qenë shumë e vogël, në këtë debat është diskutuar dhe janë nxjerr disa rekomandime për format e ngritjes së nivelit të pjesëmarrjes qytetare në këto dëgjime.
- **Radio debatet.** Janë mbajtur edhe 2 radio emisione në radion lokale (Radio Drenica), ku të ftuar kanë qenë zyrtarë nga Drejtoria për Ekonomi dhe Financa, me të cilët është diskutuar për shpenzimin e buxhetit publik për periudhën 9 mujore 2016, dhe drejtori i Shërbimeve Publike, ku është diskutuar për gatishmërinë dhe masat e ndërmarra për të përballuar situatat eventuale emergjente dhe mirëmbajtjen e rrugëve.

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI): Sistemi i prokurimit të Kosovës; Analizë: Sfidat dhe mundësitë e avancimit

Ky projekt pati për qëllim hulumtimin e mangësive në zbatim të legjislacionit dhe analizimit të akterëve kyç të sektorit të prokurimit në Kosovë që do të çonin në ofrimin e të dhënave të hapura në prokurimin elektronik duke krahasuar përvojat e rajonit dhe Evropës Qendrore.

Produkti përfundimtar është raporti i përpiluar nga KDI në bazë të hulumtimit dhe gjetjeve, dhe i cili do të trajtoj analizimin e strukturës së institucioneve të prokurimit publik dhe disa nga sfidat kryesore të tyre. Aspekte tjera të analizuara janë: vlerësimi i rrezikut kundër korrupsionit; shkaktarët kryesor të keq-menaxhimeve duke analizuar raportet e Auditorit të Përgjithshëm për Qeverinë dhe Komunat; vlerësimi i menaxhmentit dhe efektivitetit të sistemit të prokurimit si dhe mekanizmave të llogaridhënies dhe zbatimit të legjislacionit, analiza e ndryshimeve në ligjin e prokurimit dhe legjislacionin sekondar; analiza e zbatimit të prokurimit elektronik (e-prokurimit) dhe një krahasim me prokurimet elektronike evropiane, si dhe dhënia e rekomandimeve për pikat kritike në zbatimin e një prokurimi publik efektiv dhe eficient.

KDI ka konstatuar se tri (3) barrierat kryesore në procesin e prokurimit publik janë: 1) vlerësimi dhe planifikimi i dobët i nevojave; 2) mangësitë dhe parregullsitë në përgatitjen e specifikimeve teknike për dosjen e tenderit; dhe, 3) menaxhimi i dobët i zbatimit të kontratës (duke përfshirë kohën e dorëzimit dhe pagesat).

Tri institucionet kryesore publike që janë përgjegjëse për zbatimin e ligjit dhe funksionimin e përgjithshëm të sistemit të prokurimit publik në Kosovë janë ballafaquar me sfida të ndryshme. KRPP-ja ka mungesë të kapacitetet njerëzore dhe buxhetin e nevojshëm për të kryer monitorimin e plotë të dhënies së kontratave për të gjitha autoritetet kontraktuese dhe gjithashtu procesin e zbatimit të kontratave, AQP është themeluar në vitin 2011, por ka filluar të kryejë veprimtari të përbashkëta të prokurimit vetëm në vitin 2014, dhe vazhdon të përballet me trysni të ndryshme në ushtrimin e detyrës si dhe OSHP është përmendur gjerësisht si institucioni më i korruptuar në fushën e prokurimit publik.

Nga testimi i faqes së prokurimit elektronik, por edhe nga intervista me operator ekonomik, kjo platformë ende ballafaqohet me probleme të ndryshme teknike, dhe për këtë arsye, operatorët ekonomikë preferojnë të dorëzojnë tenderët fizik. Gjithashtu kjo platformë nuk ofron rritje të transparencës për publikun, por ofron një rritje të vogël vetëm për operatorët ekonomik, të cilët gjatë shprehjes së interesimit për të shkarkuar dosjen e tenderit, mund të shohin vlerën e parashikuar të kontratës.

Hapja e të dhënave në Kosovë mbetet një temë e dëshiruar, meqë duke e krahasuar me shtetet e rajonit, Prokurimi Publik i Kosovës mbetet më i mbylluri, dhe ndër të vetmit ku qasja është e garantuar vetëm përmes ligjit për qasje në dokumente publike përmes parashtrimit të një kërkesë formale.

Lista e projekteve të organizatave të cilat janë mbështetur në shtyllën Transparenca e Komunave

Emri i Projektit	Grantist	Shuma Euro
Aktivizim qytetar – Qeverisje e përgjegjshme	Iniciativa Qytetare Skenderaj	8,550
Sistemi i Prokurimit të Kosovës – Analizë: Sfidat dhe mundësitë e avansimit	Instituti Demokratik i Kosovës	4,500
Transparenca e planifikimit hapësinor në Prizren	Emancipimi Civil – EC Ma Ndryshe	18,900
Shpenzime tjera programore		8,375
	Total :	40,325





PLARFORMA VET-AVOKUESE E KOMUNITETEVE RAE

Platforma vet-avokuese e komuniteteve RAE

Prapavija

Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian edhe përkundër interesimit dhe investimeve të mëdha, pikë së pari nga donatorët dhe organizatat ndërkombëtare, mbesin komunitetet në pozitën më të vështirë sociale dhe ekonomike dhe më të marginalizuarat në shoqërinë kosovare. Është e tepërt të thuhet se mungesa e vullnetit politikë ndikoi që Strategjia dhe Plani i Veprimit për integrim të komuniteteve RAE 2009-2015 ka ndikua që ajo të mbetet vetëm pjesërisht dhe ad hoc e zbatuar. Qeveria nuk tregoi udhëheqësi në këtë proces ndërsa OJQ-t e komuniteteve ishin ato që morën iniciativë dhe përmes donatorëve siguruan pjesën më të madhe të buxhetit për zbatim të disa nga aktivitetet të parapara për realizim të objektivave të RAE Strategjisë dhe planit të veprimit të saj. Ky zavendësim i roleve, ku OJQ-t morën rolin kryesor në zbatim të Strategjisë ndërsa qeveria ishte pasive, ndikoj edhe në mungesë të fushatave të fuqishme avokuese civile për kërkim të llogaridhënies dhe përgjegjësisë institucionale lidhur me avancimin e pozitës, respektimin e të drejtave të komuniteteve RAE dhe obligimeve që institucionet kanë karshi legjisllacionit dhe strategjive të veta të aprovuara.

Fushatat e pakta avokuese mbetën të pa vërejtura dhe pa dëgjua nga vendimmarrësit për shkak të mungesës së përvojës të organizatave të shoqërisë civile të komuniteteve RAE për të argumentuar kërkesat e vet por gjithashtu edhe për shkak të dështimit të tyre për të krijuar marrëdhënie më të ngushtë dhe mobilizimit të komuniteteve me qëllim të amplifikimit të zërit të tyre deri në përmbushje të kërkesave të tyre.

Nga viti 2014 e deri në fund të vitit 2016 fondacioni bëri përpjekje që përmes konceptit Platforma vet-avokuese e komuniteteve RAE të ndryshoj skenën dhe mënyrën e avokimit të komuniteteve. Këtë e bëri duke: (1) mobilizuar grupe të Rinjëve RAE në 6 komuna të Kosovës, (2) përkrahur iniciativa avokuese të OJQ-ve dhe (3) duke përkrahur mediat e komuniteteve RAE për të raportuar dhe përkrahur grupet e Rinjëve dhe OJQ-t në fushatat e tyre avokuese.

Gjatë vitit 2016 u fillua me zbatim edhe të dy projekteve me fonde të palëve të treta (EU dhe KKS). Të dy projektet për synim parësorë kanë integrimin dhe ngritjen e pjesëmarrjes së komuniteteve RAE në sistemin arsimor. Përpos kësaj komponente kryesore të dy këto projekte kanë edhe komponente rrjetëtuese dhe avokuese të cilat u disajnuan mu me qëllim të sigurimit të vazhdueshmërisë së iniciativave të nisura në kuadër të konceptit Platforma vet-avokuese e komuniteteve RAE dhe frymës së aktivizimit dhe avokimit përtej vitit 2016.

Qëllimi i konceptit, objektivat dhe aktivitetet e parapara për 2015

Nëpërmjet të këtij koncepti, Fondacioni, **synon** të mbështes krijimin dhe rritjen e aftësive avokuese të Organizatave të Shoqërisë Civile dhe aktivistëve të Rinjë Romë, Ashkali dhe Egjiptianë me qëllim të adresimit dhe zgjidhjes së problemeve me të cilat përballen komunitetet në nivel lokal dhe qendror.

Për të arritur qëllimin e konceptit Fondacioni dizajnoj **objektivat** dhe **aktivitetet** e ndërlidhura mirë si në vijim:

1. Vlerësimi i nevojave të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, identifikimi i individëve, OShC-ve dhe fushatave për avokim dhe programi i ngritjes/zhvillimit të kapaciteteve avokuese të OShC-ve dhe individëve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian,
2. Zbatimi i fushatave avokuese të zbatuara nga OShC-t dhe aktivist të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian dhe,
3. Inkuadrimi dhe fuqizimi i mediave në fushatat avokuese.

Për të përmbushur objektivat e konceptit, Fondacioni në 2016 mbështeti:

- **Organizatave e shoqërisë civile** për të zbatuar fushata avokuese për çështje më me rëndësi dhe emergjente për komunitetet e veta gjatë së cilit proces u zhvilluan edhe më tej shkathësitë e tyre avokuese;
- **Grupet e të Rinjëve Rom, Ashkali dhe Egjiptian** në 6 komuna të Kosovës si formë e re e aktivizmit dhe vet-avokimit në nivel lokal;
- **Mediat e komuniteteve** të cilat gjatë gjithë kohës përcjellën punën e OShC-ve, grupeve të të Rinjëve por edhe ngritën vet çështje me relevancë dhe në këtë mënyrë shpesh herë edhe nxitën OJQ-t dhe individët të reagojnë.

Gjatë vitit 2016 janë realizuar:

- 7 punëtorë për OShC-t dhe aktivistë të Rinjë të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian përmes së cilave janë identifikuar çështjet për avokim, përcaktuar format e avokimit, dhe janë zhvilluar kapacitetet avokuese të pjesëmarrësve;
- Janë rritur aftësitë avokuese të më shumë se 70 përfaqësuesve të OShC-ve dhe të Rinjëve aktivistë përmes punëtorëve, trajnimeve, vizitave shkëmbimore në mes të Kosovës dhe Shqipërisë;
- Janë formuar dhe stabilizuar 6 grupe aktivistësh dhe avokuesish të Rinjë në 6 komuna të cilat tashmë kanë një agjendë pune të formësua;
- 17 emisione debatuuese REACT dhe 9 reportazhe mbi punën e grupeve të aktivisteve

dhe avokuesve të Rinjë;

- Janë ndarë 8 grante për fushata avokuese për çështje të ndryshme që preokupojnë komunitetet RAE.

Identifikimi i çështjeve, nevojave dhe lokacioneve për fushata avokuese

Identifikimi i çështjeve, nevojave dhe përcaktimi i lokacioneve për fushata avokuese janë bërë përmes takimeve individuale, punëtorive me OJQ-t, grupeve joformale të aktivistëve të Rinjë dhe vizitave në terren. Gjatë vitit 2016 janë organizuar 7 punëtori, prej të cilave 4 ishin punëtori për aktivistët të Rinjë të cilat i fasilitoj konsulenti për aktivizëm nga Shqipëria dhe gjatë së cilave mbi 35 të Rinjë të komuniteteve RAE përfituan edhe nga trajnimet dhe ligjeratat mbi (a) shkathtësitë e komunikimit me publikun, b) funksionimin e skemës sociale dhe c) institucionet qeverisëse dhe të drejtat qytetare në nivel lokal.

Përveç punëtorive të organizuara me aktivistë të Rinjë fondacioni organizoi edhe tri punëtori tjera të cilat shërbyen që të bëhet ndërlidhja në mes të dy projekteve të palëve të treta (BE dhe KKS), për të siguruar bashkëpunim dhe ko-financim nga komunat për lokacionet ku këto projekte zbatohen dhe për të gjetur modalitetet e bashkëpunimit në mes të OJQ-ve partnere në projektet e palëve të treta dhe grupeve të aktivistëve dhe avokuesve të rinjë.

Punëtoritë me aktivistë dhe avokues të rinjë realizuan objektivat e veta ku të Rinjë të bëjnë planifikimet për iniciativat e veta, shkëmbyen eksperiencat në mes veti dhe me aktivistë nga Shqipëria dhe krijuan lidhje me OJQ partnere të projekteve të palëve të treta në mënyrë që pas përfundimit të konceptit, në fund të vitit 2016, të vazhdojnë angazhimin e tyre në kuadër të këtyre projekteve dhe të bëhen pjesë e tyre.

Punëtoritë e realizuara me OJQ, zyrtarë komunalë nga 10 komuna dhe aktivistë të rinjë arritën që të sigurohet një bashkëpunim më i ngushtë në mes të OJQ-ve partnere në projektet e palëve të treta në mes të tyre dhe zyrtarëve komunalë dhe aktivistëve të Rinjë.

Lista e granteve/shpenzimeve:

Projekti/iniciativa	Grant marrësi	Shuma
Punëtorja me aktivistë të rinjë, 12-13 mars, 2016, Prishtinë	Operacionale	2 850,00 €
Punëtorja me aktivistë të rinjë, 20-21 maj, 2016, Prishtinë	Operacionale	2 581,70 €
Punëtorja me aktivistë të rinjë, 1-3 korrik, 2016, Durrës	Operacionale	6 174,62 €
Punëtorja me zyrtarë komunal, OJQ dhe aktivistë të rinjë, 16-19, korrik, 2016 Durrës	Operacionale	7 238,75 €
Punëtorja me aktivistë të rinjë, 9-10 shtator, 2016, Prishtinë	Operacionale	2 263,00 €
Punëtori e shkëmbimit të eksperiencave në mes të aktivistëve të rinjë nga Kosova dhe Shqipëria, 2-4 dhjetor, 2016, Bogë	Operacionale	3 069,25 €
Punëtori mbi aktivizmin dhe avokimin e projektit Prospect +, 10-13 dhjetor, 2016	Operacionale	500,00 €

Zbatimi i fushatave avokuese të zbatuara nga OSHC-t dhe aktivist të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian

Në vitin 2016 u vazhdua avokimi për disa nga çështjet e iniciuara që nga viti 2014 dhe 2015 por edhe u realizuan fushata avokuese të reja.

Fushata e nisur në 2014 për **hapje të kodit të veçantë buxhetorë** për zbatim të planit lokal të veprimit të komunës së Prizrenit u realizua dhe ky kod u hap në vitin 2015. Komuna e Prizrenit ndau një buxhet prej 20 000 € për zbatim të planit të vet të veprimit dhe gjatë vitit 2016 u vazhdua me fushatë në këtë temë por e fokusuar më shumë në transparencë të shpenzimeve të bëra në emer të zbatimit të planit lokal të veprimit në këtë komunë.

Një fushatë tjetër e filluar në vitin 2015 për **njohjen e gjuhës Rome si gjuhë tradicionale** në komunën e Prizrenit përkundër presionit të madh të OJQ-ve dhe komuniteti nuk arriti të realizohet as gjatë vitit 2016. Pa marrë parasysh, OShC-t dhe komuniteti janë të vendosur që këtë çështje ta shtyjnë përpara edhe në vitet në vijim. Kjo fushatë do të vazhdoj pa financim nga ana e KFOS në vitin 2017. Aktivitetet në këtë drejtim do të vazhdojnë në bazë vullnetare të komuniteteve dhe OJQ-ve.

Fushata avokuese për **lirim nga pagesa për shërbimet shëndetësorë** të pjesëtarëve të komuniteteve RAE në komunën e Prizrenit dhe **lehtësimi i futjes në skemë sociale** të atyre të cilët i përmbushin kriteret e vendosura me ligj ishte edhe një prej çështjeve për të cilat avokuan organizatat e komuniteteve RAE Nevo Koncepti dhe Durmish Aslano nga Prizreni.

tri viteve punë fitoi epilogun e vet i cili nuk ishte ai i dëshiruari në fillim por përsëri mund të quhet sukses. Qëllimi i Kësaj ndërhyrje ishte që Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë të marr përsipër mbështetje dhe njohjen e programeve arsimore që zbatohet nëpër qendrat e komuniteteve dhe në këtë mënyrë të sigurojnë kualitet dhe harmoni me plan programet arsimi të rregullt shkollor. Në këtë iniciativë u përfshinë më se 10 OJQ të cilat zbatojnë programe mësimore shtesë në më se 45 lokacione anë e mbanë Kosovës. Dështimi për ta realizuar këtë qëllim ndodhi për shkak të agjendave dhe interesave të ndryshme të OJQ-ve të përfshira. Pa marrë parasyshë kjo pikë, hartimi i një urdhërese administrative për njohje të programeve shtesë të ofruara pr nxënësit e komuniteteve RAE u fut si një ndër pikat tll cilat duhet zbatuar menjëherë pas aprovimit të Strategjisë së re të qeverisë së Republikës së Kosovës për respektim të të drejtave to komuniteteve RAE 2017-2021.

Riintegrimi i pjesëtarëve të kthyer të komuniteteve RAE nga shtetet e Evropës perëndimore ishte edhe një çështje për të cilën u avokua gjatë vitit 2016. Në këtë fushatë i bashkuan forcat Qendra Rome dhe Ashkali për Dokumentim dhe Society for Threatened People nga Gjermania. Kërkesa e shtruar në një tryezë të rrumbullakët dhe takime me zyrtarë të qeverisë, Ministrinë e Punëve të Brendëshme dhe organizatat ndërkombëtare në Kosovë ishte lehtësimi dhe shpejtimi i procedurës për aprovim të përkrahjes financiare dhe sigurimit të banimit për familjet e kthyer të komuniteteve RAE. Kjo iniciativë arriti të fitoj vetëm premtim se procedura do të lehtësohet dhe se sygjerimit do të merren parasyh gjatë procesit të përditësimit të planit të veprimit për riintegrim të personave të riatdhesuara. E tërë fushata u bazua në studimin detal të punuar nga ekspertët e Society for Threatened People të ndihmuar nga RADC.

Grupet e aktivistëve dhe avokuesve të rinj gjatë vitit 2016 ishin shumë aktiv dhe adresuan një mori çështjesh me relevancë për komunitetet e tyre në lokacionet ku ata banojnë. Ishin sidomos të angazhuar dhe arritën shumë sukses në mobilizimin e komuniteteve nëpër lagje të ndryshme të komunave ku ata veprojnë. Përfshirja e komuniteteve në fushatat e tyre avokuese ishin një nga pikat kyçe për arritje të suksesit. Ajo që vlerësohet shumë është se komuniteti nuk mbeti pasivë duke pritur që problemet e tyre të zhgjishen vet, vetiu por u inkuadruan dhe në këtë mënyrë dëshmuar se të organizuar mund të arrijnë më shumë. Fryma e vet-organizimit dhe vet-avokimit iu mbjell edhe pjesëtarëve të komuniteteve të cilët nuk ishin kurrë të angazhuar në ndonjë nga organizatat e shoqërisë civile.

Grupet e të rinjëve aktivistë dhe avokues gjatë vitit 2016 në bashkëpunim të ngushtë me komunitetet në lagjet ku patën ndërhyrje realizuan rezultate si në vijim (1) arritën shtrimin rrugëve me zhavor apo asfalt në 9 lokacione, (2) marrëveshje me kompani të pastrimit në 4 komuna për pastrim të lagjeve dhe vendosje të konteinerëve, (3) lidhjen në sistem të ujësjellësit të 5 lagjeve, (4) ngritën çështjen e banimit për 22 familje të pastrehë në fshatin Dubravë të Istogut dhe 2 familje të cilave i është djegë konteineri në lagjen Jeta e Re në komunë të Prizrenit, (5) identifikuan dhe ndihmuan afër 40 familje të cilat plotësojnë kriteret për asistencë sociale, dhe shumë çështje tjera si ndriçimi rrugorë, transporti për nxënës që banojnë largë objekteve shkollore, etj. Grupet kanë krijuar edhe nj faqe të vet në FB ku postohen të gjitha aktivitetet e tyre si dhe alarmohet opinioni për rastet e hasura në terren. Kjo faqe përcjelllet nga më se 1000 persona.

Grupet e formuara të të rinjëve aktivistë dhe avokues tani janë grupe mirë të formuara dhe stabile. Nga viti 2017 do të përfshihen në aktivitetet avokuese dhe të rrjetëzimit të projekteve të palëve të treta. Gjithashu, grupet vendosën që të regjistrojnë edhe një OJQ e cila do të vazhdoj të promovoj dhe punoj në frymen e re të aktivizmit dhe vet-avokimit të cilën e përvetësuan në 3 vitet e fundit të angazhimit të fondacionit në ngritjen dhe zhvillimin e shkathësive të tyre të aktivizmit dhe vet-avokimit. Kjo organizatë u themelua me iniciativë të 6 anëtarëve të grupeve dhe do të përfshijnë të gjithë anëtarët tjerë duke u munduar ta mbajnë frymen e njejtë ta aktivizmit dhe avokimit.

Si përfundim në përgatitje është edhe një publikim përmes së cilit do të shpaloset fryma e re e aktivizmit dhe avokimit e cila do të ndihmoj pjesëtarët e 6 grupeve të themeluara, të rinjtë tjerë dhe OJQ-t që të vazhdojnë punën në të formë të njejtë apo të ngjashme të aktivizmit dhe avokimit për zgjidhje të problemeve me të cilat përballen komunitetet RAE. Ky publikim përpos karakterit edukativë do të shërbej edhe për promovim të punës së grupeve të themeluara në kuadër të konceptit dhe të metodologjisë së re të vet-avokimit.

Lista e granteve/shpenzimeve:

Projekti/iniciativa	Grant marrësi	Shuma
Avokim për përmirësim të politikave për riintegrim të komuniteteve RAE të khtyer në Kosovë nga Evropa perëndimore	Qendra Rome dhe Ashkali për Dokumentim në bashkëpunim me Society for Threatened People	4 205,00 €
Avokimi për përmirësimin e zbatimit të politikave lokale për mbrojtjen e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në komunën e Prizrenit	Nevo Koncepti	7 930,00 €
Së bashku për një jetë më të mirë	Grupi i aktivistëve të Gjakovës	5 354,75 €
Avokimi dhe ndërmjetësimi për ndryshim	Grupi i aktivistëve të Istogut	5 307,75
Të rinjtë e komuniteteve në aksion	Grupi i aktivistëve të Pejës	5 264,75 €
Të rinjtë e Fushë Kosovës në aksion	Grupi i aktivistëve të Fushë Kosovës	4 230,00 €
Vet për ndryshim	Grupi i aktivistëve të Prizrenit	4 525, 85 €
Të Rinjtë e Suharekës avokojnë	Nevo Koncepti	2 135,00 €
Avokimi për përmirësimin e zbatimit të politikave lokale për mbrojtjen e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në komunën e Prizrenit	Durmish Aslano	2 000,00 €
Vet-avokimi për ndryshim të pozitës së komuniteteve RAE	Ec vet	5 500,00 €
Publikim mbi frymën e vet-avokimit komunitarë dhe të arriturat e grupeve të aktivistëve të rinj	Operacionale	3 400,00 €

Inkuadrimi dhe fuqizimi i mediave në fushatat avokuese

Emisioni REAGO, për produksion të së cilit u angazhua organizata Romtegra në vitin 2016 hyri në vitin e dytë të transmetimit në RTK2 në termin të fiksuar dhe në RTK1 në rastet kur ky kanal ka mundësi të ofroj kohë shtesë për programet e komuniteteve.

Për ndryshim nga viti i kaluar, emisioni REAGO filloi të prodhoj emisione dy herë në muaj dhe arriti të ketë shikueshmëri shumë më të madhe se në fillimet e saj. Ky emision i jep komuniteteve hapsirë më të madhe mediale për të ngritur çështjet që i brengosin dhe të ballafaqohen me vendimmarrësit të cilët janë gjithnjë pjesë e debateve televizive.

Gjatë vitit 2016 u realizuan gjithsejtë 26 emisione, prej të cilave 17 ishin emisione debatuese ndërsa 9 prej tyre ishin reportazhe mbi punën a aktivistëve dhe avokuesve të rinj. Disa nga temat e trajtuara në këto emisione ishin (1) Përfaqësimi politik i komuniteteve RAE në të cilin

morën pjesë përfaqësuesit e të tri komuniteteve në parlamentin e Kosovës, (2) Diskutim mbi mos kthimin e përgjigjeve zyrtare nga komunat në kërkesat me shkrim të komuniteteve në të cilin morën pjesë 2 aktiviste të rinj dhe dy zyrtare komunal, (3) Procesi i hartimit të Strategjisë së re qeveritare për komunitetet RAE, (4) Njohja e gjuhës rome si gjuhë tradicionale në komunën e Prizrenit, (5) Mekanizmat e përfaqësimit të komuniteteve në nivel lokal, (6) Masat afirmative për përfshirje të nxënësve të komuniteteve RAE në sistemin arsimorë dhe krijimi i potencialit çpër punësim, (7) Mundësitë për punësim të komuniteteve RAE, etj. Formatit i emisionit u vendosë ashtu që secili emision të ketë ose vox populli ose reportazhe të shkurtë nga terreni të cilat shërbenin për ilustrim dhe argumentim të çështjes për diskutim.

Romtegra u angazhua poashtu në realizim të një filmi dokumentarë përmes së cilit do të tregohet pozita e komuniteteve në komunat ku veprojnë aktivistët e rinj, do të shtjellohet metodologjia e frymes së re avokuese dhe do të bëjë promovimin e kësaj fryme.

Lista e granteve/shpenzimeve:

Projekti/iniciativa	Grant marrësi	Shuma
14 debate televizive mbi çështjet që bren-gosin komunitetet RAE dhe përkrahje të fushatave Avokuese	Romtegra	12 450,00 €
4 debate televizive mbi çështjet që bren-gosin komunitetet RAE dhe përkrahje të fushatave Avokuese dhe xhirrim për nevoja të filmit dokumentarë mbi vet-avokimin	Romtegra	5 000,00 €
Postprodukcioni për filmin dokumentarë mbi vet-avokimin	Butterfly	1 000,00 €
Shpenzimet për përkthim të dokumenteve për konceptin dhe projektet EU SIMRAES 2, Prospect +	-	2 215,13 €

PROJEKTET ME FONDE TË PALËVE TË TRETA

Projektet e palëve të treta

Gjatë vitit 2015 respektivisht 2016 u fillua me zbatim të dy projekteve të financuara nga donatorët tjerë. Të dy këto projekte iu grantuan/besuan fondacionit pasi të dy donatorët ishin të kënaqur me zbatim të projekteve paraparake që kishin me fondacionin. Një shtytje tjetër për ndarje të këtyre projekteve fondacionit ishte edhe reputacioni i fondacionit me punën e vet me komunitetet RAE dhe plotësimi i mirë që bëhej me konceptin e vet-avokimit të komuniteteve RAE. Në këtë mënyrë u siguria një sinergji në mes të dy projekteve dhe konceptit dhe përmes projekteve u siguria vazhdimësia e aktiviteteve avokuese të nisura në tri vitet e kaluara.

Projekti që filloi në fund të vitit 2015 është Promovimi i integritit të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Pejës dhe të Suharekës, Kosovë – Prospect Plus i financuar nga Ministria për Ekonomi dhe Zhvillim e Gjermanisë përmes Fondacionit Karl Kubel në shumë prej 500.000 €, ndërsa projekti i cili filloi me zbatim në vitin 2016: Përkrahje e BEs për zbatim të RAE strategjisë është i financuar nga BE në shumë prej 1.3 milion € dhe zbatohet në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Në vijim jepet përshkrimi i progresit të zbatimit të të dy projekteve.

Përkrahja e BE-së për Zbatimin e Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2 - Arsim për Integrim (EU SIMRAES 2)

Përshkrimi i shkurtër i projektit

Projekti për Përkrahje e BE-së në zbatimin e strategjisë për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian 2 – Arsim për Integrim (EU SIMRAES 2), ka filluar implementimin me 1 prill 2016. Projekti financohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe implementohet nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) në partneritet me 7 organizata tjera:

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)

Balkan Sunflowers Kosova (BSFK)

Bethany Christian Services (BCS)

Nevo Koncepti (NVK)

SHL Kosova (SHL-K)

Syri i Vizionit (SiV)

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është partneri kryesor institucional në projekt, që krahas përkrahjes së aktiviteteve të projektit, financon edhe një pjesë të programit të bur-save në kuadër të projektit. Komuna e Gjakovës, Prizrenit, Rahovecit, Istogut, Obiliqit, Fushë Kosovës dhe Mitrovicës janë po ashtu partnerë institucionalë në nivelin lokal.

Objektivi i përgjithshëm i projektit EU-SIMRAES 2 është të mbështesë Qeverinë e Kosovës në zhvillimin e shoqërisë demokratike dhe multietnike duke zbatuar Strategjinë për Integrimin e Komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe Planin e saj të Veprimit.

Objektivi specifik i veprimit është të sigurojë qasje të barabartë të fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin parafillor, fillor dhe të mesëm, duke përmirësuar regjistrimin, vijimin dhe arritjen e rezultateve të fëmijëve nëpërmjet mbështetjes së bazuar në komunitet dhe asaj financiare.

Grupet e shënjestruara janë:

- 10 lokalitete ku jetojnë romë, ashkali dhe egjiptian me 8,127 banorë;
- fëmijët e moshës 5 vjeçare - gjithsej 154, prej tyre 98 e vijnë arsimin parafillor dhe 56 nuk vijnë;
- fëmijët e moshës 6-14 vjeçare - gjithsej 1246, prej tyre 1002 e vijnë arsimin e obliguar, dhe 244 nuk e vijnë;
- prindërit e fëmijëve të moshës shkollore nga 10 lokalitetet e synuara;
- mësuesit e shkollave që shërbejnë komunitetet e synuara;
- nxënësit e shkollave në komunitetet e synuara;
- 200-300 nxënës romë, ashkali dhe egjiptian të shkollave të mesme;
- 7 organizata të shoqërisë civile;
- publiku i gjerë në Kosovë.

Projekti i ka tri rezultate, që identifikohen edhe si komponentë të projektit:

- Përfshirja e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian nga 10 lokalitetet e shënjestruara, në arsimin parafillor, fillor dhe të mesëm, dhe përmirësimi i rezultateve të tyre të të nxënësve
- Qasje dhe mbajtje e përmirësuar e nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në

arsimin e mesem të lartë dhe përmirësim i kapacitetit të tyre për të përfituar nga arsimi i lartë

- Organizatat që punojnë në edukimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian e përmirësojnë kapacitetin e tyre për t'u ofruar shërbime cilësore anëtarëve të komuniteteve të tyre.

Si aktivitete kryesore të projektit janë:

- 1.1 Mbështetet punës e 10 qendrave mësimore
- 1.2 Bëhet vetëdijesimi i prindërve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për të regjistruar fëmijët me kohë në shkollë
- 1.3 Ofrohet mbështetje logjistike fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për të vijuar arsimin parafillor.
- 1.4 Ofrohet mentorim individual dhe ndihmë në detyra të shtëpisë për fëmijët e moshës shkollore dhe atyre të kthyer.
- 1.5 Organizohet trajnim kundër paragjytimeve për mësimdhënësit dhe prindërit, dhe ofrohet mentorim/këshillim për të siguruar zbatimin e kompetencave të marra
- 1.6 Organizohen ngjarje lokale për të ndihmuar integrimin më të mirë të fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në nivelin shkollor.
- 2.1 Ofrohet mbështetje për regjistrimin e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin e mesëm të lartë
- 2.2 Krijohet një program i bursave për nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian të shkollave të mesme të larta.
- 2.3 Ofrohet mentorim për përfituesit e bursave.
- 3.1 Themelohet një rrjet joformal i OShC që punojnë në përmirësimin e mundësive të arsimimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian
- 3.2 Lehtësohet komunikimi në mes të anëtarëve të rrjetit dhe shpërndahet informacioni
- 3.3 Zhvillohet strategjia e bashkëpunimit për rrjetin
- 3.4 Ofrohen mundësi të zhvillimit profesional të anëtarëve të rrjetit, për të përmirësuar shkathtësitë e tyre të shërbimit dhe avokimit

Të arriturat kryesore

1. Përfshirja në edukimin e hershëm dhe arsimin e obliguar

Këtë komponent të projektit e koordinon Qendra për Arsim e Kosovës. Organizatat tjera partnere kanë rol të theksuar në menaxhimin në nivel lokal përmes qendrave mësimore. Janë 10 qendra mësimore në 7 komuna, të cilat menaxhohen nga 6 organizatat tjera partnere.

Emri i qendrës mësimore	Organizata partnere menaxhuese
Qendra Sociale në Plementin (PBLC)	Balkan Sunflowers Kosova
Qendra Mësimore në Plementin (PLC)	Balkan Sunflowers Kosova
Fidan Lahu (Fushë Kosovë)	Balkan Sunflowers Kosova
Gurakoc (Istog)	Syri Vizionit
Serbobran (Istog)	Syri Vizionit
Piranë (Prizren)	Nevo Koncepti
Jeta e Re (Prizren)	Nevo Koncepti
Lagjja e Romëve (Rahovec)	SHL-Kosova
Brekoc (Gjakovë)	Bethany Christian Services
Lagjja e Romëve (Mitrovicë)	RADC

Si aktivitete fillestare në kuadër të këtij komponenti të projektit janë kryer vizitat në qendrat mësimore dhe është mbajtur takim me të gjithë partnerët implementues në komunat përfituese të projektit. Janë ndarë detyrat dhe përgjegjësitë dhe janë nënshkruar kontratat me të gjithë partnerët implementues. Në tremujorin e parë të projektit janë punësuar Koordinatorët e Qendrave Mësimore, janë identifikuar fasilitatorët dhe tutorët, janë identifikuar nevojat për pajisje dhe inventar dhe janë bërë përgatitjet për fushata vetëdijesuese.

Duke e pasur parasysh se projekti ka filluar me 1 prill respektivisht aktivitet në terren me partnerët implementues me datën 1 maj 2016, theks i veçantë i është kushtuar organizimit të fushatave vetëdijesuese për regjistrim në shkollë të fëmijëve të kthyer nga jashtë dhe identifikimit të grupmoshave 5-6 vjet për regjistrimin e tyre në sistem parafillor në lokalitetet ku i vijnë mësimet. Projekti ka bashkëpunuar ngushtë edhe me familjet e fëmijëve për të rregulluar dokumentacionin e nevojshëm, mungesa e të cilit që është sfidë në vete dhe shpesh është shkak i mos regjistrimit me kohë ose edhe braktisjes. Gjithashtu, gjatë fushatës janë shpërndarë edhe materiale promovuese që informimi të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe qasja në informata në regjistrimin e fëmijëve të jetë sa më e lehtë.

Në tabelën nr.1 në vijim është paraqitur numri i fëmijëve të regjistruar në sistem parafillor nga stafi i qendrave të projektit:

Tabela nr.1 – Fëmijët e regjistruar në sistem parafillor gjatë muajit shtator 2016.

Nr.	Qendra Mësimore	Numri i fëmijëve (5-6 vjet) të regjistruar në arsim parafillor		
		Meshkuj	Femra	Total
1	Qendra Sociale në Plementin (PBLC)	4	3	7
2	Qendra Mësimore në Plementin (PLC)	10	8	18
3	Fidan Lahu (Fushë Kosovë)	38	35	73
4	Gurrakoc (Istog)	1	3	4
5	Serbobran (Istog)	2	2	4
6	Piranë (Prizren)	3	4	7
7	Jeta e Re (Prizren)	1	10	11
8	Lagjja e Romëve (Rahovec)	7	4	11
9	Brekoc (Gjakovë)	8	16	24
10	Lagjja e Romëve (Mitrovicë)	13	14	27

Programi i detyrave të shtëpisë që është ndër programet më të rëndësishme të projektit e që implementohet sipas metodologjisë së kursit Hap pas Hapi ka filluar pa vonesë me 1 shtator 2016 në fillim të vitit shkollor. Në këtë program janë të angazhuar së paku 3 fasilitatorë me kohë të plotë ose 6 fasilitatorë me gjysmë orari në varësi të nevojave të qendrës dhe numrit të fëmijëve. Programi është monitoruar nga stafi i projektit dhe deri në këtë periudhë pjesëmarrja e fëmijëve në këtë program ka qenë e kënaqshme. Vlen të theksohet se vetëm në muajin shtator gjithsej 806 fëmijë (435 meshkuj dhe 371 femra) kanë vijuar rregullisht programin.

Projekti EU SIMRAES parasheh ndihmë logjistike për të lehtësuar vijueshmërinë në shkollë dhe në qendër mësimore dhe në kuadër të kësaj ka ndërmarrë veprimet në vijim:

- a) ka shpërndarë 1500 pako shkollore nga 800 të parapara respektivisht i ka mbuluar të gjithë fëmijët në nevojë në 10 lokalitetet përfituese;
- b) në baza mujore shpërndan gjysmë shujtë për fëmijët që vijnë në qendra mësimore;
- c) ka shpërndarë materialet didaktike në secilën qendër mësimore;
- d) ka bërë intervenime në të gjitha qendrat dhe është duke e rinovuar tërësisht objektin e qendrës mësimore në Qendrën Sociale në Plementin dhe ndërrimin e të gjithë gypave të kanalizimit për të gjithë ndërtesën ku banojnë familjet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Me qëllim të integritit të fëmijëve që vijnë në qendra me nxënësit e komunitetit shumicë dhe komunitetet tjera në lokalitetet përfituese janë organizuar një seri ngjarjesh ndërkulturore. Vlen të theksohet se shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Tolerancës jo vetëm se ka përfshirë nxënësit e komunitetit shumicë, personelin e shkollës dhe komunës, por ka tërhequr edhe vëmendjen e medieve nacionale që i kanë transmetuar këto ngjarje.

Në kuadër të projektit parashihen disa lloje të trajnimeve për stafin e qendrave mësimore, mësimdhënësit dhe prindërit e nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Disa nga trajnimet e ofruara janë dhënë në vijim.

Trajnimi “Hap pas Hapi” (HpH) për stafin e 10 qendrave mësimore: Projekti ka për qëllim aftësimin e stafit të qendrave mësimore respektivisht fasilitatorëve dhe tutorëve me metodologjinë HpH. Trajnimet kanë filluar nga fundi i qershorit dhe kanë përfunduar në nëntor 2016. Gjithsej janë organizuar 9 grupe, me 230 pjesëmarrës (131 femra; 99 meshkuj). Prej tyre, janë certifikuar 179 pjesëmarrës (108 femra; 71 meshkuj).

Trajnimi kundër diskriminimit “Edukimi për Drejtësi Shoqërore” (EDSH): Me synimin e eliminimit të paragjyqimeve dhe diskriminimeve në sistemin arsimor, projekti ka ofruar trajnimin EDSH për prindërit e fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian dhe mësimdhënësit që punojnë me këta fëmijë. Gjatë kësaj periudhe, janë organizuar 7 grupe me 183 pjesëmarrës (115 femra; 68 meshkuj), nga të cilët 140 (86 femra; 54 meshkuj) kanë kaluar suksesshëm trajnimin dhe janë certifikuar.

Trajnimi për Koordinatorët e Qendrave Mësimore: Koordinatorëve të Qendrave Mësimore u është ofruar një trajnim në 5 module mbi programin e projektit, mënyrat e raportimit, indikatorët e suksesit, çështjet buxhetore/financiare dhe rregullat e dukshmërisë për implementimin e projekteve të BE-së.

1. Përmirësimi i qasjes në arsimin e mesëm të lartë

Komponenti i dytë i projektit është i orientuar në përkrahjen e nxënësve të shkollave të mesme të larta nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian përmes programit të bursave dhe programit të mentorimit.

Programi i bursave: Me nismën e Ministrit të Arsimit, të gjithë ofruesit e bursave janë bashkuar në një proces të koordinuar të programit të bursave këtë vit. Kjo ka bërë që aktivitetet e programit të bursave në kuadër të projektit, t’i adaptohet kësaj qasjeje të integruar, duke u modifikuar asisoji që të ndikojnë sa më mirë. Edhe ashtu, programi i bursave ka qenë i planifikuar të implementohet në bashkëpunim me MASHT-in pasi MASHT-i ka zotuar fonde të veta për bursa, krahas fondeve të projektit. Në rrethana të reja të gjitha përgatitjet dhe procedurat e programit të bursave janë bërë në bashkëpunim me MaShT-in dhe me partnerët tjerë të bursave.

Së pari është hartuar pakoja e aplikimit për bursa, që ka përfshirë thirrjen për bursa, kriteret e bursave, komisionin vlerësues të bursave dhe procedurat, etj. Në kuadër të projektit është disenuar një sistem për menaxhimin e informatave lidhur me bursat dhe i njëjti është vënë në dispozicion për të gjithë partnerët në programin e bursave. Thirrjes për bursa i ka paraprirë një fushatë informimi përmes lajmërimeve në mediat elektronike, shpërndarjes së materialeve promovuese dhe takimeve informuese nëpër lokalitete. Thirrjes për aplikime i janë përgjigjur mbi 680 aplikantë. Janë gjithsej 500 përfitues të bursave, të cilët pastaj janë ndarë në mes të projekteve/partnerëve. Projekti EU-SIMRAES 2 ka marrë 200 përfitues të bursave. Në negociata me MASHT-in dhe të ndikuar nga mënyra e zotimit të buxhetit nga MaShT-i është vendosur që për tri vite të kohëzgjatjes së projektit, MASHT-i të jep bursa për 133 nxënës, derisa KFOS për

67 nxënës tjerë. KFOS-i do të monitoroj procesin e vijimit të shkollimit dhe rezultatet e të nxënësve të gjithë përfituesve të bursave në kuadër të projektit.

Programi i mentorimit: Në kuadër të projektit parashihet që nga 200 përfituesit e bursave që ndahen në nivel të projektit, 100 prej tyre t'i nënshtrohen programit të mentorimit. Në këtë proces, projekti ka bërë marrëveshje me MASHT-in, REF-in dhe VoRAE-an për të unifikuar programin e mentorimit. KEC-i, që e implementon programin e mentorimit në kuadër të projektit, e ka adoptuar programin e mentorimit të REF-it, të cilët së bashku me MASHT-in janë në vitin e tretë të implementimit. EU SIMRAES 2 i ka caktuar kriteret, përgjegjësitë për mentorë dhe dokumentet tjera përcjellëse dhe do të angazhuar rreth 30 mentorë për këtë program. Si rregull, një mentor mund të mentorojë deri në 5 nxënës në varësi të numrit të nxënësve dhe shpërndarjes gjeografike të tyre. Mentorët janë përgatitur për këtë program, duke u trajnuar në modulën e parë që ka të bëjë me njohuritë themelore për punën e mentorit, ndërsa pas punës praktike me nxënës, atyre do t'u ofrohet edhe moduli i dytë i trajnimit, në të cilin ata do të sjellin përvojën dhe reflektimin e punës me nxënës. Procesi i mentorimit do të fillojë me 10 janar 2017 në tri (3) komuna: Gjakovë, Prizren dhe Istog, ku janë të lokalizuar përfituesit e programit të mentorimit.

2. Forcimi i kapacitetit të OshC-ve që punojnë në edukimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

Ky komponent është i drjtuar kah forcimi i kapaciteteve të anëtarëve të organizatave partnere për të ofruar shërbime cilësore në fushën e arsimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Në kuadër të këtij komponenti së pari është themeluar rrjeti joformal i organizatave që punojnë në edukimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Ky rrjet mori emrin "Konekt" dhe përbëhet nga organizatat partnere të projektit, me mundësinë që të zgjerohet me organizata tjera dhe/apo të bashkëpunojë me rrjete tjera.

Në një punëtori dyditore anëtarët e rrjetit janë mbledhur dhe kanë hartuar planin e punës të rrjetit. Plani përqendrohet në aktivitete të komunikimit dhe informimit, si dhe në zhvillim të kapaciteteve për avokim dhe krijim e monitorim të politikave

Rrjeti do të mbajë takime periodike që do të shërbejnë për shkëmbimin e përvojave të anëtarëve të rrjetit në fushën e avokimit për arsimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Derisa KFOS-i do ta ketë rolin e lehtësimit të këtyre takimeve në aspektin e organizimit logjistik, secila organizatë me rradhë do të jetë nikoqire e takimeve. Takimi i parë i këtillë është organizuar në nëntor në Prizren, ku nikoqire ishte organizata partnere "Nevo Koncepti"

Në kuadër të projektit është hapur ueb faqja e projektit e cila është në dispozicion në <http://eu-simraes.net/>. Po ashtu projekti ka hapur një faqe në Facebook, që është në dispozicion në <https://web.facebook.com/eusimraes2/?fref=ts>.

Lista e granteve:

Emri i projektit	Grantisti	Shuma
EU SIMRAES II	KEC	253,804.00
Shuma e granteve e shpërndarë nga KEC te partnerët lokalë për vitin 2016		
EU SIMRAES II	Nevo Koncepti	21,331.68
EU SIMRAES II	Bethany Christian Services	10,905.84
EU SIMRAES II	Syri Vizionit	21,331.68
EU SIMRAES II	SHL-Kosova	10,905.84
EU SIMRAES II	Balkan Sunflowers Kosova	36,216.67
EU SIMRAES II	RADC	10,905.84

Lista e shpenzimeve:

Lloji i shpenzimit	Përfituesi	Shuma
Pajisje dhe inventar	Qendrat Mësimore	24,923.98
Trajnimi i stafit të qendrave mësimore, mësimdhënësve dhe prindërve (HpH, EDSh, mentorimi dhe koordinatorët)	Qendrat Mësimore/ Shkollat/Mësimdhënësit/ Prindërit	28,371.19
Furnizimi me 1500 pako shkollore	Nxënësit	18,288.00
Programet e qendrave mësimore	Nxënësit	3,000
Punëtori dhe takime të rrjetit	Anëtarët e rrjetit	1,067
Ueb faqja e projektit	Publiku i gjerë	1,500
Sistemi për mënaxhimin e informatave për bursa	KFOS/ MASHt/Partnerët e bursave	20,100
Materiale promovuese	KFOS/Organizatat partnere	2,260

Promovimi i integritit të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Pejës dhe të Suharekës, Kosovë – Prospect Plus

Projekti *Prospect Plus* është vazhdimësi e projektit Prospect, i cili është zbatuar në katër komuna të Kosovës (Prizren, Gjakovë, Rahovec dhe Istog). Projekti Prospect Plus zbatohet në dy komuna (Pejë dhe Suharekë), duke filluar nga nëntori i v.2015. E drejta në arsim dhe në shëndetësi nuk është vetëm e drejtë themelore e njeriut, por edhe strategji thelbësore për të tejkaluar varfërinë dhe të sigurohet gjithë përfshirja sociale dhe ekonomike. Në këtë kontekst projekti synon të vazhdojë t'i kontribuojë realizimit të strategjisë shtetërore për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian duke përmirësuar qasjen në shërbimet për arsim, shëndetësi dhe çështje sociale. Andaj synimi i përgjithshëm i Projektit Prospect Plus është të kontribuojë në realizimin e të drejtave të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në Kosovë, respektivisht në komunën e Pejës

dhe të Suharekës, dhe në integrimin e tyre në shoqërinë kosovare. Për të kontribuar në arritjen e këtij qëllimi të përgjithshëm, Projekti Prospect Plus ka marrë mbi vete obligimin të arrijë një qëllim të caktuar, i cili është që në katër lagje në dz komunat e cekura ku jeton komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian të përmirësohet qasja në shërbimet për arsim, shëndetësi dhe çështje sociale si një hap i rëndësishëm drejt rritjes së pjesëmarrjes ekonomike dhe sociale si dhe të integritit social.

Projekti parasheh një varg masash dhe aktivitete në fushat e arsimit dhe të shëndetësisë, të cilat janë të përfshira në Strategjinë dhe Planin e veprimit për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë (specifikisht në sektorët e arsimit dhe shëndetësisë si dhe në sektorët e ndërlidhur të çështjeve sociale). Ato do të realizohen, monitorohen dhe zhvillohen së bashku me grupet e synuara, OJQ-të partnere si dhe palët relevante për të siguruar qëndrueshmërinë edhe pas përfundimit të projektit.

Janë gjithsej tri fusha të intervenimit me këtë projekt, të shprehura si qëllime të projektit:

1. Fëmijët romë, ashkali dhe egjiptas në katër mahalla janë të integruar në shkollën fillore (nivelel parashkollor, fillor dhe të mesëm të ulët).
2. Komunitetet e synuara romë, ashkali dhe egjiptas e përmirësojnë qasjen e tyre në shërbimet shëndetësore dhe sociale dhe fitojnë më shumë njohuri dhe informata rreth çështjeve që kanë të bëjnë me shëndetin, dhe
3. Një numër i OJQ-ve (Rrjeti PROSPECT) angazhohet dhe avokon për implementimin e planeve komunale të veprimit për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.

Grupi i synuar i Prospect Plus janë **komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian në katër lokacione (mëhalla) në dy komuna, të cilët përbëjnë rreth 1900 pjesëtarë.** Komuniteti i synuar është: paralagjia “7 Shtatori” dhe fshati Vitomiricë në Komunën e Pejës, si dhe fshati Gelancë dhe Leshani në Komunën e Suharekës. Në secilin prej katër lokacioneve ka nga një shkollë fillore e cila ofron arsim parashkollor për fëmijët e moshës pesëvjeçare, arsim fillor për fëmijët nga 6 deri 10 vjeç, si dhe arsim të mesëm të ulët për fëmijët nga 11 deri 14 vjeç.

Peja

Ekziston një numër i konsiderueshëm i romëve, ashkalive dhe egjiptasve të cilët jetojnë në Pejë, megjithëse ata përbëjnë më pak se 4% të popullsisë që jeton në këtë komunë. Sipas të dhënave të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, 3,836 romë, ashkali dhe egjiptas jetojnë në komunën e Pejës, ku egjiptasit përbëjnë më shumë se 70% të kësaj popullsie. Një e treta e romëve, ashkalive dhe egjiptasve që jetojnë në Pejë (gjithsej 1,325) janë të moshës 5-19 vjeç, ndërsa vetëm pak më shumë se gjysma e tyre (gjithsej 687) vijnë arsimin parashkollor, fillor, dhe të mesëm.

Mahalla (lagjia) “7 Shtatori” gjendet në zonën urbane të Pejës. Rreth 1,300 familje jetojnë në këtë zonë, derisa romët, ashkalitë dhe egjiptasit përbëjnë gjithsej 1,200 persona. Fëmijët nga kjo lagje vijnë shkollimin fillor dhe të mesëm të ulët në shkollën Xhemajl Kada – gjithsej

262 prej tyre (klasa 0 deri 9), ndërsa 133 fëmijë nuk shkojnë në shkollë. Ekziston një Qendër e komunitetit e cila funksionon në këtë lagje dhe organizon aktivitete të ndryshme me burra, gra dhe fëmijë.

Vitomirica është një fshat me rreth 5,400 banorë i cili gjendet 5 kilometra në veri të Pejës. Fshati kryesisht është i banuar me shqiptarë dhe boshnjakë, ndërsa llogaritet se në këtë zonë jetojnë rreth 450 romë dhe egjiptas. Shkolla lokale fillore dhe e mesme e ulët quhet “7 Shtatori” dhe nuk duhet ngatërruar me mahallën në zonën urbane të Pejës. Gjithsej 79 fëmijë nga komunitetet romë dhe egjiptas vijnë në mësimin në shkollën lokale, derisa 24 prej tyre mbesin jashtë shkollës. Fshati gjithashtu ka një qendër kulturore (një qendër multifunkionale e komunitetit) e cila ka disa hapësira të përshtatshme për fëmijë dhe të rinj, edhe pse kjo qendër shpesh shfrytëzohet nga organet komunale si dhe nga organizatat tjera.

Aktivitetet e projektit realizohen në qendrat mësimore të themeluara me projekt brenda hapësirave shkollore.

Suhareka

Suhareka është një komunë në pjesën jugore të Kosovës me gjithsej 59,722 banorë, prej të cilëve 539 (0.9%) janë romë, ashkali dhe egjiptas. Gjithsej 122 nga 196 banorë të moshës 5 deri 17 vjeç vijnë në një lloj të arsimit parauniversitar që paraqet një situatë paksa më të mirë sesa në Pejë, megjithëse ekziston një mospërputhje e madhe në raport me popullsinë shumicë.

Gelanca është një fshat me pak më shumë se 1,000 banorë i cili gjendet 9 kilometra larg Suharekës. Vetëm pesë nga 219 ashkali dhe egjiptas janë të punësuar, derisa 51 fëmijë vijnë në mësimin në shkollën lokale fillore dhe të mesme “Drita”, ndërsa 8 prej tyre nuk vijnë në mësimin.

Leshani gjendet 6 kilometra larg Suharekës. Fshati ka rreth 1,600 banorë nga të cilët 59 janë ashkali, shumica e të cilëve janë pjesë e skemës sociale. 26 fëmijë ashkali vijnë në shkollën fillore dhe të mesme të ulët “Vaso Pashë Shkodrani” në fshat, derisa 7 prej tyre nuk shkojnë fare në shkollë.

Si në Gelancë ashtu edhe në Leshan si qendër mësimore për aktivitetet e projektit përdoren hapësirat brenda shkollave.

Kushtet e vështira ekonomike, varfëria, papunësia, niveli i ulët i vetëdijësimit të prindërve sa i përket arsimit, si dhe analfabetizmi janë arsye kryesore për vijimin e ulët të shkollimit. Poashtu, tre nga katër lokacionet e propozuara gjenden në zonat rurale, dhe gjatë sezonit të mbjelljeve dhe korrjeve fëmijët punojnë për t'u ndihmuar prindërve të tyre. Edhe pse numri i të kthyerve ende nuk dihet, riatdhesimi ka filluar të ndodhë për ato familje të cilat kanë emigruar në fund të vitit 2014 dhe në fillim të vitit 2015, derisa të gjitha lokacionet e projektit u gjetën të papërgatitura t'u riintegronë fëmijët të cilët e kishin humbur vitin shkollor.

Në kushte varfërie dhe pa të ardhura, pjesëtarët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas e kanë të vështirë t'u qasen shërbimeve shëndetësore, derisa shumica e familjeve mbështeten

në skema sociale.

Në komunën e Pejës, megjithëse objektet shëndetësore/mjekësore gjenden afër lokacioneve të synuara, pjesëtarët e komuniteteve RAE ballafaqohen me problemin e pjesëmarrjes, ku kryesisht gratë (famijet) nuk kanë mjete financiare për të paguar për vizita të rregullta mjekësore. Vizitat e vetme mjekësore bëhen në rastet e urgjencave.

Në Suharekë situata është akoma më e keqe. Si Gelanca ashtu edhe Leshani nuk kanë objekte shëndetësore/mjekësore, dhe pjesëtarët e komuniteteve duhet të udhëtojnë në Suharekë për vizita mjekësore për të cilat nuk mund të paguajnë. Vetëm në rastet e urgjencave ata udhëtojnë për në qytet dhe marrin shërbime mjekësore.

Deri më tani nuk ka pasur ndonjë projekt të madh të implementuar në komunën e Pejës dhe të Suharekës sa i përket mbështetjes për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas. Gjithashtu, asnjëri nga donatorët e mëdhenj të cilët punojnë në integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas nuk e kishte shtrirë praninë në këto dy komuna. Komunitat i kishin mbështetur disa aktivitete të vogla. Për shembull: Komuna e Pejës i ka mbështetur grupet rinore joformale nga komunitetet RAE në organizimin e aktiviteteve të vetëdijësimit në lidhje me rëndësinë e arsimit brenda mahallës 7 Shtatori. Poashtu, kjo komunë e ka mbështetur organizatën lokale "Syri i Vizionit" për të zhvilluar aktivitete të vogla që kanë të bëjnë me vetëdijësimin e komuniteteve RAE sa i përket përfshirjes në arsim dhe kujdesit shëndetësor. Vitin e kaluar komuna e Suharekës i ka mbështetur aktivistët romë, ashkali dhe egjiptas në Gelancë për të zhvilluar aktivitete të vetëdijësimit dhe për të ndihmuar fëmijët në zgjidhjen e detyrave të shtëpisë. Megjithkëtë, mbështetja nga komunitat ka qenë e vogël dhe ka pasur ndikim të vogël në komunitetet RAE. Kjo vjen gjithashtu edhe si rezultat i aktivizimit të ulët qytetar, apo i pak nismave që rrjedhin nga vetë pjesëtarët e komuniteteve RAE.

Sa i përket zotimit, komunitat kanë shfaqur gatishmërinë e tyre për ta mbështetur cilëndo nismë e cila rrjedh nga pjesëtarët e komuniteteve RAE.

Komuna e Pejës ka zhvilluar një politikë të përgjithshme për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas. Kryetari i komunës ka nënshkruar dhe ka miratuar një dokument të quajtur "Strategjia e veprimit për komunitetet RAE në komunën e Pejës", ndërsa janë ndërmarrë shumë veprime për ta implementuar këtë politikë. Kjo politikë trevjeçare ka përfunduar në vitin 2011. Që atëherë nuk është nxjerrë asnjë politikë për komunitetet RAE. Sipas organizatave të shoqërisë civile në Pejë, në atë kohë janë arritur rreth 90% të masave të kësaj politike. Që nga ajo kohë komuna nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim për ta rishikuar/përditësuar apo zhvilluar ndonjë politikë të re.

Në komunën e Suharekës, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE) e ka mbështetur komunën për ta zhvilluar «Planin e veprimit për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas në komunën e Suharekës». I planifikuar me pjesëmarrje të ulët të përfaqësuesve të komuniteteve RAE dhe me praninë e të gjithë drejtorive komunale, dokumenti u miratua nga këshilli komunal dhe u nënshkrua nga kryetari i komunës. Ky dokument përmban shtatë kapituj, ku përshkruhen masat për secilin kapitull, përfshirë edhe

masat për të adresuar brenga sa i përket arsimit, shëndetësisë, dhe çështjeve sociale të këtij komuniteti të marginalizuar. Duke u thirrur në këtë dokument komuna ka mbështetur në shkallë të vogël nisma lokale që kanë ardhur nga aktivistët e komuniteteve RAE, kryesisht fushata të vetëdijësimit në lidhje me arsimin dhe shëndetësinë.

Fillimi i zbatimit të Projektit Prospect Plus ka filluar me krijimin e një baze të të dhënave, ku partnerët lokalë kanë mbledhur informacionin e nevojshëm lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me arsimin, shëndetësinë, çështjet sociale dhe zhvillimin organizativ të organizatave të shoqërisë civile që punojnë me komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane. Për të zhvilluar papengueshëm aktivitetet e projektit në lagjet e përmendura, KFOS ka përgatitur hapësirat ku zhvillohen aktivitetet e projektit duke i furnizuar me inventar të nevojshëm dhe pajisje të ndryshme teknologjike. Me fillimin e vitit të ri shkollor 2015/16 KFOS gjithashtu, përmes partnerëve lokalë, ka bërë shpërndarjen e mjeteve didaktike mësimore për fëmijët e komuniteteve që vijnë në mësimin në lagjet ku gravitojnë shkollat e përfshira në projekt. Për të vazhduar më tej, lidhur me arsimin, partnerët lokalë kanë filluar me dy grupe të aktiviteteve: ato ndërgjegjësuere dhe ndërkulturore. Lidhur me aktivitetet ndërgjegjësuere, partnerët lokalë kanë filluar fushatat ndërgjegjësuere për vijueshmëri të rregullt dhe për regjistrim të fëmijëve në klasë të parë. Partnerët lokalë kanë nisur vizitat në shtëpia dhe kanë organizuar takime me prindër, shpesh duke i përfshirë edhe zyrtarët komunalë të arsimit. Gjithashtu kanë hartuar dhe shpërndarë materiale ndërgjegjësimi. Sa i përket aktiviteteve ndërkulturore, që ka për synim zbutjen/eliminimin e paragjykimëve dhe stereotipave, partnerët lokalë kanë nisur të zhvillojnë aktivitete duke i bërë bashkë fëmijët e komuniteteve me fëmijët e shumicës të shoqërohen dhe të kuptojnë traditën kulturore të njëri-tjetrit përmes lojës, garave të ndryshme, artit etj. Për t'u ndihmuar fëmijëve të komuniteteve me vështirësi në nxënie, është paraparë që të shkathtësohet një grup i njerëzve nga të cilët pritet t'u ndihmojnë fëmijëve të komuniteteve në kryerjen e detyrave të shtëpisë, të komunikojnë me prindërit dhe me shkollat, duke synuar kështu që fëmijëve të komuniteteve me vështirësi në nxënie t'u ofrohet një mjedis i përshtatshëm, me çka pritet të përmirësohet vijueshmëria dhe suksesi i nxënësve të kësaj kategorie. Për të shkathtësuar grupin e njerëzve të cilët do t'u ofrojnë këto shërbime fëmijëve, është angazhuar Qendra për Arsim e Kosovës/KEC. Cikli i trajnimeve ka filluar në janar dhe ka përfunduar në mars 2016.

Për çështjet që ndërlidhen me shëndetësinë dhe çështjet sociale, partnerët lokalë kanë identifikuar pjesëmarrësit të cilëve do t'u ndërtohen kapacitetet ashtu që të punojnë si ndërmjetësues Shëndetësorë dhe Socialë, si urë lidhëse ndërmjet komuniteteve dhe ofruesve të shërbimeve mjekësore dhe sociale. Për të ndërtuar këto kapacitete është angazhuar Asociacioni i Mjekëve Familjarë të Kosovës, i cili ka filluar trajnimet për pjesëmarrësit e identifikuar. Cikli i trajnimeve ka filluar në janar dhe ka përfunduar në mars të vitit 2016, nga ku pastaj të trajnuarit kanë filluar angazhimin në lagjet e projektit.

Shuma e granteve e shpërndarë në partnerë lokalë për vitin 2016

Emri i projektit	Grantisti	Shuma
Prospect Plus	Nevo Koncepti, realizimi i aktiviteteve mësimore, të ndërmjetësimit shëndetësor dhe social, dhe të rrjetëzimit dhe avokimit	23,222
Prospect Plus	Syri i Vizionit, realizimi i aktiviteteve mësimore, të ndërmjetësimit shëndetësor dhe social, dhe të rrjetëzimit dhe avokimit	23,225
Prospect Plus	Qendra për Arsim e Kosovës, trajnimi i tutorëve dhe mentorimi i mësimdhënësve të përfshirë në projekt	9,600
Prospect Plus	Asociacioni i Mjekëve Familjarë të Kosovës, trajnimi i mediatoreve, mentorimi i punës së tyre dhe ndërlidhja me ofruesit e shërbimeve shëndetësore	6,634
Prospect Plus, operacionale	Nevo Koncepti, Syri i Vizionit Furnizimi me pajisje teknologjike	3455
Prospect Plus, operacionale	Nevo Koncepti, Syri i Vizionit Shpenzimet për dukshmëri (banerë, etiketa etj)	800
Prospect Plus, operacionale	Nevo Koncepti, Syri i Vizionit Pakot shkollore për nxënësit e komuniteteve	2400
Prospect Plus, operacionale	Nevo Koncepti, Syri i Vizionit Inventarizimi i qendrave mësimore	12330
Prospect Plus, operacionale	Nevo Koncepti, Syri i Vizionit Adapimi i qendrave mësimore në Pejë	2000
Prospect Plus, operacionale	Nevo Koncepti, Syri i Vizionit Adapimi i qendrave mësimore në Suharekë	2140

Të dhënat e përgjithshme të përfituesve të projektit Prospect Plus

Lagjia	Banorë të komunitetit	Nr fëmijëve që vijnë në mësimin (6-19 vjeç)	Nr fëmijëve që nuk vijnë në mësimin (6-19 vjeç)	Nr familjeve të përfituesve të skemës sociale	Nr i të punësuarve	Nr i të papunësuarve
7 Shtatori, Pejë	1156	119	37	43	6	149
Vitomiricë, Pejë	433	25	5	19	0	36
Totali në Pejë	1589	144	42	62	6	185
Leshan, Suharekë	141	26	7	0	2	50
Gelancë, Suharekë	207	48	9	15	4	103
Totali në Suharekë	348	74	16	15	6	153

INTEGRIMET EVROPIANE DHE QEVERISJA E MIRË

Programi për Integrim Evropian dhe Qeverisje të Mirë

Në vitin 2016, Programi për Integrim Evropian dhe Qeverisje të Mirë ka mbështetur organizatat jo-qeveritare në monitorim dhe avokim me qëllim që t'i kërkohet llogari Qeverisë së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me agjendën e reformave të BE-së, agjendë kjo që është deklaruar si primare në kahjen e qeverisjes në Kosovë. Puna e këtij programi është zhvilluar në tri drejtime strategjike: (1) të sigurohet që shoqëria civile e Kosovës të monitorojë dhe avokojë në mënyrë aktive për standarde evropiane të qeverisjes përmes kontributit të tyre në raportet vjetore të Komisionit Evropian për Kosovën, (2) të thellohen njohuritë mbi politik-bërjen e BE-së ndër praktikuesit e politikave publike, si dhe (3) të ndërtohet një momentum ndërkombëtar për përmirësimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe BE-së përmes monitorimit të procesit të integritimeve evropiane.

Kontributi i OJQ-ve në procesin e Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim

Brenda këtij drejtimi të programit, Fondacioni që nga viti 2014 ka shtyrë përpara një proces më gjithëpërfshirës të pjesëmarrjes së organizatave të shoqërisë civile në Procesin e Dialogut për Stabilizim Asociim, përveç tjerash. Duke vazhduar me këtë trend edhe në vitin 2015, ashtu edhe në vitin 2016 fondacioni ka shtyrë para këtë proces ku organizata të reja u janë bashkangjitur rrjetit të kontribuuesve dhe kanë marrë pjesë me inputet e tyre në fazat më të hershme të hartimit të Raportit për Kosovën.

Në vitin 2016, ky proces fillimisht ka nisur me mobilizimin e organizatave partnere kyçe të interesuara të monitorojnë progresin e Kosovës në rrugën e saj të integritimit në BE. Më pas, është bërë krahasimi dhe përputhshmëria e ekspertizës së këtyre organizatave partner me kapitujt e Raportit për Kosovën, si dhe me sektorët kyç tematikë të tij. Është vendosur komunikim i vazhdueshëm me zyrën e BE-së në Prishtinë, ku na është rekomanduar që kontributi për Raportin për Kosovën të bëhet në dy faza: në fazën fillestare të hartimit të këtij raporti në fund të Prillit, si dhe në konsultimet me shoqërinë civile në fund të Gushtit. Fillimisht, organizatat kanë dërguar analiza dhe rekomandime të kondensuar në afatin e prillit në fillimin e procesit të hartimit të Raportit për Kosovën. Më pas, në korrik të 2016, këto analiza janë zgjeruar në raporte të plota ku është kontribuar në takimin e komisionit evropian me shoqërinë civile me 24 gusht, 2016.

Në fund, është prodhuar një seri prej nëntë studimeve për progresin vjetor të Kosovës në Fushën e integritimeve evropiane. Organizatat në fjalë kanë monitoruar dhe analizuar punën e bërë të institucioneve qeveritare gjatë vitit 2016, ku ekspertiza e tyre është angazhuar në fushat që tashmë i njohin mirë. Kjo përpjekje ka rezultuar në material të vlefshëm për gjurmimin e arritjeve dhe ngecjeve të Kosovës karshi agjendës evropiane. Për më tepër, këto raporte kanë shërbyer si platformë avokimi për rekomandimet që jepen në to, si në institucionet e vendit dhe ato të BE-së, duke përforcuar kështu zërin e shoqërisë civile dhe ndikimin e saj në politik-bërjen në vend.

Emri i Projektit	Grantist	Shuma Euro
Kontributi për Raportin e KE për Kosovën: Luftimi i Korrupsionit dhe krimet të organizuar, parashkrimi i lëndëve penale dhe financimi i partive politike	Organizata për Demokraci, Anti Korrupsion dhe Dinjitet, Çohu!	3,800
Kontributi për Raportin e KE për Kosovën: Planifikimi Urban dhe Trashëgimia Kulturore	EC Ma Ndryshe	3,000
Kontributi për Raportin e KE për Kosovën: Mbrojtja e dëshmitarëve dhe deklarimi i pasurisë	Lëvizja FOL	3,000
Kontributi për Raportin e KE për Kosovën: Prokurimi publik dhe lufta kundër korrupsionit	Instituti Demokratik i Kosovës	4,000
Kontributi për Raportin e KE për Kosovën: Lufta kundër pastrimit të parave në Kosovë dhe monitorimi i Reformës së Administratës Publike	Grupi për Studime Juridike dhe Politike	4,000
Kontributi për Raportin e KE për Kosovën: Ballafaqimi me presionin konkurrues në treg dhe Funksionimi i institucioneve të drejtësisë	Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë	3,000
Kontributi për Raportin e KE për Kosovën: Progresi në Mitrovicë	NGO Aktiv	3,000
Kontributi për Raportin e KE për Kosovën: Policimi i udhëhequr nga Inteligjenca nga ana e policisë së Kosovës dhe Luftimi dhe parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm	Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë	4,000
Kontributi për Raportin e KE për Kosovën: Kuvendi i Kosovës	Democracy Plus	2,000
Publikimet dhe perkthimet		21,352
Shpenzime tjera programore	11,327	
Totali :	62,479	

Forum 2015: Ecje nëpër akull – Kushtëzime, sfida dhe reforma drejt BE-së

Për të kurorëzuar punën njëvjeçare të kësaj shtylle të programit, Fondacioni në bashkëpunim me Grupin për Studime Juridike dhe Politike organizuan një konferencë të Forumit 2015 me titull “Ecje nëpër akull: Kushtëzime, sfida dhe reforma drejt BE-së”. Duke sjellë së bashku diplomatë, politikë-bërës, media dhe përfaqësues të shoqërisë civile, qëllimi ishte që të nxirren në pah sfidat me të cilat ballafaqohet Kosova vis-a-vis qeverisjes së mirë dhe procesit të integritimit evropian.

E darë në tri sesione të veçanta, konferenca filloi me fjalën hyrëse të drejtorit ekzekutiv të fondacionit, z. Shllaku, dhe më pas u shpalos punimi i realizuar nga Augustin Palokaj dhe Gjeraqina Tuhina, të cilët analizuan hapat e ardhshme të procesit të integrimi evropiane të Kosovës. Diskutimi pasues në panel mbledhi kryeministrin Isa Mustafa, shefen e zyrës së Be-së Nataliya Apostlova si dhe publicistin Veton Surroi. Pas kësaj, u zhvilluan dy panele paralele, ai mbi Dialogun Kosovë-Serbi si dhe paneli mbi Reformat në Sundimin e Ligjit në kuadër të integrimi evropiane të Kosovës.

Përgjatë konferencës është bërë publikimi i kontributeve të punuara nga organizatat për Raportin për Kosovën, si dhe në panelin diskutues mbi Reformat në Sundimin e Ligjit janë diskutuar çështjet të cilat janë identifikuar në këto punime, ku pjesëmarrës ishin vetë përfaqësuesit e këtyre organizatave, përfaqësues të institucioneve të BE-së, si dhe përfaqësues të institucioneve të vendit.

Monitorimi i Procesit të Integrit Evropian: Marrëdhëniet Kosovë-BE

Brenda kësaj shtylle strategjike të programit, fondacioni e sheh të rëndësishme të mbajë momentumin e perspektivës Evropiane përmes punës në avancimin e marrëdhënieve të Kosovës me BE-në. Secili hap tutje në avancimin e pozitës së Kosovës në rrugën e saj të integrit në BE kërkon një sërë miratimesh brenda institucioneve qendrore të BE-së si dhe vendeve anëtare të saj. Duke e identifikuar këtë faktor si të rëndësishëm, Fondacioni ka përkrahur një sërë iniciativash për të qartësuar dhe identifikuar pengesat e rrugëtimit të vendit drejt BE-së, si dhe ka ndërmarrë hapa avokues që të rrënojnë muret e ngritura në mes të vendeve anëtare dhe qytetarëve të Kosovës përmes demistifikimit të paragjykimeve dhe afrimit të dy palëve në një dialog konstruktiv.

Avokimi për heqjen e regjimit të vizave Schengen dhe dokumentari “Rejected”

Në këtë aspekt vlen të përmendet fushata avokuese e Fondacionit për heqjen e regjimit të vizave Schengen për Kosovën. Duke vazhduar përpjekjet e një viti më parë, në fund të 2015-tës Fondacioni ka prodhuar dokumentarin “Rejected”. Ky dokumentar ka synuar të demistifikojë marrëdhënien në mes të migrimit të Kosovarëve drejt BE-së dhe regjimit të vizave të kësaj të fundit, përmes intervistave me përfaqësues të shoqërisë civile dhe qeveritarëve kosovarë.

Kjo fushatë avokuese ka targetuar tri kryeqytete kryesore të vendeve të BE-së, Brukselin, Berlinin dhe Parisin për të ngritur vetëdijen e politik-bërësve relevantë dhe akterëve kryesorë puna e të cilëve ndikon politikën e vizave të BE-së ndaj Kosovës. Fushata është realizuar në formë të organizimit të diskutimeve në panel, në partneritet me një organizatë vendore në secilin qytet. Këto evente janë menduar të shtjellojnë marrëdhëniet e komplikuar në mes të valës së madhe të migrimit të Kosovarëve në vendet e BE-së dhe regjimit të vizave të imponuar nga këto vende. Event i parë është mbajtur në Berlin në fund të 2015-tës, kurse ai i Brukselit dhe Parisit janë mbajtur në shkurt të 2016-tës.

Panelet e diskutimit të organizuara kanë mbledhur njerëz me peshë në institucionet e tyre përkatëse, duke përfshirë këtu ministra, zëvendës-ministra, ambasadorë nga ana e institucioneve të Kosovës, si dhe përfaqësues të Komisionit Evropian, së bashku me përfaqësues të “think tank”-ëve më me renome në Evropë. Çështje me rëndësi të ngritura gjatë këtyre diskutimeve ishin mundësia e tejkalimit të polarizimit të institucioneve të Kosovës dhe përmbushja e obligimeve të mbetura nga procesi i liberalizimit të vizave; ndikimi i valëve të emigrantëve nga Kosova në fund të 2014-tës si dhe refugjatëve nga Siria në vendimet e vendeve anëtare për heqjen e vizave; implikimet e mundshme për Kosovën në rast se liberalizimi do të stër-vonohej tutje; si dhe mundësitë e fitimit të mbështetjes nga vendet anëtare të BE-së për Kosovën në rrugën e saj të heqjes së vizave.

Fuqia Negociuese e Kosovës kundrejt BE-së

Këtë vit programi i Integritimit Evropian ka filluar një cikël të studimeve rreth temës së “Fuqia Negociuese e Kosovës kundrejt BE-së”. Fillimisht, është mbajtur një takim me akterët kryesorë në këtë aspekt, dhe janë identifikuar elementet kryesore të marrëdhënieve Kosovë-BE, si dhe fushat të cilat do të mund të ishin subjekt i studimeve tona. Përmes granteve për këto studime, është tentuar të skicohet një pamje e tërësishme e proceseve negociuese të Kosovës me institucionet e BE-së, si dhe me vendet anëtare të saj.

Punimi i parë i këtij cikli është “Çka pas MSA-së”, një analizë e situatës brenda Bashkimit Evropian në dinamikat politike të tij në fund të 2016-tës, si dhe pasojat që kjo situatë mund të ketë në veprimet përballë Kosovës, duke pasur parasysh ndasitë e vendeve anëtare rreth shtetësisë së Kosovës për të mundësuar ecjen drejt statusit të kandidatit, hap ky i ardhshëm e i logjikshëm pas nënshkrimit të MSA-së. Analiza është zgjeruar rreth asaj se çka nënkupton nënshkrimi i MSA-së për Kosovën dhe hyrja e kësaj marrëveshjeje në fuqi. Duke qenë se kjo është vetëm fazë fillestare, sfida kryesore e pret shtetin e Kosovës në fazën kyçe, - atë të implementimit, fazë kjo që do të bëhet nën llupën konstante të Brukselit. Implementimi i MSA-së ka treguar të jetë sfidues për secilin vend. Kosova me mangësi të mëdha në kapacitete, do të sfidohet shumë herë në procesin e implementimit. Punimi është publikuar në fillim të nëntorit 2016, në Forum 2016 gjatë sesionit plenar “Ecje nëpër akull: Kushtëzime, sfida dhe reforma drejt BE-së”.

Studimi i ardhshëm i këtij cikli do të realizohet nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike. Me titullin “Baza ligjore e Kosovës ndaj statusit të saj të mundshëm të kandidatit të BE-së”, ky projekt synon të sqarojë implikimet juridike të mos-njohjes së Kosovës nga vendet anëtare të BE-së, në skenarë të mundshëm të kandidaturës së Kosovës për Bashkim Evropian. Për më tepër, ky hulumtim do të ofrojë zgjidhje juridike për problemet e identifikuar. Të gjeturat nga ky studim do të shpërndahej dhe do të avokohet për to në Prishtinë dhe Bruksel, duke ofruar rekomandime për zgjidhjet e propozuara.

Temë tjetër që do të mbulohet është çështja e imazhit të Kosovës, dhe ndikimi i tij në marrëdhëniet e saj me BE-në. Punuar nga Gëzim Krasniqi, ky studim do të fokusohet në dy komponentë të veçantë. Së pari, do të bëjë analizimin e konstelacionit institucional brenda BE-së në kuadër të procesit të zgjerimit, me fokus të veçantë në rolin e konsideratave ekonomike,

politike dhe të sigurisë si dhe perceptimet publike brenda BE-së. Së dyti, projekti do të analizojë fuqinë negociuese të Kosovës në raport me BE-në dhe shtetet anëtare të saj duke analizuar kapacitetet e përgjithshme politike, institucionale dhe njerëzore (hard power); fuqinë ekonomike dhe aftësinë konkurruese të Kosovës dhe bizneseve të saj në zonën e lirë ekonomike evropiane (sticky power); dhe aftësinë për të përdorur mjetë jo-tradicionale për të krijuar avantazh politik dhe përmirësuar imazhin e saj në mesin e vendeve të BE-së (soft-power).

Emri i Projektit	Grantist	Shuma Euro
Çfarë pas MSA-së?	-	4,000
Baza ligjore e Kosovës ndaj statusit të saj të mundshëm të kandidatit të BE-së	Grupi për Studime Juridike dhe Politike	18,720
Analizë e fuqisë negociuese të Kosovës në raport me BE-në dhe shtetet anëtare të saj	-	4,350
Shpenzime tjera programore		8,450
Totali :		35,520

Forum 2015: Zgjerimi i BE-së kah Ballkani – Si na sheh Evropa?

Kjo tryezë është organizuar me rastin e publikimit të raportit të European Policy Center (EPC) me titull Vendet Anëtare të BE-së dhe zgjerimi drejt Ballkanit, ku shqyrtohen konsiderimet e këtyre vendeve në rastet e politik bërjes si dhe barrierat potenciale që ndikojnë pozicionimin e akterëve shtetërorë ndaj çështjes së zgjerimit të BE-së. Me hyrjen e Kroacisë në BE, procesi i zgjerimit drejt Ballkanit duket të jetë vënë në autopilot. Shpesh pengesat në avancimin e agjendës evropiane në këto vende janë zhvilluar brenda BE-së, më konkretisht në shtetet anëtare. Përderisa procedurat e brendshme të BE-së për trajtimin e zgjerimit kanë qenë gjithmonë ndër-qeveritare në natyrë, gjatë viteve të fundit, janë rritur mundësitë dhe rastet për shtetet anëtare të ndërhyjnë në këtë proces, duke dhënë shenja të një ashtuquajtur “nacionalizim” të zgjerimit. Panelistë të këtij diskutimi ishin Ministri i Integritimit Evropian, Bekim Çollaku, Corina Stratulat nga EPC, Ioannis Armakolas nga Hellenic Foundation for European and Foreign Policy (ELIAMEP) si dhe Fisnik Korenica nga Grupi për Studime Politike dhe Juridike.

Forum 2015: Kosova në UNESCO

Në bashkëpunim me organizatën EC Ma Ndryshe, Forumi 2015 ka organizuar një diskutim në panel si përpjekje për të nxitur debat publik mbi hapat që duhet ndjekur institucionet e Kosovës për sa i përket tentativave për tu anëtarësuar në UNESCO. E mbajtur më 14 prill 2016, afër gjashtë muaj pas votës negative, është ndier nevoja për të qartësuar vizionin e vendit për anëtarësim në këtë organizatë, pasi që pas dështimit në grumbullimin e votave të duhura në konferencën e UNESCO-s të mbajtur në nëntor 2015, institucionet e Kosovës nuk kanë dhënë indikacione për ndonjë agjendë apo veprim të radhës. Në pjesën e parë të kësaj tryeze është

prezantuar një analizë e shkurtër e EC Ma Ndryshe mbi shkaqet e dështimit në përpjekjen e parë, dhe janë ofruar sugjerime mbi hapat tutje. Panelistë të këtij diskutimi ishin Petrit Selimi, (atëherë) UD Ministër i Punëve të Jashtme, Caroline Jäger-Klein, eksperte e trashëgimisë kulturore nga Universiteti Teknik i Vienës, Ambasador Dimitris Moschopoulos, këshilltar i institucioneve të Kosovës për trashëgiminë fetare dhe kulturore dhe Sali Shoshi nga Trashëgimia Kulturore pa Kufij.

Implementimi i projekteve të financuara në fund të vitit 2015

Luftimi i korrupsionit politik përmes fuqizimit të sistemit të deklarimit të pasurisë dhe ngritjes së transparencës të financave të subjekteve politike

Gjatë vitit 2016 Çohu! ka filluar hulumtimin e deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publik, ku ka përzgjedhur rreth 80 zyrtarë të lartë nga të gjitha institucionet publike me anë të metodës së rastësishme. Për këta zyrtarë është kontrolluar pasuria prej vitit 2010 deri në 2016, janë krahasuar lëvizjet e pasurisë së këtyre zyrtarëve ndër vite, pasurit e luajtshme dhe të paluajtshme, i është kushtuar rëndësi kohës së fitimit të atyre pasurive etj. Të gjitha këto të dhëna janë të vendosura në një bazë të dhënash në Excel, dhe tani janë në përpunim që të publikohen në opendatacohu.org. Paralelisht është duke u përfunduar edhe drafti i final i hulumtimit i dalë nga këto të dhëna. Përveç kësaj, Çohu! ka realizuar një hulumtim lidhur me financimin e partive politike në Kosovë, mënyrën e financimit, analizimin e bazës ligjore dhe rekomandimet se si të dilet nga kjo mënyrë klienteliste e financimit të partive politikë. Kjo analizë është publikuar në një tryezë të gjerë diskutimi me 07-12-2016 në kuadër të kampanjës së javës Kundër Korrupsionit. Punimi në fjalë ka sjellë një perspektivë mbi financimin e partive politike në Kosovë duke pasur për bazë tre realitete të etabluara: (1) Mungesa e auditimit të financave të partive politike, (2) Kritikrat dhe standardet ndërkombëtare, (3) Mos-implementimi i Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike. Përgjatë rrjedhës së projektit, Çohu ka reaguar lidhur me dështimin e Kuvendit të Kosovës që për katër herë më radhë ka dështuar të përzgjedhë auditorët që do të bënin auditimin e pasqyrave financiare të partive politike për katër vitet e kaluara 2013-16, dhe për dy palë zgjedhje, ato lokale dhe të përgjithshëm.

Monitorimi dhe Vlerësimi i Planit Kombëtar të Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit

Grupi Për Studime Juridike dhe Politike ka monitoruar punën e institucioneve të Republikës së Kosovës në përmbushjen e obligimeve të dala nga matrica e masave afatshkurtra të planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA). Ky plan u miratua nga Qeveria e Kosovës më 16 dhjetor 2015, dhe nga Kuvendi më 10 Mars 2016. Duke pasur parasysh rëndësinë që ka MSA-ja në rrugën drejt BE-së dhe në zhvillimin e vendit, GLPS ka ndjekur për së afërmi punën e institucioneve relevante që të evidentojë arritjet dhe sfidat gjatë këtij procesi. Pas monitorimit të gjashtë-mujorit të parë, GLPS ka organizuar një konferencë ku ka kritikuar institucionet për mos-zbatimin e këtij plani në afat të duhur kohor. Ndër tjerash, të dhënat nga ky monitorim

tregojnë se (1) aftësia e institucioneve për të hartuar bazamentin ligjor në linjë me Acquis mbetet e ulët, (2) Mungon bashkëpunimi proaktiv ndërinstytucional, (3) Ka nevojë për ndarje të qartë të përgjegjësisë brenda institucioneve dhe organizim më efikas të burimeve njerëzore, (4) Mungon vullneti politik për të prioritetizuar PKZMSA-në si plan ditor të punës. Të dhënat për gjashtëmujorin e dytë do të publikohen në shkurt të vitit 2017, pasi që afati për raportim nga institucionet e Kosovës për implementimin e indikatorëve të mbetur është mesi i Janarit 2017.

Kosova në kontekstin e bashkëpunimit policor rajonal: gjendja ekzistuese dhe hapat tutje

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë ka marrë përsipër realizimin e këtij projektin me qëllim të ngritjes së pjesëmarrjes së Kosovës në iniciativat rajonale të sigurisë, si dhe për promovimin e bashkëpunimeve bilaterale policore. Gjatë këtij viti janë publikuar hulumtimet “Nyja e Gordianit: Pengesat e Kosovës për Anëtarësim në organizatat ndërkombëtare të sigurisë – Rasti i INTERPOL-it”. Hulumtimi trajton kontekstin e përfaqësimit dhe anëtarësimit të Kosovës në nismat rajonale dhe evropiane të sigurisë, si dhe bashkëpunimin policor të Kosovës me shtetet tjera. Aty shqyrtohet rëndësia e anëtarësimit të Kosovës në këto nisma, sfidat e deritanishme dhe roli i Marrëveshjes së Brukselit për bashkëpunim rajonal në mes Kosovës dhe Serbisë. Marrëdhëniet e Kosovës me INTERPOL-in, të cilat zhvillohen në mënyre të tërthortë përmes UNMIK-ut, mosbashkëpunimi në nivel të duhur ndërmjet institucioneve kosovare për anëtarësim në INTERPOL, si dhe mbështetja e këtij procesi nga shtet përkrasë të Kosovës përbëjnë një pjesë të rëndësishme të kësaj ndërmarrjeje. Hulumtimi në fjalë ka propozuar dy skenarë që do të mund ta shpinin Kosovën drejt anëtarësimit në INTERPOL. Në skenarë jepen arsyet për nevojën e menjëhershme të Kosovës me qëllim të zbatimit të ligjit, si dhe parandalimit e luftimit të krimeve që tejkalojnë kufijtë shtetërorë, ku Kosova mund të japë kontributin e saj.

Ngritja e skelës: Analizë e efekteve të Instrumentit të Asistencës së Para-anëtarësimit në ekonominë e Kosovës

Mbështetur nga KFOS, Besa Shahini analizon Instrumentin për Ndihmën e Para-Anëtarësimit (IPA) në Kosovë, si dhe ndikimin e mundshëm të tij në ekonominë e Kosovës, në kontekstin e situatës aktuale ekonomike pas nënshkrimit të MSA-së me BE-në. Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje solli në pah sfida të reja për Kosovën; Presionet buxhetore dhe ato të konkurrencës që rrjedhin si pasojë e liberalizimit të tregtisë me BE-në, do të mund të sforcjnë prodhuesit vendorë dhe buxhetin e Kosovës. Analiza e Shahinit shqyrton atë se si reformat e financuara nga IPA do të mund të ndikojnë në liberalizimin e tregut për ekonominë e Kosovës. Më 8 nëntor 2016, Shahini ka prezantuar punimin e saj në një panel diskutimi të organizuar nga European Policy Centre në Bruksel, ku ka theksuar sfidat me të cilat Kosova po përballlet në hyrjen në fuqi të MSA-së, si dhe nevojën e ri-drejtimin të fondeve të IPA-s drejtë projekteve dhe aktiviteteve me ndikim të drejtpërdrejtë në prodhim dhe rritje të eksportit.

Thellimi i Njohurive mbi BE-në

Shkolla e Integritimit në BE ka mbetur një ndër instrumentet kyçe të fondacionit në transferimin e njohurive mbi politikat e BE-së tek profesionistët e kësaj fushe. Një dekadë më parë kjo shkollë fokusohej në njohuri bazike, dhe implementohej në partneritet me Fondacionin Kosovar për Shoqëri Civile. Që nga 2015, fondacioni ka modifikuar qasjen duke sofistikuar këtë instrument të transferit të njohurive.

Shkolla mbi BE-në është në transformim e sipër në një institucion edukativ, të ri-organizuar në module tematike të specializuara të cilat adresojnë politika specifike të BE-së nëpërmjet punëtorive 2-ditore. Implementuar nga organizatat tona partnere, këto punëtori mbledhin bashkë ekspertë akademikë dhe institucionalë, duke filluar nga ata vendorë deri tek ata të rajonit dhe Bashkimit Evropian. Në vitin 2016, përpos EC Ma Ndryshe, Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë dhe Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë i janë shtuar edhe dy organizata të reja, Lëvizja FOL dhe Instituti Demokratik i Kosovës, duke shtuar kështu edhe numrin dhe llojllojshmërinë e temave të trajtuara në këtë cikël të shkollës.

Emri i Projektit	Grantist	Shuma Euro
Organizimi dhe realizimi i Modullit për Thellim të Njohurive Evropiane në temën e Planifikimit Urban dhe atë të Trashëgimisë Kulturore	EC Ma Ndryshe	8,450
Organizimi dhe realizimi i Modullit për Thellim të Njohurive Evropiane në temën e Ballafaqimit me presionin konkurrues në treg dhe atë të drejtave të pronësisë intelektuale dhe industriale në BE	Oda Amerikane e Kosovës	5,000
Organizimi dhe realizimi i Modullit për Thellim të Njohurive Evropiane në temën e Reformimit të Sektorit të Sigurisë si dhe atë të Ndërtimit të Kapaciteteve në Parandalimin dhe Luftimin e Ekstremizmit të Dhunshëm	Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë	5,000
Organizimi dhe realizimi i Modullit për Thellim të Njohurive Evropiane në temën e Mbrojtjes së Informatorit dhe atë të Deklarimit të Pasurisë	Lëvizja FOL	5,000
Organizimi dhe realizimi i Modullit për Thellim të Njohurive Evropiane në temën e De-konstruktimit të korrupsionit dhe luftimit të tij dhe atë të Integritetit në institucionet publike	Instituti Demokratik i Kosovës	5,000
Shpenzime tjera programore	9,450	
Totali :	37,900	

Kjo qasje inovative është treguar e suksesshme për sa i përket ngritjes së interesimit të një num-

ri të madh të profesionistëve dhe praktikuesve të politikave publike që lidhen me prioritetet e agjendës evropiane në Kosovë. Pas seleksionimit, pjesëmarrja në modulet e organizuara ka shkuar nga 25 pjesëmarrës deri në 53 sosh, siç ishte rasti me modulën e fundit të organizuar në fund të Nëntorit 2016. Komponentë tjetër e rëndësishme ka qenë llojllojshmëria e prapavijave të pjesëmarrësve në këto module. Varësisht nga tematika e modulit, punëtoritë kanë mbledhur së bashku profesionistë nga sektorë të ndryshëm: qeveritarë, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, bizneset etj. Në këtë mënyrë, modulet kanë ofruar një platformë që mundëson mbledhjen së bashku të akterëve dhe hisedarëve të një çështjeje të caktuar, që ndoshta për herë të parë kanë pasur rastin të diskutojnë dhe të sjellin në pah nevojat, interesat dhe përvojat e tyre për ti krahasuar ato me njëri tjetrin.

Vlerë shtesë në këto punëtori ka qenë përfshirja e ekspertëve rajonale dhe atyre të BE-së në përmbajtjen e moduleve. Ligjëratat dhe diskutimet në panel janë drejtuar nga ekspertë në çështjet e Integritimit Evropian nga organizata të dalluara rajonale. Mes tjerësh, këtu ja vlen të përmendim

Cornelia Abel nga Sekretariati i Transparency International, Gentian Elezi, ish-zëvendës Ministër i Integritimit Evropian në Shqipëri, Gabriel Sipos nga Transparency International në Sllovaki, Malinka Ristevska Jordanova nga European Policy Institute në Maqedoni. Për më tepër, ligjëruesit dhe panelet e diskutimit janë përbërë nga përfaqësues të nivelit të lartë të degëve të legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit, duke përfshirë këtu deputetë, kryesues të komisioneve parlamentare, zëvendës-ministra dhe ambasadorë të Republikës së Kosovës.

Grantet Operacionale për Implementimin e Moduleve

Emri i Modulit	Shuma në euro
Moduli 1: Urbanizmi dhe çështjet e menaxhimit urban	6,972
Moduli 2: Konservimi i integruar i trashëgimisë kulturore	6,170
Moduli 3: Pjesëmarrja publike në Planifikim Hapësinor	6,113
Moduli 1: Ballafaqimi me presionin konkurrues në treg	8,607
Moduli 2: Të drejtat e pronësisë intelektuale dhe industriale në Bashkimin Evropian	8,654
Moduli 1: Qeverisja e Sektorit të Sigurisë: Policimi me anë të inteligjencës	12,913
Moduli 2: Preventimi i Ekstremizmit dhe Deradikalizimit	10,235
Moduli 1: Deklarimi i Pasurisë dhe Ligji Antimafia	4,490
Moduli 2: Mbrojtja e Informatorëve	5,010
Moduli 1: Dekonstruktimi i korrupsionit dhe luftimi i tij	9,620
Moduli 2: Integriteti në institucionet Publike	6,916
<i>Shpenzime tjera programore</i>	15,280
Totali :	100,980

TË LIDHESH ME EVROPËN

Të lidhesh me Evropën

Edhe gjatë vitit 2016, Fondacioni ka vazhduar me përmirësimin e marrëdhënieve me 5 shtetet e BE-së mosnjohëse dhe 2 të Ballkanit, për të intensifikuar lidhjet midis shoqërisë kosovare dhe atyre të shteteve 5+2, nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme:

Greqi - Adresimi i problemit të stereotipeve negative kombëtare në Ballkanin jugor

Me Athinën ka vazhduar bashkëpunimin mbi atë që është ndërtuar gjatë disa viteve të kaluara nga partneri ELIAMEP. Duke i shfrytëzuar hulumtimet e mëparshme, këtë vit është bërë adresimi i problemit të stereotipeve negative në Ballkanin jugor, me punëtrori të mbyllura për mediat dhe opinion bërësit në Greqi. Gjatë fazës së fundit është bërë analiza e stereotipeve negative kombëtare rreth Kosovës dhe shqiptarëve në marrëdhëniet multi dimensionale midis Greqisë dhe Kosovës. Shënimet dhe analiza janë gjeneruar nga: a) një studim i detajuar i përfaqësimit të Kosovës në mediat greke, e cila i është shtuar punës së kryer më herët nga ELIAMEP, atë përfaqësimit të Shqipërisë në mediat greke. Kjo ka krijuar një fotografi shkencore dhe gjithëpërfshirëse të problemit të përfaqësimit negativ të Kosovës dhe Shqipërisë në përgjithësi në mediat greke; b) është bërë vazhdimi i monitorimit të raportimit në mediat greke të çështjeve aktuale të Kosovës, sidomos në mediat me influence; c) vazhdimi i monitorimit të marrëdhënieve diplomatike, ekonomike dhe shoqërore në med të Kosovës dhe Greqisë; d) draftimi i një numri të analizave të shkurtëra rreth zhvillimeve aktuale politike dhe sociale të Kosovës. E gjitha kjo, do të krijojë një bazë për raportim më objektiv dhe më pozitiv i çështjeve kosovare në Greqi.

Rumani - Vizita e delegacionit kosovar në Bukuresht

Në Rumani, nëpërmjet partnerit tonë CRPE, kemi përfunduar një aketë me 200 parlamentarë rumunë, mbi perceptimet e tyre për Kosovën moderne. Ky instrument ka shërbyer si manual për delegacionin kosovar që në takimet e radhës në Rumani, të jenë më të përgatitur për mënyrën se si ti çasen vendimmarrësve rumunë, duke i ditur perceptimet e tyre për Kosovën.

Më 11-14 tetor është organizuar vizita e delegacionit kosovar në Bukuresht. Janë mbajtur takime me diplomatë rumunë, me anëtarë të Partisë Nacionale Liberale, me përfaqësues të Asociacionit për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në Rumani, në ambasadën Britanike – takim me gjyqtarë dhe prokurorë, me pjesëtarë të Aleancës Demokratike të hungarezëve në Rumani. Gjithashtu, në ASPEN Institute është bërë edhe prezentimi i të gjeturave preliminare të anketës. Pjesëmarrës në këtë takim ishin: Gjylieta Mushkolaj – Profesoreshë në Universitetin e Prishtinës, Dardan Sejdiu – Nënkretar i Komunës së Prishtinës, Agon Maliqi – Përfaqësues i medias, Besa Luci – Drejtore e Kosovo 2.0, Arben Gashi – deputet në Kuvendin e Kosovës, Gent Salihu – këshilltar i Ministrit të Drejtësisë, Alban Hashani – Riinvest, Lumir Abdixhiku –

Riinvest, dhe Dukagjin Pupovci – Drejtor, Qendra për Arsim e Kosovës.

Iniciativa tjera

Fondacioni, nëpërmjet programit për Integrim Evropian, ka mbështetur edhe iniciativa tjera kreative, në mënyrë që të përafrojmë qytetarët e Kosovës me ata të vendeve që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës.

Është bërë një intervenim artistik mbi realitetin e jetërave në Kosovë dhe Serbi, me shfaqjen Enciklopedia e të Gjallëve nga Qendra Multimedia.

Kurse në kuadër të festivalit tashmë tradicional Mirëdita, Dobar Dan! janë mbështetur pjesë të aktiviteteve kulturore (shfaqje teatrale) të cilat janë mbajtur në Beograd.

Gjithashtu janë mbështetur edhe debatet që janë mbajtur në Beograd dhe në Prishtinë, si dhe përkthimi dhe prezentimi i librit të Veton Surroit – Ambasadori i Melkizedekut.

Ndërsa, si pjesë e aktiviteteve për intensifikimin e bashkëpunimit kulturor midis Kosovës dhe Sllovakisë, kemi sjellur teatrin Kolomaz për të performuar në festivalin e monodramas Monoakt, që është mbajtur nga 26 qershori deri më 2 korrik 2016, në Pejë.

Është mbajtur takimi strategjik në Vienë me OJQ-të partnere nga Greqia, Rumania dhe Sllovakia, nga i cili u zhvilluan dy projekte. 1) Zhvillimi i njohurive të shtetësisë së re në Evropën Juglindore: Politikat e jashtme dhe të brendshme të Kosovës, dhe 2) Politikat e mosnjohjes: Mësimet e nxjerra dhe transferimi i njohurive.

Duke analizuar situatën në të cilën gjendet Kosova sa i përket reformave integruese, Grupi për Studime Juridike dhe Politike së bashku me Forum 2015 kanë organizuar një konferencë me temë “Ecje nëpër akull: Kushtëzime, sfida dhe reforma drejt BE-së”. Kjo konferencë ka bërë së bashku diplomatë, politikë-bërës, media dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Qëllimi kryesor i kësaj konference ishte të nxjerr në pah sfidat me të cilat ballafaqohet Kosova vis-à-vis, si drejt qeverisjes së mirë, ashtu dhe drejt procesit të integritimit Evropian.

Dokufest 2016

Festivalin Dokufest, këtë vit, Fondacioni e ka mbështetur nga dy programet e saja strategjike, ai i Transparencës dhe Llogaridhënies, dhe ai i Integritimit Evropian. Nga programi i Integritimit Evropian është mbështetur aktiviteti i gazetarëve nga 5 vendet e BE-së dhe 2 të rajonit, të cilat ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës.

Këtë vit festivali solli 8 gazetarë. Pjesëmarrësit u emëruan nga rrjeti i partnerëve dhe bashkëpunëtorëve të Fondacionit, dhe pastaj u ftuan të marrin pjesë. Që nga nisja e projektit para 5 vitesh, ky vit ishte hera e parë që mysafirët e konfirmuar erdhën nga të 7 vendet dhe atë:

1. Hilma Unkic, Mediacentar, BeH,

2. Samuel Marec, Dennik.sk, Sllovaki,
3. Žarka Radoja, Radio Free Europe, Serbi,
4. Marianna Katsaouni, Free lance photographer, Greqi,
5. Iulian-Mihail-Aureliu Comanescu-Petică (Dilema veche, Mediafax, Șapte Seri, Comanescu.ro), Rumani,
6. Feliciano Manuel Tisera Pardiñas, Bez.es, Spanjë,
7. Alexia Evripidou, Cyprus Mail, Qipro,
8. Stephen Nugent, Nomad Films, Qipro,

Përbërja e pjesëmarrësve të këtij viti ishte e veçantë për shkak të disa karakteristikave që nuk ishin më parë. Së pari, kjo ishte hera e parë që nga nisja e projektit para pesë vitesh që gazetarët e konfirmuan erdhën nga të shtatë vendet mosnjëohëse të synuara nga projekti *Connecting with Europe*. Ky diversitet dhe kjo mbulueshmëri krijon bazë për arritjen e qëllimit të ndërtimit të një imazhi pozitiv për Kosovën njëkohësisht në secilin prej 5 vendeve të BE-së dhe 2 vendeve në rajon. Së dyti, projekti për herë të parë ishte nikoqir i pjesëmarrësve nga Qiproja. Gazetarja e Cyprus Mail-it, Alexia Evripidou, dhe producenti Stephen Nugent nga Nomad Films erdhën me plot kureshtje për ta eksploruar Dokufestin, Prizrenin, dhe Kosovën dhe për ta prezentuar pastaj përvojën e tyre me një video produksion dhe disa tekste. Së treti, këtë vit Fondacioni ishte nikoqir i një pjesëmarrësi i cili po vinte këtu për herë të dytë. I ngazëllyer nga përvoja me programin e vitit të kaluar, Feliciano Tisera, i cili shkruan për portalin Bez.es në Spanjë, shprehu interesimin e tij të marrë pjesë përsëri, dhe të vazhdojë të krijojë vëmendje pozitive për Kosovën nëpër media spanjolle.

Ngjajshëm me vitin e kaluar, Fondacioni organizoi një program shtesë përveç atij të Dokufestit për ta pasuruar përvojën kosovare të gazetarëve dhe për t'i njoftuar ata me aspektet tjera të progresit dhe shtetndërtimit të Kosovës gjatë viteve të shkuara.

Zhvillimi i njohurive të shtetësisë së re në Evropën Juglindore: Politikat e jashtme dhe të brendshme të Kosovës

Ky projekt i nivelit rajonal ka për qëllim të mbushë një boshllëk në bazën e njohurive që disa vende të rajonit të Ballkanit kanë për Kosovën bashkëkohore. Në një numër të projekteve të mëparshme (për shembull, në projektet e zbatuara nga ELIAMEP dhe CRPE) është bërë e qartë se vendet që nuk e kanë njohur Kosovën ose mbajnë interaksion të kufizuar me te, ose të dyja, ka një deficit serioz të studimeve profesionale jo-stereotipike rreth shtetit të ri të pavarur. Përndryshe, debati publik është ende i dominuar nga mitet dhe stereotipet që kanë qarkulluar që nga fillimi i krizës jugosllave rreth 25 vjet më parë. Ky projekt ka për qëllim që pjesërisht të përmirësojë këtë problem, por edhe të ndihmojë hulumtuesit e rinjë dhe dinamikë, që të prodhojnë dije të re për Kosovën moderne. Gjithashtu, projekti ka për qëllim të bëjë ekspozimin

e hulamtuesve me përvojën direkte të Kosovës, koordinimin e hulamtuesve nga Kosova dhe vendet tjera, si dhe formimin gradual të një rrjeti të hulamtuesve të përbashkët.

Është **mbajtur në Selanik** takim strategjik me partnerët e projektit për zhvillimin e planit të veprimit. Pas zhvillimit të projektit **është bërë edhe** shpallja e konkursit në Sllovakia, Rumani, Greqi, Qipro, Spanjë, **Serbi dhe Bosne e Hercegovinë**, nepermjet partnerëve dhe mediave sociale. Për një periudhë të shkurtër kemi arritur që të rekrutojmë **16 hulamtues të rinjë (nga Sllovakia, Shqipëria, Qiproja, Greqia, Rumania, Izraeli, Republika Çeke)**, dhe **5 mentorë** (nga SHBA, Britania e Madhe, Greqia, Maqedonia), të cilët gjatë tërë kohës kanë punuar me hulamtuesit. Hulamtuesit, janë të botës akademike, dhe ose kanë të përfunduar doktoratat, ose janë në përfundim e sipër. Shumica prej tyre janë ligjerues në Universitete prej nga vijnë, gjë që e bën më të përshtatshme diseminimin e analizave të tyre.

Takimi i parë i 16 hulamtuesve dhe 5 mentorëve **është mbajtur** në Universitetin Macedonia ne Selanik, me ç'rast janë **mbajtur** ligjerata për **teknikat e hulamtimit**, ligjeratë për diplomacinë kosovare, si dhe janë **organizuar** punë grupore dhe individuale me mentorët.

Projekti gjithashtu ka paraparë **edhe një vizitë** kërkimore në Kosovë, e cila është realizuar prej 23-29 tetor. Hulamtuesit kanë pasur mundësi të takohen dhe të intervistojnë zyrtarët rreth temave të tyre. Gjithashtu, më 27 tetor, e kemi organizuar një tryezë tërë ditore, me ç'rast janë diskutuar arritjet e tyre, planet e diseminimit, si dhe i kemi ftuar 4 think-tank organizata lokale që ta bëjnë prezentimin e punës së tyre (të katër organizatat nga lëmitë për të cilat shkruhet nga hulamtuesit.)

Politikat e mosnjohjes: Mësimet e nxjerra dhe transferimi i njohurive

Synimi kryesor është të shqyrtojë dhe të shpjegojë mënyrat e ndryshme në të cilat anëtarë të Bashkimit Evropian angazhuar me Kosovën. Ajo shqyrton praktikat e veçanta të një sërë shtetesh në katër kategori - duke filluar nga mbështetësit e fortë deri kundërshtarëve të fortë. Duke vepruar kështu, projekti do të konstatojë se ku ka vend për zgjerimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dypalëshe mes shteteve anëtare të BE-së dhe Kosovës.

Disa vjet pas shpalljes së pavarësisë, Kosova ka tërhequr shumë njohje, por nuk ka arritur të konsolidojë plotësisht statusin e saj ndërkombëtar. Ekziston një nevojë urgjente për reflektim mbi pikat e forta dhe të dobëta të përpjekjeve diplomatike të Kosovës, për të kuptuar nuancat prapa qëndrimeve të mos-njohësve apo njohësve ngurrues, derisa njëkohësisht mëton ndërtimin e kapaciteteve të institucioneve shtetërore dhe diplomatike të Kosovës. Ky projekt ka për qëllim të përditësojë dhe sistematizojë njohurinë tone rreth politikave të mos-njohjes, apo mos-përkrahjes së Kosovës në procese dhe mekanizma ndërkombëtarë.

Projekti i ka dy komponente:

1. Analiza e politikave të shteteve mos-njohëse (Greqia, Rumania, Sllovakia, Spanja, Qiproja), apo njohëse por jo përkrahëse (Polonia me rastin e UNESCO-s) që do të punohen nga 9 autorë nga vendet respektive (që të gjithë profesorë/hulumtues të avancuar në Universitete të njohura në Evropë). Në mënyrë që të arrihet rezultat krahasues, do të analizohen edhe rastet e shteteve që e kanë njohur pavarësinë e Kosovës dhe i dalin në përkrahje në secilin proces (Britania e Madhe dhe Gjermania). Pra, projekti vendosë një matricë, e cila do ti shpjegojë politikën e:
 - a. Vendeve mos-njohëse, por që e përkrahin (apo nuk e pengojnë) Kosovën në procese të rëndësishme integruese (Greqia, Sllovakia dhe Rumania)
 - b. Vendeve njohëse, por që nuk e përkrahin Kosovën në procese integruese (Polonia dhe Republika Çeke)
 - c. Vendeve kategorikisht mos-njohëse (Qiproja dhe Spanja)
 - d. Vendeve njohëse dhe përkrahëse (Britania e Madhe dhe Gjermania)
2. Transferimi i njohurive nga të gjeturat dhe ngritja e kapacitetit të politikëbërësit kosovar, që do të bëhet nëpërmjet punëtorive të mbyllura

Projekti implementohet gjatë pjesës së parë të vitit 2017, kurse deri tani janë identifikuar autorët e analizave dhe është marrë përkushtimi i tyre.

Emri i Projektit	Grantist	Shuma Euro
Adresimi i problemit të stereotipeve negative kombëtare në Ballkanin jugor	ELIAMEP	29,905
Vizita e delegacionit kosovar në Bukuresht	Operational	10,289
Enciklopedia e të Gjallëve II	Qendra Multimedia	7,500
Mirëdita, Dobar Dan!	NGO Integra	17,600
Ambasadori i Melkizedekut	Samizdat	4,200
Platforma Prizreni 2020	Ec Ma Ndryshe	8,000
Prezentimi i teatrit sllovak Kolomaz në festivalin Monoakt në Pejë	Kolomaz Theatre	2,572
Dokufest 2016 – gazetarët	Operational	14,329
Zhvillimi i njohurive të shtetësisë së re në Evropën Juglindore: Politikat e jashtme dhe të brendshme të Kosovës	Operational	131,108
Politikat e mosnjohjes: Mësimet e nxjerra dhe transferimi i njohurive	Operational	13,500
Hulumtim i projektit “isms”	Rita Knudsen	1,275
Takim me OJQ-të partnere në Vienë	Operational	6,444
Let Go EU	INSPR	8,850
Konferenca në Sarajevë mbi bashkëpunimin kulturor dhe turistik mes Kosovës dhe Bosnjë e Hercegovinës	Ec Ma Ndryshe	2,450
Konferenca: “Ecje nëpër akull: Kushtëzime, sfida dhe reforma drejt BE-së”	GLPS	2,000
Shpenzimet tjera programore		46,074
Total :		306,096

Platforma Open 333

Open 333 është platformë avokuese e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Ajo sjell temat dhe çështjet më sfiduese që dalin nga dinamikat politike dhe sociale në vend.

Open 333 sjell 3 mendime të 3 personaliteteve brenda 3 minutave.

Edicionet që janë punuar gjatë vitit 2016 kanë trajtuar këto tema:

1. Kush janë shkaktarët e krizës në Universitetin e Prishtinës? (Ramadan Zejnullahu, Dukagjin Pupovci, Rron Gjinovci)

2. Investimet Kapitale (Alban Zogaj, Lorik Bajrami, Alban Hashani)
3. Çka mendojnë serbët e Kosovës për Asociacionin e Komunave serbe në Kosovë (Miodrag Milicevic, Naim Rashiti, Nenad Djurdjevic)
4. Punët e Qeverisë në Një Minutë: Ndërtimi i Autostradave
5. Punët e Qeverisë në Një Minutë: Tentimi i privatizimit të PTK-së
6. Punët e Qeverisë në Një Minutë: Koncesionimi i aeroportit
7. Punët e Qeverisë në Një Minutë: Privatizimi i KEDS-it
8. Pse Kosova nuk ka strategji afatgjate të energjisë?
9. Të arriturat e Shoqërisë Civile gjatë 2016 – pjesa I (CIVIKOS, Cohu, INPO)
10. Të arriturat e Shoqërisë Civile gjatë 2016 – pjesa II (QKSS, Ec Ma Ndryshe, KEC)
11. Të arriturat e Shoqërisë Civile gjatë 2016 – pjesa III (GLPS, KDI, FOL)

Gjithashtu, gjatë 2016, Open 333 i ka bashkuar forcat me sbunker për bashkëpunim në një projekt gjashtë mujor tematik për të nxitur një seri debatesh konkrete. Komunikimi përmes video mesazheve dhe mediave sociale po bëhet gjithmonë e më efektiv në tërheqjen e vëmendjes dhe në ndikimin në diskurs publik. Përmes këtij bashkëpunimi shtrihet ndikimi i ideve përtej rrethit të ngushtë të lexuesve të bllogut (sbunker) apo vetëm shikuesve të Open 333, dhe depërton më lehtë tek masa më të gjëra. Secili edicion i Open 333 përcillet edhe me dy shkrime rreth temës së njëjtë nga autorët e sbunker.

Deri tash, janë realizuar dy edicione:

1. Çka shtrembërojnë librat e historisë në Ballkan? (Shkelzen Gashi, Ermal Hasimja, Bekim Blakaj)
 - a. Shkrimi: Çfarë shtrembërojnë librat e historisë në Ballkan? - Armanda Hysa
 - b. Shkrimi: Logjika e falsifikimit të historisë - Anna Di Lellio
2. Çfarë sjell ligji për Trepçën? (Luan Shllaku, Iraj Hashi, Muhamet Mustafa)
 - a. Shkrimi: Aktet juridike nuk mjaftojnë për zhvillim ekonomik - Besnik Pula
 - b. Trepça – bekim apo mallkim - Kujtim Dobruna



RILIDHJA E MITROVICËS

Rilidhja e Mitrovicës

Prapavija

Mitrovica veriore, një ndër vatrat më të shquara të konflikteve politike në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe shqipëtarëve dhe serbëve të Kosovës vazhdon të jetë një ndër qytetet më të ndara në botën e sotme. Ndarja gjeografike, me lumin Ibër në mes, përpos që ndanë një qytet në anën veriore dhe jugore simbolizon edhe ndarjen etnike, politike e sociale, tensione të vazhdueshme në mes të dy shteteve e dy komuniteteve të cilët jetojnë gati plotësisht të ndarë dhe të larguar nga njëri tjetri. Ky lum përpos ndarjes në mes të serbëve dhe shqipëtarëve të Kosovës bënë edhe ndarjen e sebëve, në ata të cilët jetojnë në veri dhe atyre të cilët jetojnë në Kosovën qendrore dhe lindore duke krijuar kështu nivele të ndryshme të zhvillimit dhe integritimit dhe ndarjeve dhe tensioneve prej më të ndryshmeve si në mes të shqipëtarëve e servëve ashtu edhe në mes të vet serbëve.

Viti 2016 u karakterizua me shumë tensione politike në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ligji për Trepçën, fillimi i punës në rinovimin e urës mbi lumin Ibër, ngritja e murit buzë Ibrit në anën veriore, ngrirja e pjesëmarrjes së deputetëve Serb në parlamentin e Kosovës, përplasjet rreth krijimit të Asociacionit të komunave me shumicë serbe janë vetëm disa çështje rreth të cilave u përplasën politikat e Kosovës dhe Serbisë dhe si rezultat ngritën tensionet në mes të qytetarëve shqipëtarë dhe serb në Kosovë.

Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë i lehtësuar nga Bashkimi Evropian vazhdoi edhe gjatë vitit 2016 por u karakterizua me shumë paqartësi dhe deklarata të ndryshme nga dy palët. Këto deklarata, shpesh herë edhe të kundërta, gjatë tërë procesit e në veçanti gjatë vitit 2016 ndikuan që dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë të shihen nga qytetarët e të dyja shteteve si jo transparente dhe pa intencë që marrëveshjet edhe të zbatohen. Akuzat e dy palëve të prfshira në dialog nuk lehtësuan fare jetën e qytetarëve të rëndomtë dhe nuk ndikuan në normalizimin e marrëdhënieve të këtyre dy shteteve edhe pse ai është synimi kryesorë i tij.

Mundësinë për intervenim në Mitrovicë Fondacioni e pa menjëherë pas parafimit të marrëveshjes në mes të Prishtinës dhe Beogradit në Prill të 2013. "Sagën" e Mitrovicës Fondacioni e hapi në vitin 2014 me fillimin e zbatimit të konceptit Rilidhja e Mitrovicës. Që nga atëherë ky koncept ka një trajektore në ngritje, përkundër shumë sfidave që erdhën falë tensioneve politike në mes të dy shteteve.

Viti 2014 ishte vit kur Fondacioni u përkushtua më shumë në hulumtim të terrenit, gjetjen e partnerëve të besueshëm, relevant dhe me përkushtim për të shtyrë përpara agjendën e Fondacionit të përcaktuar me strategji të vet dhe për të vendosur bazamentin në troll të sigurtë për vitet në vijim. Rezultatet e para u arriten në vitin 2015 me tashmë shtylla programore mirë të vendosura ndërsa ekspansioni i punës u pa gjatë vitit 2016. Prezenca e Fondacionit në Mitrovicë, e cila në fillim ishte nga pak e marrëshme, tashmë është dominante karshi iniciativave

të donatërëve tjerë dhe ka ndikuar në hapjen graduale të shoqërisë në veri duke ndikuar në aktivizimin e një fryme të re në shoqërinë civile në veri. Viti 2016 ishte përplot iniciativa të organizatave të shoqërisë civile e cila u zgjua nga gjumi dhe frymëzënia nga ato OJQ të cilat për më shumë se 15 vjet ishin “kujdestarë” për grante nga donatorët e mëdhej por të cilat nuk arritën shumë, apo edhe nuk u munduan që ta ngjallin veriun dhe ta përfshijnë qytetarin në projektet e veta. Tani, edhe pse ende me shumë sfida, në veri vlonë nga projektet dhe iniciativa të ndryshme të OShC-ve, grupeve të rinjëve, ekspertëve, akademisë, përfaqësuesve të institucioneve lokale, artistëve, etj.

Qëllimi i konceptit, objektivat dhe aktivitetet e parapara për 2016

Synimi i konceptit Reconnecting Mitrovica është të nis një proces cilësor të kultivimit të shoqërisë së fuqishme civile, të ndërtohen lidhje më të mira e më të forta ndërmjet grupeve të shoqërisë civile, atyre akademike, të biznesit si dhe ndërmjet grupeve të tjera të qytetarëve nga të dyja anët e lumit Ibër dhe përmes këtyre grupeve të ushtrohet presion konstruktiv ndaj vendimmarrësve për zbatim të marrëveshjes në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe qeverisë lokale e cila do të duhej të siguroj ofrim të shërbimeve cilësore për qytetarët e vet.

Qëllimi –Rilidhja graduale e Mitrovicës dhe veriut të vendit me shumicë serbe me pjesën tjetër të Kosovës.

Për të arritur qëllimin e konceptit Fondacioni dizajnoj **objektivat** dhe **aktivitetet** e ndërlidhura mirë si në vijim:

1. Përkrahja për projektet hulumtuese dhe avokuese të OShC-ve dhe monitorimi i zbatimit të marrëveshjes së Brukselit,
2. Njoftimi me principet bazë të BEs për media, OShC dhe zyrtarë komunal – Shkolla për integrim evropian
3. Trendet dhe nivelet e Integritit Serb.

Për të përmbushur objektivat e konceptit, Fondacioni në 2016 mbështeti:

- **Organizata të shoqërisë civile** për të hulumtuar dhe më pas avokuar për çështjet e studijuara e të cilat ndikojnë në kualitetin e jetës së tyre dhe nivelin e integritit në shoqërinë kosovare;
- **Mediat** të cilat përcjellën, përkrahën dhe amplifikuan zërin e shoqërisë civile gjatë fushatave avokuese të zbatuara nga OShC-t dhe ngritën edhe vet çështje me relevancë për komunitetin Serb në Kosovë,
- **Organizata të shoqërisë civile nga rajoni**, eksperte në fusha të ndryshme të cilat ofruan

shërbime në ngritje të kapaciteteve të OJQ-ve lokale;

- **Grupe formale dhe jo formale të të rinjve** të cilat në formë alternative duke e përdorur artin dhe kulturën ndërtojnë ura të reja komunikimi në mes të veriut dhe jugut.

Gjatë vitit 2016 janë realizuar:

- Mbi 200 ngjarje/aktivitete u organizuan në **Qendrën e Energjisë Qytetare (CEC)**. Qendrën CEC përmes aktiviteteve të ndryshme të organizuara nga KFOS, Aktiv dhe OJQ tjera u përfshinë 4 897 persona.
- 15 emisione debatuese **“Sporazum”** me nga 2-3 mysafir në studio të cilat trajtuan tema që lidhen me dialogun e Brukselit dhe ato të cilat ndikojnë në demokratizim të shoqërisë dhe pluralizëm të mendimit. U transmetua si premier gjithësejtë 913,45 minuta program në televizionet e TV Rrjetit dhe B92 INFO,
- 12 debate të **Klubit Social të Mitrovicës**, ku në atmosferë joformale u trajtuan tema që brengosin qytetarin në veri, prej temave politike e deri te temat kulturore dhe shoqërore të cilat deri vonë mungonin në veri,
- 7 takime përgatitëse të partnerëve të platformës avokuese **Empirika** dhe 7 tryeza diskutimi mbi çështjet më të rëndësishme për komunitetin serb në veri që lidhen me marrëveshjen e Brukselit.
- 20 tryeza diskutimi në kuadër të **17 projekteve të përkrahura të OShC-ve dhe mediave** për avokim,
- 1 konferencë rajonale dhe 3 punëtori të thellimit të njohurive mbi BEn me pjesëmarrje të mbi 100 personave dhe 20 ligjërues, ekspert në fushë të integritimit evropian në kuadër të **shkollës për integritim evropian**,
- 1 812 minuata TV program u transmetua në TV Rrjetit bazuar në emisionet e realizuara për të amplifikuar **fushatat avokuese të OShC-ve**. Programi i transmetuar ishte në formë të lajmeve, storieve të shkurta, filmave dokumentarë dhe debateve.

1. **Përkrahja për projektet hulumtuese dhe avokuese të OShC-ve dhe monitorimi i zbatimit të marrëvesjes së Brukselit,**

Edhe në 2017 fondacioni punoi ngusht me OShC të veriut ndërsa partnerin kryesorë në këtë anë të Mitrovicës ishte NGO Aktiv. Themelimi i CEC në 2015 mundësoi fondacionin por edhe donatorë dhe OJQ të tjerë të zbatojnë më lehtë dhe në kushte shumë të përshtatshme iniciativë të ndryshme. Qendra e Energjisë Qytetare edhe këtë vit dëshmoi të jetë një intervenim i qelluan nga ana e fondacionit duke krijuar kështu një vend energjie ku gjatë tërë vitit qarkulluan shume organizata, individ, institucione dhe u zhvilluan aktivitete të ndryshme duke filluar

nga prezantimet e projekteve dhe mundsësive të ndryshme për komunitetin që jeton në anën veriore, tryezat diskutimi, performanca artistike e deri te realizimi i emisionit “Sporazum” i cili tash më ka fituar reputacion ndër komunitetin serb dhe është i shikuar edhe përmes platformave me bazë interneti edhe nga komunitetet tjera ndërsa përmes sistemit kabllovik shihet edhe në shtete te rajonit.

Programet të cilat i zbaton Fondacioni në partneritet me OJQ Aktiv në **Qendrën e Energjisë Qytetare** e të cilat për synim parësorë kanë mobilizimin dhe aktivizimin e qytetarit e më pas edhe avokimin e përbashkët për zgjidhje të çështjeve të identifikuara si të rëndësishme për qytetarët, të studiuara dhe argumentuara mirë janë:

Klubi Social i Mitrovicës (Mitrovica Social Club) – është vend për takime dhe diskutime në ambient jo formal (në caffee shop) i cili për grup synimi ka të rinjt, por jo vetëm. Ky klub që gjendet në përdhesen e CEC, dhe është shndërruar në vend takim qytetarësh konstruktiv – i cili mund të shihet edhe si Rick’s Caffè i Casablancës – vendtakim unik për të gjitha aktivitetet civile në qytet dhe më gjërë dhe vend për diskutim të temave të ndryshme që brengosin qytetarët në veçanti të rinjt e veriut të Mitrovicës. Temat që diskutohen janë prej më të ndryshmeve por me rëndësi për komunitetin që jeton në Mitrovicë dhe më gjërë në veri. Format i kësaj platforme diskutimi zakonisht ka dy deri në tre panel diskutues të cilët vijnë nga institucionet vendim-marrëse apo analist/ekspert të fushës, një moderator dhe publiku i cili në atmosferë shumë jo formale duke pirë kafe apo çaj bisedojnë, bëjnë pyetje apo diskutijnë mbi temën paraprakisht të përcaktuar nga Bordi këshillëdhënës i CEC. Gjatë viti 2016 u mbajtën 12 diskutime të këtij lloji, disa nga temat e trajtuara janë si në vijim: (1) NGO sektori në veri: mundësi dhe qëllim i humbur!, (2) Çka nlnkupton Kosova për njerëzit nga Vojvodina, Kosova dhe Beogradi, (3) Gazetaria si opozitë e përjetshme, (4) Kush ka nevojë për viza? (5) Trashëgimia kulturore në Kosovë, (6) Integrimi evropian, Beogradi dhe Prishtina, shenjat në rrugë, (7) Aktivizmi kundër ekstremizmit dhe autokracisë, etj. Të gjitha debatet e Klubit janë gjiruar dhe janë të vendosura në kanalën e Mitrovica Social Club. Ndër mysafirët më të njohur në këto debate ishin: Dimitris A. Moschopoulos, Dustin DeGrande, Natasa Dragojlovic, Besa Shahini, Adrijana Hodžić, Budimir Ničić, Shpetim Gashi, etj.

Platforma Avokuese “Empirica” – është platformë e cila përkrahë iniciativa avokuese në veri të Kosovës dhe komunitetit serb në Kosovë. Kjo nismë e filluar në 2015 gjatë vitit 2016 u formësua duke përfshirë OJQ dhe media tjera të veriut në koalicion i cili ka potencial të mirë të jetë platformë e fuqishme avokuese serbe. Gjatë vitit 2016 u puna shumë në mobilizim të OShC-ve tjera, hartim të një strategjie të veprimit të kësaj platforme dhe vendosjen e një brendi të ri për veri të Kosovës. Kjo platformë arriti që gjatë vitit 2016 të orgnizoj 7 tryeza diskutimi mbi temat paraprakisht të studiuara përmes platformës Point One. Temat e trajtuara ishin: (1) Kualiteti i përkthimeve të ligjeve të Kosovës në gjuhën serbe, (2) Qëndrimet e serbëve të Kosovës mbi sigurinë pas nënshkrimit të marrëveshjes së Brukselit, (3) Të rinjtë duhet pyetur për qëndrimet dhe nevojat e tyre, (4) Analiza e trendeve socio-politike ndër serbët e Kosovës, (5) Ftesë për transparencë më të madhe të dialogut të Brukselit, etj. Tema e fundit u trajtua disa herë në tryeza formale dhe jo formale dhe arriti të jetë e përcjellur nga shumë media si në Kosovë ashtu edhe nga mediat rajonale. Platforma një herë për një herë përbëhet nga 4 OJQ dhe një medie:

NGO Aktiv, Sinergija, Qendra Humane, Qendra për Kulturë Demokratike dhe Avokim dhe Kontakt Plus Radio.

Strategjia e hartuar nga partnerët e Empirika parashehë së shpejti edhe bashkëpunim me OJQ shqipëtare nga prishtina dhe vendet tjera bazuar në temat e trajtuara.

“Pont one” (Pika një) – është një aktivitet tjetër të cilin e zbaton OJQ Aktiv në kuadër të CEC me përkrahje të Fondacionit i cili zhvilloi metodologji dhe përmes përdorimit të sofverve si SPSS, Nvivo dhe të platforma tjera të bazuara në GIS siguron analiza kuantitative dhe kualitative në tema/fusha me relevancë për komunitetin serb në Kosovë. Studimet e punuara në këtë platformë shërbejnë për të ushqyer platformën avokuese Empirika dhe emisionin “Sporazum”.

TV Debat “Marrëveshja” (Sporazum) – është TV emision debatues i cili realizohet në partneritet në mes të Fondacionit, OJQ Aktiv dhe TV Rrjetit (Mreža). Qëllimi kryesorë i këtij emisioni është që përmes diskutimit televiziv të ngriten çështjet me relevancë për qytetarët e Kosovës, në rend të parë të komunitetit serb lidhur me zbatimin e marrëveshjes së Kosovës dhe Serbisë por edhe temave tjera të ndërlidhura dhe përmes përdorimit të rrjeteve sociale dhe mysafirëve në studio të përfshihen edhe qytetarët me pyetjet dhe komentet e tyre në lidhje me temën e trajtuar. Një theks i veçant i jepet përdorimit të rrjeteve sociale për të atraktuar një numër sa më të madh të qytetarëve, në rend të parë të rinjëve të cilët edhe janë përdoruesit më masiv të rrjeteve sociale. Ky emision transmetohet në pesë televizionet lokale serbe të mbledhura nën TV Rrjetin dhe TV Kim dhe B92 INFO, ndërsa në formatin audio transmetohet në të gjitha radiot e mbledhura në rrjetin e radiove serbe KOSMA. Në këtë mënyrë sigurohet depërtimi deri te një numër signifikant i shikuesve, ndëgjuesve dhe përdoruesve të rrjeteve sociale me qëllim të informimit më të mirë, hapjes së një hapsire diskutimi dhe përsëri ofrimi i mundësisë për të ndëgjuar zërat ndryshe. Më shumë në lidhje me këtë emision nën objektivin 3.

Fondacioni edhe gjatë vitit 2016 punoi edhe me OShC tjera të veriut dhe Kosovës qendrore dhe mbështeti iniciativa hulumtuese me qëllim avokimi. Çiftëzimi i OShC-ve me mediat u pa si një nga iniciativat më të qëlluara kohëve të fundit të cilat mundësuan që zëri i organizatave të ndëgjohet përtej anëtarëve të OJQ-ve, partnerëve të tyre, rrethëve të ngushta të interesit dhe të dalin publikisht me të gjeturat e tyre. Ky vit ishte vit i ekspansionit të fushatave avokuese dhe aktiviteteve të OJQ-ve dhe mediave në fusha të ndryshme të cilat lidheshin drejtë për drejtë apo tërthorazi me marrëveshjen e Brukselit.

Të gjitha projektet e përkrahura në vitin 2015 vazhduan me fushata avokuese edhe në 2016 përmes përkrahjes mediale të partnerëve të tyre edhe pse shumica e projekteve kishin përfunduar me zbatim. Hulumtimet dhe rezultatet e dala zgjuan edhe interesim të madh në mediat rajonale, si Tanjug, DW, B92, e portale të tjera.

Duhet përmenduar se interesim të madh zgjuan hulumtimet mbi **sigurinë e komunitetit Serb në Kosovë pas nënshkrimit të marrëveshjes së Brukselit** të zbatuar nga Human Centar e Mitrovicës veriore i cili u citua shumë herë në shumë media, ndërsa zgjoi edhe interesim të madh edhe te komuniteti ndërkombëtarë dhe disa nga pikat nga ky hulumtim përfunduan edhe në raportin e progresit për Kosovë të Komisionit Evropian. Po e njejtja organizatë në bashkëpunim me një organizatë të komunitetit Shqipëtarë në veri të Mitrovicës vazhduan të

trajtojnë të njejtën çështje të sigurisë por tani duke e hulumtuar perceptimin e **sigurisë së shqipëtarëve në veri të Kosovës**. Ky studim është në përfundim e sipër dhe pritet të dilet me rezultatet në tre muajt e parë të vitit 2017.

Trajtimi dhe jeta e pakicave në komunat me shumicë të komunitetit tjetër është subjekt i projekti “Jeta në mënyrë të pakicave” që vlenë të përmendet. Është ky një projekt i zbatuar nga një organizatë e re por me të punësuar me eksperiencë mediale OJQ Omonia e cila gjithashtu ka një web portal i cili do të bëjë diseminimin e rezultateve të projektit. Projekti ka për qëllim të hulumtoj jetën dhe sfidat me të cilat përballlet komuniteti shqipëtarë në veri dhe ai serb i cili jeton në Prishtinë dhe Pejë. Në kuadër të këtijë projekti që zgjatë 5 muaj do të realizohen 3 TV dhe radio reportazhe në kohëzgjatje prej 25 minutash dhe 10 artikuj/stori mbi jetën e pakicave në komunat me shumicë të komunitetit tjetër. Në këtë mënyrë do të dokumentohet dhe krahasohet tjrajtimi i njërës dhe palës tjetër në situata të njejta apo të ngjashme.

Është hera e parë që organizatat serbe trajtojnë tema të cilat për grup synimi kanë komunitetin shqipëtarë dhe kjo dëshmon se dal ngadalë po krijohen lidhje, edhe pse ende të brishta, në mes të këtyre dy komuniteteve.

Një iniciativë tjetër bashkëpunimi u fillua në fund të vitit 2016 e cila për grup synimi ka të rinj të komunitetve shqipëtarë dhe serb të veriut. Kjo iniciativë u nis si bashkëpunim në mes të Termokiss, një initiative avangarde të të rinjve nga Prishtina, dhe Aktiv Art Club i cili mbledh të rinj serb në Mitrovicë. Janë realiuar 2 takime, një në Mitrovicën veriore dhe një në Prishtinë. Këto dy takime kishin për qëllim që këto dy grupe të njoftohen më mirë, të shkëmbejnë në mes veri interesimet dhe synimet e veta në mënyrë që më pas të kenë bashkëpunimin me të lehtë. Në vazhdim do të organizohet një punëtori e përbashkët e këtyre dy grupeve dhe me pjesëmarrje të grupeve të ngjashme të regjionit ashtu që kjo nismë të ketë karakter rajonal dhe të mos shihet si edhe një projekt i “bashkim-vllazërimit”, të cilat janë përkrahur nga donatorët tjerë dhe prej të cilave ka mbetë shumë pak pas përfundimit.

Si përfundim mund të thuhet se skena e shoqërisë civile në vitin 2016 u pasuru me iniciativa inovative, organizata dhe individ të ri në skenën e shoqërisë civile por mbesin edhe shumë sfida përpara deri te një gjendje relativisht e relaksuar.

Lista e granteve/shpenzimeve:

Projekti/iniciativa	Grant marrësi	Shuma
Veriu dhe jugu: bashkëpunim për zgjidhje të problemeve të njejta	TV Herc	8 900,00 €
Qytetarët e veriut publikisht mbi marrëveshjen e Brukselit	Qendra për zhvillim të komuniteteve	11 700,00 €
Trashëgimia kulturore serbe në Kosovë – problemet dhe perspektiva	NGO Media Pulse	8 980,00 €
Marrëveshja e Brukselit: Qendrimi shprehet	Radio Kontakt Plus	9 660,00 €
Të drejtat e grave dhe marrëveshja e Brukselit	E drejta e grave	6 710,00 €
Situata e sigurisë në rajon – të rinjtë dhe radikalizmi politikë	Nëna Terezë	9 634,75 €
Qendrimet e shqipëtarëve të veriut mbi sigurin pas nënshkrimit të marrëveshjes së Brukselit	Qendra Humane	10 460,00 €
Rritja e praktikave demokratike dhe përfshirja e qytetarëve në proceset vendimmarrëse	NGO Aktiv	61 475,00 €
Arti dhe kultura si mjet për ndryshim shoqëror	Operacionale (5 140 € OJQ Rritu)	20 104,00 €
Konsulencë mediale për emisionin Sporazum dhe projektet tjera avokuese me bazë mediale	-	6 000,00 €
Jeta në mënyrë të pakicave	Omonia	4 500,00 €

2. Njoftimi me principet bazë të BEs për media, OSHC dhe zyrtarë komunal – Shkolla për integrim evropian

Gjatë viti 2016 fondacioni vazhdoi bashkëpunimin në zbatim të Shkollës për integritime evropiane me Lëvizjen Evropiane të Serbisë si organizatë me ekspertizë dhe mundësi për të siguruar ligjerues më kualitativ dhe OJQ Aktiv në veri si partner lokal. Është ky viti i tretë që Shkolla për integritime evropiane zbatohet në veri. Programi i Shkollës këtë vit pësoi pak ndryshim si rezultat i nevojës në terren. Këtë vit përpos nivelit bazik Shkolla u pasurua me 3 punëtorë të thellimit të njohurive mbi BEn të realizuara nga dy partnerët dhe vet fondacioni.

Programi i vitit 2016 u fillua me konference rajonale e cila iu dedikua një auditori më të gjerë se vetëm vijuesve të perzgjedhur për nivelin bazik të Shkollës. Pjesëmarrës në **punëtorinë rajonale**: Bazat për fillim: Ballkani Perëndimor dhe BE u mbajt me 31 maj, 2016 në CEC ishin mbi 60 vijues dhe përfaqësues të OSHC-ve, mediave, etj. Panelistë ishin zyrtarë të lartë të qeverisë dhe institucioneve të Kosovës dhe Serbisë si dhe ekspertëve nga organizatat e shoqërisë civile. Panelistë përpos tjerësh ishte edhe Ramadan Ilazi, zv. Ministër i atëherëshëm i MIE, Ksenija

Milenkoviç, UD e drejtoreshë e zyrës për integritime evropiane të Serbisë, Venera Hajrullahu, drejtoreshë e KCSF, Simonida Kacarska, Instituti i politikave evropiane nga Maqedonia, etj.

Numri fillestarë i vijuesve të **nivelit bazik të Shkollës** në vitin 2016 ishin 42, ndërsa ligjeratat deri në fund i përcjellën 36 vijues të cilët fituan diplomat mbi vijushmërinë. Në kuadër të nivelit bazikë u mbajtën 30 ligjërata dhe punëtori nga ekspertë eminent nga Serbia dhe rajoni. Numri total i vijuesve të Shkollës prej vitit 2014 e deri 2016 tani ka arritur në 129 që është një masë mjaft e madhe e personave të cilët fituan njohuri bazike të BEs, instrumenteve dhe politikave të saj.

Në vizitën **studimore në Beograd** e cila u mbajt prej 15-16 shtator, 2016 morrën pjesë 23 vijues, ndërsa në atë në Prishtinë 29. Deri sa gjatë vizitës studijuese në Beograd vijuesit patën mundësi të vizitojnë disa nga iniciativat civile për integrim evropian dhe të bisedojnë me ekspertë dhe vizituan institucionet dhe zyrtarë të lartë qeveritarë vizita në Prishinë u organizua me rastin e mbajtjes së Forumit 2015 me titull: Ecje nëpër akull, e mbajtur me 7 nëntor, 2016 gjatë se cilës pjesëmarrësit patën mundësi të ndëgjojnë perspektivën kosovare mbi disa çështje të cilat lidhen ngusht me procesin e integritimit EU si dialogu Kosovë-Serbi, reforma e sundimit të ligjit në procesin e EU integritimit.

U mbajtën tri punëtori të thellimit të njohurive mbi BEn. Një prej tyre ishte e organizaur në formë të vizitës studijuese dy ditore ndërsa dy të tjerat ishin punëtori tematike.

Vizita studimore Knjazhevcit u realizua prej 22-23 korrik, 2016. Tema e vizitës ishte **zhvillimi ekonomik lokal** sipas vlerësimit të nevojës të vijuesve nga vitet e kaluara të Shkollës. Gjatë vizitës 15 pjesëmarrësit e kësaj vizite morën informata nga dora e parë mbi praktikatat e mira nga Agjencioni për zhvillim lokal, Qendra rajonale për trajnim profesional, Agjencioni për zhvillim të Knjazhevcit dhe Qendra për fuqizim ekonomik të të rinjëve.

Punëtorja e dytë e thellimit të njohurive mbi BEn e cila u realizua nga Lëvizja Evropiane e Serbisë dhe NGO Aktiv për temë pati **Monitorimin e marrëveshjes së Brukselit**. Kjo punëtori u mbajt me 25 nëntor, 2016 me 17 pjesëmarrës. Punëtorin e udhëheqi Dushan Janjiq i Forumit për Marrdhënie Etnike. Kjo punëtori ishte e dedikuar për OShC-t të cilat bëjnë monitorimin e zbatimit të marrëveshjes e Brukselit, të përkrahura nga KFOS dhe organizata të tjera.

Punëtorinë me titull **Mediat dhe BE** u organizua nga fondacioni dhe u mbajt prej 3-6 qershor, 2016 nëp Durrës në Shqipëri. Punëtorinë e disajnuan dhe mjetën dy gazetarë dhe korrespondent nga Brukseli, Augustin Palokaj dhe Dejan Anastasijevic. Në punëtori morrën pjesë 30 pjesëmarrës të të gjitha mediave minoritare në Kosovë, përfshi ketu edhe mediat Rome dhe Malaziasë të RTKs.

Në Nëntor Augustin Palokaj mbajti edhe një takim me përfaqësues të mediave si takim "Follow up" të punëtorisë së mbajtur në qershorë për të përditësuar gazetarët në lidhje me ngjarjet në ndërkohe. Augustin Palokaj gjithashtu mbajti edhe një ligjëratë të hapur në CEC në Mitrovicën veriore e cila ishte e vizituar nga me shume se 40 persona nga sferat endryshme shoqërore.

Cikli i vitit 2016 u përfundua me ceremoninë e ndarjes së diplomave për vijuesit e programit të Shkollës për integrim evropian.

Lista e granteve/shpenzimeve:

Projekti/iniciativa	Grant marrësi	Shuma
Shkolla për integrim evropian – niveli bazik dhe dy punëtori për thellim të njohurive mbi BE	Lëvizja Evropiane në Serbi	27 020,00 €
Shkolla për integrim evropian – niveli bazik dhe dy punëtori për thellim të njohurive mbi BE	NGO Aktiv	10 985,00 €
Seminari rajonal “Bazat për fillim: Ballkani perëndimorë dhe BE”, 31 maj, 2016, Mitrovica veriore	Operacionale	851,77 €
Seminarë i thellimit të njohurive mbi BE: Mediat dhe BE, 3-6 qershor, 2016, Durrës	Operacionale	8 463,66 €
Thellim i njohurive mbi BE: Zhvillimi lokal, vizitë studimore Knjazhevcit,	Operacionale	595,29 €
Ligjeratë e hapur Mediat dhe BE	-	620,42 €
Follow up e seminarit Mediat dhe BE, Graçanicë, 8 nëntor, 2016	Operacionale	1 129,36 €
Vizitë studimore Prishtinës	Operacionale	704,00 €
Ceremonia e ndarjes së diplomave	Operacionale	577,02 €

3. Trendet dhe nivelet e Integritit Serb

Viti 2016 u karakterizua me bashkëpunim të shquar me mediat të cilat siguruan dukshmëri më të madhe të punës së OJQ-ve, siguruan dialog dhe diskutim të hapur në etër në mes të përfaqësuesve politik, aktivistëve të OShC-ve, analistëve dhe intelektualëve serb dhe shqipëtarë. Në këtë sferë më intensivët ishin dy iniciativa të menduara dhe disajnuara nga fondacioni dhe të realizuara nga partnerët e saj NGO Aktiv dhe TV Mreza të ndihmuar nga konsulenti për media. Dy iniciativat me të mëdha dhe më të dukshme ishin: (1) TV debati “Sporazum”, tash veç i njohur për publikun dhe (2) Përkrahja mediale projekteve avokuese të OShC-ve dhe Shkollës për integrim evropian dhe platformës avokuese Empirika.

TV Debati “Sporazum” realizoi gjatë tërë vitit 15 emisione në të cilën gjithsejtë morrën pjesë 37 mysafirë në studio nga të gjitha sferat e shoqërisë si përfaqësues politikë, lider partishë politike, politikë bërës, analistë. Temat e trajtuara ishin të natyrës aktuale politike dhe në të shumtën e rasteve lidheshin me marrëveshjen e Brukselit e shpesh herë kishin për temë edhe (jo) transparencën e vet marrëveshjes. Qëllimi kryesorë i emisionit ishte demistifikimi i marrëveshjes së Brukselit, domethënia e saj për qytetarët e rendomtë, hapja e debatit publik mbi çështjet dhe mendimet shpeshë herë të kundërmyera njëra tjetrës nga shqipëtarët dhe serbët e Kosovës dhe ofrimin të hapsirës për shprehje të lirë dhe pa cenzurë. Ky emision realizohet dhe transmetohet tashmë dy vite dhe ka fituar besimin e një numri signifikant të shikuesve në Kosovë dhe rajon. Emisioni transmetohet në 6 televizione në Kosovë, 5 anëtarët e TV Rrjetiti, rrjetit i televizioneve serbe dhe TV Mitorvica dhe në B92 INFO përmes së cilës sigurohet

shikueshmëria edhe në Serbi, Maqedoni, Bosne e Hercegovine, Mal të Zi. Për të promovuar emisionin sa më shumë dhe për të arritur edhe te shikuesit e moshës më të re të cilët më shumë e përdorin internetin dhe mediat sociale, emisioni ka edhe faqet dhe kanalet e veta në Facebook, Twitter, Youtube dhe Vimeo. Të gjitha emisionet janë bazuar në hulumtime të shpejta të punuara përmes Point One platformës që zbatohet nga NGO Aktiv ndërsa publiku është pjesë aktive e secilit emision duke bërë pyetje dhe dhënë mendim mbi diskutimin në studio. Disa nga temat e trajtuara në vitin 2016 janë: (1) Situata e sigurisë në Kosovë pas nënshkrimit të marrëveshjes së Brukselit, (2) Zhvillimi dhe potenciali ekonomik i Kosovës, (3) Arsimi, njohja e diplomave pas marrëveshjes së Brukselit, (4) jo(vizibiliteti i mediave, (5) E drejta e përdorimit të gjuhës, (6) Kriza politike në Prishtinë, (7) Liria e lëvizjes, (8) Vendimi igjykatës kushtetuese mbi ligjshmërinë e Asociacionit të komunave me shumicë Serbe, (9) Liberalizimi i vizave, (10) E ardhmja e Trepçës, (11) Transparenca e dialogut të Brukselit, (12) Politikat e jashtme karshi dialogut të Brukselit dhe marrëdhëniet shqiptaro-serbe.

Sipas të dhënave nga web faqet e TV Rrjetit, faqeve të mediave sociale, CEC shikueshmëria e emisionit është relativisht e lartë së paku 1200 shikues për emision.

Përkrahja mediale për projektet avokuese të OShC-ve dhe promovimi i Shkollës për integrim evropian dhe platformës avokuese Empirika është një projekt tjetër i cili gjatë vitit 2016 ndikoi që zëri i OShC-ve të ndëgjohet më fuqishëm nga vendimmarrësit, organizatat ndrkombëtare dhe qytetarët dhe njëkohësisht promovoi edhe punën e fondacionit. Në kuadër të projektit të zhvilluar në bashkëpunim me TV Rrjetin u realizuan: 78 lajme në web faqe të TV Rrjetit dhe anëtarëve të saj, 35 emisione të karakterit dokumentarë, 6 debate televizive, 14 intervista me udhëheqës të OShC-ve të cilat realizuan hulumtime dhe 14 storie të shkurta për lajme në televizionet e TV Rrjetit. Gjithsejtë u prodhuan 1 812 minuta program i cili pari edhe nga disa repriza, kështu që kjo minutazhë e prezencës në media është edhe shumë më e madhe. E tërë përmbajta e këtyre emisioneve mund të gjindet në web faqen e TV Rrjetit. Ky projekt arriti që OShC-t të fitojnë në reputacion, të krijohet hapsirë për diskutim të hapur dhe shprehje të lirë dhe të fitohet kurajo për angazhim edhe në fushat e “rënda” politike.

Një iniciativë e re u fillua me portalin shumë të vizituar nga veriu KoSSev i cili është një nga portalet më të vizituara të serbëve të Kosovës dhe i cili menaxhohet në kuadër të OJQ Qendra për zhvillim të komunitetëve. Kjo iniciativë do të krijoj hapsirë për dialog në mes të intelektualëve serb dhe shqipëtar përmes kollumnave dhe organizimit të diskutimeve të qytetarëve në lidhje me marrëveshjen e Brukselit dhe temat e lidhura me të e me synim të krijimit të hapsirës për shprehje të qëndrimeve të njërës dhe anës tjetër në mënyrë që të arrihet së paku një normalizim i marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë në mes të qytetarëve dhe intelektualëve të shqipëtarëve dhe serbëve. Gjithashtu projekti do të përbëhet edhe nga 16 vox populli, forum për diskutim në mes të qytetarëve dhe nxjerrje të pikave kryesore dhe interpretim i emisionit “Sporazum”.

Një e arritur poashtu është anëtarësimi i disa mediave serbe në Këshillim e Mediave të Shkruara të Kosovës, gjë që tregon gatishmerinë e rilidhjes me mediat shqiptare dhe përfshirjen në organizatat kosovare.

Gjatë vitit u përkrahën edhe disa iniciativa kulturore si festivali i letërsisë bashkëkohore “Polip” ndërsa veriut iu mundësua edhe pjesëmarrja në programet artistike të zbatuara nga Stacioni në Prishtinë.

Lista e granteve/shpenzimeve:

Projekti/iniciativa	Grant marrësi	Shuma
Përkrahje mediale projekteve të avokimit të OShC-ve	TV Mreza	18 000,00 €
Konsulencë për projektet mediale	-	10 170,00 €
Realizimi teknik dhe transmetimi i TV emisionit “Marrëveshja” dhe mësimi duke punuar	TV Mreza	26 640,00 €
Realizimi i animacioneve dhe spoteve promovuese për emisionin Sporazum	Butterfly	500,00 €
Vendosja dhe menaxhimi i faqes së veçantë (podcast) në web faqen e TV Mreza për emisionin Sporazum	TV Mreza	1 300,00 €
Standardet e gazetarisë në mediat minoritare	Këshilli i mediave të shkruara	4 000,00 €
Kultura dhe pajtimi – përkthim dhe botim i romanit të Veton Surroit “Definicioni i dashurisë së Marie Gjoni”	Samizdat	3 500,00 €
Festivali ndërkombëtarë i letërsisë “Polip”	Qendra Multimedia	300,00 €
Intelektualët në dialog, qytetarët në dëbat mbi marrëveshjen e Brukselit dhe temat të lidhura me atë	Qendra për Zhvillim të Komuniteteve	18 104,00 €
Bashkëpunimi në mes të Mitrovicës veriore dhe pjesëve tjera të Kosovës përmes moduleve/programeve të artit bashkëkohorë	Stacioni	6 490,00 €



FONDI REZERVË

Më mëso mua/SchoolMe

Përshkrimi i shkurtër i projektit

Rezultatet e hulumtimeve do të pasqyrojnë përparësitë e zbatimit të projektit në shkollat pilot, si dhe ndërhyrjet që duhet të realizohen me qëllim të rritjes së efikasitetit të zbatimit të tij në shkollat e tjera.

Në dokumentet strategjike të arsimit në Kosovë, si në Kornizën e re të Kurrikulës së Kosovës, Planin Strategjik të Arsimit, etj, në mënyrë të theksuar potencohet nevoja për zhvillimin dhe shfrytëzimin e burimeve online, si një mundësi për shfrytëzimin e burimeve alternative të përmbajtjeve mësimore, të cilat ndihmojnë në zhvillimin e kompetencave të nxënësve dhe rritjen e cilësisë në arsim. Një qasje e tillë promovohet në veçanti nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT), e cila mbështetë zbatimin e projekteve të cilat mundësojnë zhvillimin dhe shfrytëzimin e platformave digjitale në procesin mësimor. Zhvillimi dhe shfrytëzimi i këtyre platformave mundëson zbatimin më të shpejtë të Kornizës së re të Kurrikulës së Kosovës, sidomos kur dihet se mungojnë tekstet mësimore të cilat mundësojnë zhvillimin e kompetencave të nxënësve të parapara me këtë kornizë.

Pikërisht për të mundësuar zbatimin e Kurrikulës së re të Kosovës në arsimin parauniversitar përmes shfrytëzimit të burimeve online të përmbajtjeve mësimore, Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) në mars të vitit 2016 ka filluar pilotimin e projektit dy vjeçar "SchoolMe" apo "Më mëso mua". Pilotimi i këtij projekti u mundësua nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) dhe ka për qëllim aftësimin e mësimitdhënësve dhe nxënësve për shfrytëzimin e përmbajtjeve mësimore të platformës digjitale "SchoolMe" apo "Më mëso mua" në procesin mësimor. Kjo platformë ka përmbajtje mësimore, të cilat janë në përputhje me kërkesat e kurrikulave bërthamë të fushave lëndore të klasave 1-9 të nivelit të shkollës fillore dhe të mesme të ultë. Gjithashtu kjo platformë ka përmbajtje mësimore me cilësi të lartë të cilat sqarohen në kuadër të lëndëve të ndryshme mësimore, si realizimi i eksperimenteve në laboratorët virtualë të dukurive të ndryshme nga Fizika dhe Kimia, pamjet e gjallesave në lëndën e Biologjisë, prezantimi i hartave në Histori dhe i vendeve të ndryshme që janë pjesë e përmbajtjeve që duhet përvetësuar në lëndën e Gjeografisë, etj. Të gjitha këto materiale mund të shfrytëzohen nga mësimitdhënësit e shkollave ku pilotohet projekti, si dhe nga nxënësit e tyre.

Projekti "Më mëso mua" zbatohet për herë të parë në 14 komuna të Kosovës. Në komunën e Prishtinës dhe të Gjakovës janë nga 2 shkolla përfituese, ndërsa nga 1 shkollë përfituese është në Pejë, Istog, Malishevë, Rahovec, Drenas, F. Kosovë, Suharekë, Shtime, Podujevë, Hani i Elezit, Lipjan dhe Vushtrri.

Për të pasur një pasqyrë objektive lidhur me efektet që ka bërë zbatimi i këtij projekti në shkolla, KEC gjatë vitit 2017 dhe 2018 do të realizojë disa hulumtime.

Të arriturat kryesore

Në fillim projekti ishte paraparë të realizohet në 15 shkolla në mbarë Kosovën. Me insistimin e koordinitorit të projektit, si dhe realizimin e kursimeve gjatë kryerjes së aktiviteteve të ndryshme u mundësua që të shtohet dhe një shkollë pjesëmarrëse në projekt. Kështu pilotimi i projektit "Më mëso mua" filloi të realizohet në 16 shkolla të Kosovës.

Projekti "Më mëso mua" filloi të implementohej për herë të parë në Kosovë, prandaj zbatimi me sukses i tij kërkonte angazhimin e KEC-it për të siguruar gjithë logjistikën për shfrytëzimin e rrjetit, si dhe aftësimin e mësimitdhënësve për shfrytëzimin e tij në procesin mësimor. Nga aspekti logjistik kërkohet nga KEC të mundësonte instalimin e rrjetit të internetit dhe shpërndarjen e tij nëpër klasa në shkollat që nuk ekzistonte ose për ta funksionalizuar atë në shkollat ku kishte rrjet të instaluar të internetit, të siguronte dhe të instalonte SMART televizorët, të mundësonte regjistrimin e mësimitdhënësve dhe nxënësve për shfrytëzimin e platformës digjitale, si dhe parapagimin e tyre për shfrytëzimin e saj. Po ashtu, KEC duhet të aftësonte mësimitdhënësit se si të shfrytëzonin platformën "Më mëso mua" në procesin mësimor.

Gjatë vitit 2016 u realizuan shumë aktivitete të cilat sollën arritjen e këtyre rezultateve:

1. Instalimi i rrjetit të internetit në 8 shkolla pjesëmarrëse dhe funksionalizimi i rrjetit në shkollat e tjera

KEC ka publikuar një thirrje për organizatat e interesuara për të bërë analizimin e situatës dhe caktimin e kostos për instalimin dhe shpërndarjen e rrjetit të internetit në shkollat e përfshira në projekt. Firma fituese ka bërë analizën e situatës në shkolla, ka bërë instalimin dhe shpërndarjen e rrjetit të internetit në klasa në 8 shkolla pjesëmarrëse, si dhe ka bërë funksionalizimin e rrjeteve ekzistuese në 4 shkolla të tjera. Në këtë mënyrë është siguruar shpërndarja e internetit në 810 klasa në shkollat përfituese të projektit.

2. Blerja e 144 SMART TV dhe instalimi i tyre në 16 shkolla

KEC ka publikuar një thirrje për kompanitë e interesuara për të ofertuar lidhur me blerjen e 144 SMART TV dhe instalimin e tyre në shkollat përfituese. Kompania fituese ka siguruar SMART TV sipas kushteve të parapara në ofertë dhe ka bërë instalimin e 810 SMART TV në 15 shkollat përfituese varësisht nga mundësia e shpërndarjes së rrjetit të internetit në shkollë, si dhe të 5 smart TV në shkollën e 16, e cila është shkollë e shtuar në projekt.

3. Bashkëpunimi me DKA për të siguruar parapagimin e internetit për shkollat përfituese

KEC ka arritur që të nënshkruajë marrëveshje mirëkuptimi me 12 nga 14 komunitat e Kosovës dhe në këtë mënyrë të sigurojë që këto komuna të bëjnë financimin e shfrytëzimit të internetit për periudhën 2 vjecare prej 3040 Mbs për 14 shkollat përfituese. Kjo ka bërë që KEC të kujdeset për financimin e shfrytëzimit të internetit vetëm për 2 shkolla, si për shkollën "Emin Duraku" në Shtime dhe shkollën "Ali Gashi" në Drenas. Kjo ka bërë që komunitat ta shohin me interes dhe të ndihmojnë në zbatimin e këtij projekti në shkollat e tyre. Po ashtu kjo ka bërë që KEC të kursejë shpenzimet dhe të rrisë edhe për 1 numrin e shkollave përfituese.

4. Aftësimi i mësimitdhënësve për shfrytëzimin e platformës digjitale

Në fund të muajit gusht të vitit 2016, KEC ka organizuar trajnime 2-ditore me bazë në shkollë për 30 mësimitdhënës të secilës nga 16 shkollat përfituese. Trajnimet kanë pasur për qëllim aftësimin e mësimitdhënësve të niveleve dhe lëndëve të ndryshme për të shfrytëzuar përmbajtjet e platformës digjitale "Më mëso mua" në procesin mësimor. Gjatë ditës së parë të trajnimit, mësimitdhënësit janë njoftuar me strukturën e platformës digjitale, ndërsa gjatë ditës së dytë ata janë aftësuar se si ta shfrytëzojnë platformën për zhvillimin e kompetencave të nxënësve dhe vlerësimin e njohurive të tyre. Një ekip i mësimitdhënësve të trajnuar kanë organizuar trajnime për kolegët e tyre. Deri në fund të vitit 2016, në kuadër të projektit "Më mëso mua" janë aftësuar 710 mësimitdhënës të 16 shkollave përfituese për të shfrytëzuar këtë platformë në procesin mësimor.

5. Regjistrimi i mësimitdhënësve dhe nxënësve për shfrytëzimin e platformës digjitale

KEC ka bashkëpunuar me kompaninë që menaxhon platformën digjitale "SchoolMe" për të regjistruar 710 mësimitdhënësit e aftësuar të shkollave pjesëmarrëse në këtë platformë. Po ashtu, kjo kompani ka regjistruar edhe 5 716 nxënës të këtyre shkollave për të shfrytëzuar përmbajtjet mësimore të kësaj platforme. Kjo platformë është në dispozicion online 24 orë gjatë 7 ditëve të javëve dhe nxënësit mund ta shfrytëzojnë atë për përfitimin e njohurive dhe zhvillimin e kompetencave të tyre dhe në kushtet e shtëpisë.

6. Monitorimi i mësimitdhënësve gjatë orëve mësimore

Koordinatorja e projektit ka vizituar disa herë të gjitha shkollat pjesëmarrëse dhe ka këshilluar mësimitdhënësit lidhur me mënyrën e shfrytëzimit të platformës digjitale në procesin mësimor. Gjatë vizitave, koordinatorja ka monitoruar dhe zbatimin në klasa të platformës nga 2-3 mësimitdhënës të secilës shkollë. Pas monitorimit, koordinatorja ka dhënë këshilla se si të optimalizohet shfrytëzimi i platformës në zhvillimin e kompetencave të nxënësve gjatë procesit mësimor.

Planet për të ardhmen

Gjatë vitit 2017 duhet të intensifikohet bashkëpunimi me mësimdhënës për të shfrytëzuar në mënyrë sa më efikase platformën digjitale në procesin mësimor. Po ashtu, koordinatori duhet të shtojë numrin e vizitave të shkollave pjesëmarrëse në projekt dhe numrin e orëve të monitoruara në mënyrë që të kuptojë më mirë përparësitë dhe vështirësitë e zbatimit të platformës në lëndë të caktuara. Kjo do të ndihmonte bashkëpunimin profesional të koordinatores me mësimdhënësit për të shpërndarë përvojat e suksesshme, si dhe për të gjetur mundësitë e tejkalimit të vështirësive eventuale. Gjatë vizitave duhet të shihet mundësia e shtimit të numrit të nxënësve të shkollave përfituese që shfrytëzojnë platformën digjitale në procesin mësimor.

Koordinatorja duhet të motivojë disa mësimdhënës të sukseshëm që të regjistrojnë orët e tyre mësimore, të cilat më pas mund të pasurojnë përmbajtjet e platformës "Më mëso mua". Këto orë do të shfrytëzoheshin dhe nga mësimdhënësit e shkollave të tjera.

Në kuadër të projektit është paraparë dhe një vizitë studimore në Moldavi, në vendin ku zbatohet një projekt i ngajshëm për shfrytëzimin e laboratorëve digjital në procesin mësimor. Pas vizitës, koordinatori do të organizojë një takim me drejtorë dhe mësimdhënës të shkollave përfituese në mënyrë që të shpërndajë përvojat e fituara gjatë vizitës studimore.

Meqë projekti pilotohet për herë të parë në Kosovë, atëherë në kuadër të tij janë paraparë të organizohen dhe hulumtime të ndryshme, të cilat do të ndihmojnë implementuesit e projektit dhe MASHT të kuptojnë përparësitë e zbatimit të këtij projekti në shkolla, si dhe intervenimet që duhet të ndërmerren në mënyrë që të optimalizohen rezultatet e zbatimit të tij në shkolla të ndryshme.

Liberalizimi i regjimit të vizave midis Kosovës dhe Bosnje e Hercegovinës

Derisa Kosova ka liri të lëvizjes me të gjitha shtetet e Ballkanit, rasti me Bosnje e Hercegovinën është ndryshe. Përderisa në Serbi qytetarët e Kosovës mund të udhëtojnë vetëm me kartela identiteti, Bosnja e Hercegovina ka aplikuar viza për qytetarët e Kosovës. Të njejtën gjë si masë reciprociteti vendosë ta aplikojë edhe Kosova karshi qytetarëve të Bosnjës e Hercegovinës, dhe me këtë çenohet liria e lëvizjes e shumë qytetarëve që dëshirojnë të udhëtojnë, si në Bosnje ashtu edhe në Kosovë. Gjithashtu, me këtë politikë të vizave, bashkëpunimi ekonomik, kulturor e social thuajse është ndërpritur në tërësi. Gjatë vitit 2016, Fondacioni, nëpërmjet partnerit Doku Kino, është angazhuar që të ndikojë në politikat e lehtësimit të procedurave për marrjen e vizave. Në kuader të kësaj iniciative, janë ndërmarrë këto aktivitete:

Dialogu i palëve të involvuara – Objektivi i këtij projekti ishte bërja bashkë e përfaqësuesve të ndryshëm të organizatave të shoqërisë civile, studiues, gazetarë dhe përfaqësues të sektorit të ekonomisë për të dërguar mesazhe të qarta tek qeveritë e Bosnje-Hercegovinës dhe Kosovës, në mënyrë që të lehtësojnë regjimin e rreptë të vizave midis këtyre vendeve.

Në takimin në Beograd morrën pjese Zëvendësministri për Integritet Evropian, Shef i Njësisë Ekonomike dhe Zhvillimit Social të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal, Presidenti i AmCham i Serbisë, kryetar i Unionit të biznesit të Gruas – BiH, sipërmarrës, Shef i Zyrës për Bashkëpunim Rajonal i Odës Ekonomike të Serbisë, Shef i marketingut i Korporatës Bosnalijek, analistë të shquar të politikave dhe ekonomisë, si dhe gazetarëve nga të dyja vendet.

Takimi në Sarajevë mbledhi përfaqësues të 49 kompanive më të mëdha nga të dyja vendet në nivel Drejtorësh Ekzekutiv, përfaqësues të Odave Ekonomike, Ambasadave dhe organizatave ndërkombëtare.

Fushata PR ka krijuar lidhje të ngushta me kryeredatorët e mediave më relevante në të dyja vendet. Mbulesa mediatike është bërë nga disa televizione, radio stacione, gazeta ditore, shumica e agjensive të lajmeve, nëpërmjet raporteve, transmetim direkt nga ngjarjet, debate televizive dhe intervista. Në të njejtën ditë, të tre televizionet (Aljazeera Balkans, N1 dhe Pink BiH) kishin diskutuar takimin tonë si temë kryesore.

Dialog i palëve të involvuara

Objektivi ishte që pas takimeve në Sarajevë dhe Beograd, të ftohen përfaqësues të zgjedhur të Organizatave të ndryshme të Shoqërisë Civile, institucioneve hulumtuese, mediava dhe Odave Ekonomike në takimin një ditë në malin Jahorina afër Sarajevës. Janë ftuar përfaqësues të këtyre institucioneve nga Kosova, Bosnje e Hercegovina, Serbia, Greqia dhe Rumania. Qëllimi ishte që së bashku edhe me pjesëmarrësit nga Greqia dhe Rumania, si dy shtete që nuk e kanë njohur Kosovën, por nuk e pengojnë lirinë e lëvizjes, për ta përpiluar një deklaratë me rekomandime, e cila u është dërguar të dyja qeverive.

Në ditën e dytë është mbajtur një konferencë për shtyp me ç'rast janë prezentuar rekomandimet, duke ushtruar presion tek strukturat politike të BH. Impakti i këtij organizimi ka sjellur

rezultate konkrete. Ministri i jashtëm i Bosnës Igor Crnadak, një orë pasë konferencës tonë, ka deklaruar se do të fillohet një dialog me qeverinë kosovare për të lehtësuar procedurat e marrjes së vizave.

Ngritja e vetëdijes publike për aspektet negative të regjimit të vizave

Në bashkëpunim me gazetarët e Kosovo 2.0 është bërë prodhimi i një filmi dokumentar i përbërë nga 6 storie të ndryshme me eksperiencë personale rreth barrierave të qytetarëve për të levizur midis KS dhe BH (dhe publikimi/avokimi)

Është bërë trajnimi dhe përkrahja e gazetarëve për prodhimin e raporteve të detajuara rreth aspekteve negative të regjimit të vizave (KS dhe BiH) (dhe publikimi/avokimi).

Zemrat e Huaja – Shfaqje teatrale e regjisorit boshnjak Dino Mustafić

Në kuadër projektit për liberalizimin e vizave midis Kosovës dhe Bosne e Hercegovinës, është prodhuar edhe një shfaqje teatrale nga regjisori i njohur boshnjak Dino Mustaić. Shfaqja është dhënë premierë në Teatrin Kombëtar në shkurt 2016, ndërsa gjatë viti 2015 është shfaqur edhe në Sarajevë dhe Beograd.

Bashkëpunimi turistik mes Kosovës dhe Bosnjës

Mënyra tjetër për të ngritur bashkëpunimin midis qytetarëve të të dyja vendeve ishte edhe përpjekja që Ec Ma Ndryshe ka bërë, duke sjellur bashkë operatorët turistik te vendeve.

Është mbajtur takimi i parë në Kotorr në mes të operatorëve turistik të BH dhe KS, të cilët kanë diskutuar rreth përfitimeve, si ekonomike ashtu edhe shoqërore, që do ti kishim, në rast se do të hiqeshin vizat mes BH dhe KS.

Konferenca e dytë “Rritja e komunikimit shoqëror përmes turizmit dhe kulturës: Bosnja dhe Kosova – Si të tejkalohen pengesat në komunikim?” u mbajt më 23 Nëntor 2016 në Sarajevë. Konferenca i bëri bashkë personalitetet e njohura të turizmit dhe kulturës nga të dy shtetet, ndërsa diskutimet u zhvilluan përgjatë dy paneleve. Në panelin e parë mbi bashkëpunimin turistik, folës nga qeveria e Kosovës, shoqatat e biznesit dhe operatorët turistik nga të dyja vendet treguan për vështirësitë e bashkëpunimit rajonal në fushën e turizmit. Ndërsa në panelin e dytë mbi bashkëpunimin kulturor, ku u paraqitën udhëheqës të festivaleve të kulturës nga Kosova dhe Bosnja u rikonfirmuan pengesat e komunikimit për shkak të politikës së vizave. Pjesëmarrës të konferencës ishin përfaqësues të operatorëve të turizmit, organizatave jo-qeveritare, medias, qeverisë dhe universiteteve nga Bosnja. Konferenca ishte vazhdimësi e takimit dy-ditor të mbajtur në Korrik 2016 në Kotor të Malit të Zi, ku përfaqësues të sektorit të turizmit dhe kulturës nga Kosova, Bosnja dhe Mali i Zi diskutuan për mundësitë e bashkëpunimit rajonal. Konferenca në Sarajevë ishte përpjekja e radhës për të nxitur bashkëpunimin kulturor dhe turistik mes të dy shteteve, duke i nxjerr në pah pasojat e dëmshme të politikës së vizave

që Kosova dhe Bosnja aplikojnë dyanshëm.

Të gjitha këto aktivitete kanë ndihmuar që të fillojnë procedurat e lehtësimit të marrjes së vizave, si të Kosovës, ashtu edhe të Bosne e Hercegovinës.

Emri i Projektit	Grantist	Shuma Euro
Open Talks Initiative – Liberalizimi i regjimit të vizave në mes të Kosovës dhe Bosnje e Hercegovinës	Doku Kino	35,077
Open Talks Initiative – We Have A Solution! Think Tanks and the Policy Paper	Doku Kino	13,829
Re-connecting: Increasing Public Awareness on the Negative Aspects of Visa Regime between Kosovo and BiH	Media Centar	20,000
Zemrat e Huaja: Traktati teatral i kufirit	Centar Umjetnosti	7,647
Bashkepunimi turistik mes Kosovës dhe Bosnjes	Ec Ma Ndryshe	18,000
Total :		94,553

